

UNIVERZITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY



Fakulteti i Juridik
Praven Fakultet
Law Faculty

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

PROGRAMI-E DREJTA PENALE

TEMA

“Faji dhe rëndësia e fajit e kryer me dashje dhe nga pakujdesia”

MENTORI:

Prof. D-r Besa Arifi

KANDIDATI:

Arman Presheva

Tetovë, 2019

DEKLARATË

Unë Arman Presheva me përgjegjësi të plotë deklaroj se jam autor origjinal i këtij desertacioni dhe puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve .

Tetovë , 2019

.....

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

DEKLARATË.....	2
FALËNDERIM.....	5
Lista e tabelave.....	6
Lista e Grafikoneve.....	7
ABSTRAKTI (Gjuhë Shqipe).....	8
KAPITULLI I PARË.....	12
A) Qëllimet e hulumtimit.....	12
B) Hipotezat.....	14
C) Rëndësia e punimit.....	15
KAPITULLI I DYTË.....	17
2.1 Përmbajtja dhe elementet përbërës të përgjegjesisë penale.....	22
2.2 Veprimi ose mosveprimi.....	24
2.3 Nocioni i rrezikut shoqëror.....	26
2.4 Kundërligjshmëria.....	28
2.5 Faji.....	30
2.6 Figura e e veprës penale si parakusht i përgjegjesisë penale.....	32
2.7 Dallimet dhe ngjajshmëritë midis veprës penale dhe figures së veprës penale.....	40
2.8 Elementet përbërës të figurës së veprës penale.....	41
2.8.1 Objekti i figurës së veprës penale.....	43
2.8.2 Ana objektive e figurës së veprës penale.....	44
2.8.3 Ana subjektive e figurës së veprës penale.....	46

2.9 Faji si element përbërës i veprës penale dhe figurës së veprës penale.....	49
2.9.1 Përkufizimi i fajit dhe funksionet e tij.....	50
2.9.2 Zhvillimi i konceptit të Fajit.....	51
2.9.3 Përmbajtja e Fajit, koncepti psikologjik dhe normativ	52
2.9.4 Struktura e Fajit.....	55
2.9.5 Përgjegjshmëria dhe komponentat e saj.....	57
2.9.6.1 Papërgjegjshmëria	60
2.9.6.2 Veprimi i lirë në shkak (Actio libera in causa)	61
2.10 Dashja dhe kuptimi i saj sipas Legjislacionit vendas.....	62
2.10.1 Llojet e Dashjes	64
a) Dashja direkte (dollus directus)	64
b) Dashja eventuale (dollus eventualis)	65
c) Dollus antecedent dhe dolus subsequens (consequent).....	66
d) Dolus repentinus i dollus praemeditatus	67
e) Dolus determinatus i dolus indeterminatus.....	67
f) Dolus generalis dhe dolus specialis	68
2.11 Pakujdesia (culpa), kuptimi sipas Legjislacionit penal vendas	68
2.11.1 Llojet e Pakujdesisë.....	71
2.11.2 Pakujdesia me vetëdije (luxuria).....	71
2.11.3 Pakujdesia pa vetëdije (negligentia).....	72
2.11.4 Faji dhe format e tij sipas Kodit Penal të Shqipërisë	74
2.11.5 Faji dhe format e tij sipas Kodit Penal të Kosovës	76
2.12 Rëndësia në përcaktimin e përgjegjshisë penale nëse egziston ose jo vepra penale.....	78
2.13 Cilësimi ligjor figurave të ngjashme të veprave penale	80
2.13.1 Përgjegjësia dhe ndëshkimi për veprat e kryera me Dashje dhe nga Pakujdesia.....	82

2.13.2 Vlersimi i gjykatës në dhënjën e dënimit.....	83
KAPITULLI I TRETË.....	86
3. Metodologjia.....	86
3.1 Vëllimi i veprave penale të kryera nga faji – me dashje dhe nga pakujdesia në Gjykatën penale të Komunës së Gostivarit në periudhën kohore 2011-2015 dhe politika ndëshkuese e Gjykatës	87
3.2 Casy Study - Intervistë e realizuar me Prokurorin Publik në Komunë e Gostivarit	92
KAPITULLI I KATËRT.....	98
4.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	98
4.1 BIBLIOGRAFIA.....	103
4.1.1 Akte normative.....	105

Lista e tabelave

Tabela nr.1

Tabela nr.2

Lista e Grafikoneve

Grafikoni nr.1

Grafikoni nr.2

ABSTRAKTI (Gjuhë Shqipe)

Vepra penale ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Pikërisht për të kuptuar vlerën juridike të fakteve të parashikuara nga ligji si vepra penale në lidhje me të mirat juridike të cilat ligjvënësi synon të mbrojë, është e nevojshme ndarja dhe analizimi shkencor i të gjithë elementëve përbërës të veprës penale. Për të ekzistuar vepra penale nuk mjafton vetëm realizimi i figurës së veprës penale, është i nevojshëm edhe faji nga ana e autorit. Pra, hulumtimi shkencor i kësaj teze do të fokusohet në Fajin si institut i të drejtës penale si dhe format në të cilat manifestohet ky institut mbi të cilin mbështetet përgjegjsia penale.

Faji paraqet në vetvete qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës shoqërisht të rrezikëshme që vijnë apo mund të vijnë prej saj, të kundërligjshme dhe pasojës së dëmshme. Ky institut paraqet themelin apo bazën juridike mbi të cilin sajohet dhe mbështetet përgjegjsia penale. Duke u nisur nga Parimi i të drejtës romake „*Nullum crimen, nulla poena sine culpa*“ (Nuk ka veprë penale dhe nuk ka dënim pa faj) lehtë mund të qasemi drejt hulumtimit të këtij instituti si dhe qëllimet e parimit në fjalë, sipas të cilit për çdo veprë të shkaktuar me faj nga autori i veprës penale parashihet kufizimi dhe vendosja në korniza të caktuara e drejta e shtetit për të ndëshkuar.

Hulumtimi i kësaj teze kryesisht do të bazohet në qartësimin e anës subjektive të figurës të veprës penale, ku do të vjen në konsideratë hulumtimi i Fajit dhe format në të cilat manifestohet ai gjithmonë duke u bazuar në Parimin mbi fajin se: „*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veprë penale, nëse vepra nuk është kryer me faj*“.

Faji pra, përkufizohet si qëndrimi psikik që mban personi ndaj veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm dhe pasojave të dëmshme. Si institut i të drejtës penale është një ndër çështjet fundamentale dhe më komplekse sidomos për përgjegjsinë penale dhe ndëshkimin. Fajësia ose mungesa e saj në kryerjen e veprës penale vlerësohet nga gjykata dhe deklarohet në vendimin e saj përfundimtar. Në kontekst të këndvështrimit të tillë mbi përkufizimin e fajit do të hulumtohen edhe format në të cilën paraqitet Faji si: Dashja (*dolus*) dhe Pakujdesia (*culpa*).

Dashja përcaktohet si kryerje e vetëdijshme dhe e dëshirueshme e veprës penale. Në strukturën e nocionit të fajit paraqitet si një ndër elementet nëpërmjet të cilit shprehet raporti psikologjik i kryesit ndaj veprës së tij dhe njëherit edhe substrati themelor psikologjik I Fajit. Duke pasur parasysh se Dashja paraqitet në disa forma, pikërisht gjatë hulumtimit do të fokusohemi edhe në format e kësaj komponente të cilat janë të lidhura ngushtë me vetëdijen e kryesit edhe pse vlen të potencojmë se llojet e posaçme të Dashjes sipas strukture së tyre psikologjike nuk dallohen nga struktura elementare e Dashjes në përgjithësi, si kryerje e vetëdijshme dhe e dëshirueshme e veprës penale.

Pakujdesia si formë e Fajit gjithashtu do të jetë pjesë e këtij hulumtimi shkencor, por është e rëndësishme të potencoj se përkundrejt Dashjes te kjo formë e Fajit vepra penale kryhet kur personi edhe pse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e arrdhjes së tyre dhe me mendjehetësinë e tij shpreson t'i shmangë ato, ose nuk i prashikon, megjithëse sipas rrethanave duhet dhe ka mundësi ti parashikojë. Pakujdesia dhe Dashja dallohen midis veti për shkak të qëndrimit të ndryshëm psikik të personit ndaj veprimit apo mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm. Ky konceptim i këtyre dy formave të fajit do të na mundësojë ti qasemi aspektit dallues midis pakujdesisë me vetbesimin e tepruar dhe dashjes indirekte si mënyrë e të menduarit rreth pasojave të mundshme të cilat mund t'i parandalojë ato.

Shkalla dhe karakteri i parashikimit të pasojave në pakujdesi me vetbesim të tepruar nuk janë as të barabarta dhe as të njëjta me ato të dashjes. Pakujdesia në formën e vetbesimit të tepruar është karakteristikë e veprave penale të shkeljeve të rregullave të mbrojtjes në punë, të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj. Përgjegjësia penale ekziston në ato raste kur personi i ka aftësitë për të parashikuar pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij, kur nuk ka rrethana objektive penguese në këtë veprim. Ekzistenca e neglizhencës lidhet me detyrimin e personit për t'i parashikuar pasojat dhe me mundësinë e parashikimit. Kodi Penal përmban disa figura veprash penale të cilat kryhen vetëm me pakujdesi në formën e neglizhencës, si mjekimi i pakujdesshëm ose humbja e disa dokumentave sekrete, ndërsa shumica e figurave të veprave penale të cilat parashikohen në Kodin Penal zhvillohen me format e pakujdesisë.

Trajtimi i Fajit në këtë tezë do të përmbillet me elaborimin e formës të ndërlikuar të Fajit që paraqet një rast përjashtimor, ku qëndrimi psikik i personit ndaj pasojave të afërta dhe të largëta është i ndryshëm. Personi parashikon se me veprimin e tij do të vijë domosdoshmërisht

ardhja e pasojës së afërt dhe vepron me dashje direkte për ardhjen e saj. Por në vënd të saj vjen një pasojë tjetër, pasoja më e largët të cilën personi nuk e ka dëshiruar psh: tek figura e veprës penale plagosja e rëndë me dashje e cila ka sjellë si pasojë vdekjen. Rasti fatkeq është kur në kryerjen e veprës penale nga personi nuk vërtetohet asnjë formë fajsie, domethënë kur vepra kryhet pa faj dhe ngjarja e ndodhur quhet rast fatkeq. Në këtë situatë të krijuar doktrina juridike parasheh mundësinë e lidhjes shkakësore midis sjelljes së personit dhe pasojës së ardhur prej saj. Personi në rrethanat e ndodhjes së ngjarjes, objektivisht nuk ka patur mundësi ta parashikonte dhe as ishte i detyruar ta parashikonte atë. Rasti fatkeq në legjislacionin penal e përjashton përgjegjësinë penale të autorit të veprës.

Analiza e veçantë e elementit “Faj” të veprës penale ka rëndësi nga ana metodologjike në studimin dhe interpretimin e veprës penale. Pra, synohet që të vendosen përpara përgjegjësisë penale personat që kryejnë vepra penale, vepra të cilat plotësojnë kushtet e përkufizimit që jep doktrina e së drejtës penale, gjë që përbën garancinë themelore të procesit penal.

Rëndësia e studimit të Fajit dhe formave në të cilat ai manifestohet është parësore në këto drejtime:

- Së pari, shërben për të përcaktuar përgjegjësinë penale, nëse ekziston ose jo vepra penale në një rast ku shfaqet fajit dhe format në të cilat ai manifestohet;
- Së dyti, ka rëndësi vendimtare për të përcaktuar cilësimin ligjor të figurave të ngjashme të veprave penale, për të cilat kryhen forma të ndryshme fajit;
- Së treti, ka rëndësi për caktimin e dënimit, pasi format e fajit, natyra e motiveve dhe qëllimi ndikojnë në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore;

PJESA E PARË

KAPITULLI I PARË

a) Qëllimet e hulumtimit

Hulumtimi i kësaj teze si objekt studimi elaboron në aspektin teoriko –shkencor “Fajin”, duke përfshi përkufizimin e tij , faktorët që mundësojnë paraqitjen e tij dhe format e manifestimit kryesisht Dashjen dhe Pakujdesinë. Qëllimi primar gjithmonë duhet të jetë qartësimi i asaj çka trajtohet në kontekstin e nocionit, rregullativës ligjore si dhe një tjetër element në këtë rast, trajtimi komparativ i legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë me legjislacionet penale të vendeve të rajonit dhe më gjërë në kontekst të këtij instituti. Përveç përgjegjësisë penale të subjekteve të së drejtës (person juridik, person fizik) e cila gjithmonë bazohet në Fajin e autorit të veprës penale , qëllimi i hulumtimit të këtij studimi paraqet edhe një hap para rreth qartësimit më adekuat lidhur me zbatimin praktik të së drejtës penale nga ana e institucioneve përkatëse tek të cilat shtrohet kjo problematikë. Zbulimi i autorëve të veprave penale nga ana e institucioneve përkatëse dhe përcaktimi i ndëshkimit adekuat mundëson që të vendosen përpara përgjegjësisë penale personat që kryejnë vepra penale, vepra të cilat plotësojnë kushtet e përkufizimit që jep doktrina e së drejtës penale në kontekst të Fajit , gjë që përbën garancinë themelore të procesit penal.

Së fundi qëllim I hulumtimit të kësaj teze paraqet analizën e zbatimit të procedurave gjyqësore , të cilat bëjnë trajtimin e rasteve të Faji si institut dhe formave në të cilat ai manifestohet me çrast institucionet përkatëse si Prokuroria shtetërore por edhe gjykatat është e rëndësisë të veçantë të marrin parasysh dhe të ndihmohen nga mendimet e ekspertëve në dhënien e përcaktimeve dhe shkaqeve që kanë çuar në realizimin e veprës penale, por gjithashtu vet gjykatësi duhet të ketë një vëmendje shumë më të koncentruar ndaj gjithë faktorëve që kanë prodhuar manifestimin e përgjegjësisë penale. Gjykata në dhënien e dënimit duhet të ketë parasysh të gjithë elementët e sjelljes së autorit të veprës si dhe të rrezikshmërisë që karakterizon këtë vepër duke identifikuar dhe japë dënimin më të përshtatshëm për rastin konkret të paraqitur. Duke iu referuar hulumtimit praktik të kësaj teze të gjithë të dhënat do të merren nga Gjykata penale e Gostivarit , me çka si qëllim hulumtimi do të jetë edhe praktika gjyqësore bazuar në veprat penale të kryera me faj dhe atë me Dashje dhe nga Pakujdesia për një periudhë kohore të caktuar, me qëllim që të vërehet se ky lloj I veprave penale a është në rritje

ose në rënje , çka do të sjell përfundimin rreth efikasitetit të gjykatave, dhënjen e dënimeve në bazë të të gjithë elementeve të sjelljes së autorit të veprës penale si dhe të rrezikshmërisë shoqërore. Në këtë kontekst kryerja e veprës penale me dashje apo nga pakujdesia do të merret si rethanë lehtësuese apo rënduese për kryesin e veprës penale lidhur me shqiptimin e dënimit.

b) Hipotezat

Në tezën që hulumtohet do të nisemi nga hipoteza e përgjithshme :

- Sa më i bazuar të jetë procesi i përcaktimit të Fajit në veprën penale , aq më ligjore do të jetë veprimtaria e procedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtutjeshme. Përcaktimi i përpiktë i institutit të fajit dhe formave në të cilat ai manifestohet është parakusht për zbatimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal;

Nga Hipoteza e përgjithshme burojnë edhe hipotezat e veçanta:

- Struktura e Fajit përfshin: përgjegjsi, dashje dhe pakujdesi dhe vetëdije ose detyrim dhe mundësi për vetëdije për ndalueshmërinë e veprës penale, dmth. , nevojitet vetëdije aktuale apo potenciale për ndalueshmërinë e veprës, kurse detyrimi dhe mundësia për vetëdije për ndalueshmërinë janë të mjaftueshme jo vetëm te pakujdesia por edhe te dashja;

- Për çdo veprë të shkaktuar me faj nga autori I veprës parashihet kufizimi dhe vendosja në korniza të caktuara e drejta e shtetit për të ndëshkuar;

- Në vlersimin e saj gjykata është e detyruar të bëjë një vlersim pozitiv të të gjithë Rasteve që kanë çuar në shkaktimin e pasojave të parashikuar nga dispozita ligjore;

- Gjykata duhet të ndihmohen nga mendimi i ekspertëve në dhënien e përcaktimeve dhe shkaqeve që kanë çuar në realizimin e veprës penale, por gjithashtu vet gjykatësi duhet të ketë një vëmendje shumë më të koncentruar ndaj gjithë autorëve nëse ata paraqiten si pjesmarrës në kryerjen e veprës penale që ka prodhuar manifestimin e përgjegjësisë penale.

- Gjykata në dhënien e dënimit duhet të ketë parasysh të gjithë elementët e sjelljes së autorit të veprës penale si dhe të rrezikshmërisë shoqërore. Gjykata duhet të jetë në gjendje të identifikoj dhe jap dënimin më të përshtatshëm për rastin konkret të paraqitur dhe të krijuar sipas fajta dhe formave të tij;

- Në legjislacionin penal , llojet e posaçme të dashjes janë të rëndësishme për praktikën gjyqësore , për njohjen më të mirë të dashjes dhe mund të merren si rrethanë rënduese apo lehtësuese me raste të dënimit;

Me vërtetimin apo hedhjen e hipotezave të parashtruara do të fitojmë të dhëna të sakta lidhur me Institutin e Fajit, format e manifestimit të tij dhe rëndësinë e tyre në vlersimin dhe dallimin e llojit të veprave penale në legjislacionin penal vendor.

c) Rëndësia e punimit

Rëndësia dhe arsyet e hulumtimit të këtij punimi janë të shumta por njëra ndër më të rëndësishmet është ajo, se ky punim do të jetë një lloj ndihmese për të kuptuar në mënyrë të detajuar institutin e Fajit, format e manifestimit të tij dhe rëndësinë e këtyre formave në jurisprudencën penale. Pra, realizimit të këtij punimi do t'i shërbej hartimi i një strukture funksionale të brendshme të të gjitha strukturave shtetërore në veçanti Prokurorisë shtetërore dhe Gjysqisë lidhur me identifikimin rast pas rasti të elementeve përbërës të veprës penale kryesit Fajit me qëllim ndihmese për të bërë dallimin e qartë ndërmjet veprave penale dhe mbi bazën e të cilave do të akuzohet autori i saj. Sa më I bazuar do të jetë procesi gjyqsor I përcaktimit të fajit, aq më ligjore do të jetë veprimtaria e organeve të procedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtejshme. Pra, punimi në fakt në mënyrë modeste do të ketë impakt në modernizimin e legjislacionit tonë penal, posaçërisht në pjesën e anës subjektive të figurës së veprës penale, por edhe të procedurës penale. Në këtë pjesë, Kodi ynë Penal, ka nevojë për reformim, sipas parimeve të përgjithëshme juridike-penale, për tu përsosur dhe për tu afruar më shumë me qëndrimet bashkëkohore të së Drejtës Penale si dhe me praktikën europiane përkatëse. Kështu Kodi ynë Penal ka nevojë të plotësohet me dispozita sqaruese, ndërsa ai procedural me reformën e Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Së fundi , ky hulumtim do të gjallëronte më shumë jetën juridike penale në vëndin tone pasiqë, zgjerimi i botimeve në këtë fushë, do të perbënin kontribut të çmuar në përpunimin e mendimit shkencor juridik penal dhe forcimin e formimit shkencor profesional të studentëve të drejtësisë të universiteteve në vendin tonë. Punimi i kësaj teze ndoshta do të jetë sadopak i ndikueshëm edhe tek ligjvënësi për të pasuruar dispozitat në legjislacionin penal që kanë të bëjnë me kualifikimin e veprave penale në procedurat gjyqsore si dhe plotësimin e zbrastirave juridike që mund të hasen në legjislacionin vendas. Me rastin e hulumtimit dhe të vërtetimit të hipotezave të lartpërendura dhe pas arritjes dhe realizimit të qëllimeve të parapara në këtë punim do të rezultojnë disa përfundime dhe rekomandime që do të nxirren nga ky hulumtim, të cilat do ti paraqes në tezën time të magjistraturës.

PJESA E DYTË

KAPITULLI I DYTË

2. VEPRA PENALE SI BAZË E PERGJEGJËSISË PENALE

Gjatë studimeve shkencore mbi institutet themelore që karakterizojnë kodet penale, si tentativa, përgjegjësia e tentativës, pakujdesia, bashkëpunimi, bashkërealizimi i veprave penale, mbrojtja e nevojshme, vepra penale e cilësuar nga rrethana lehtësuese apo rënduese etj; vihet re aplikimi i vazhdueshëm i një terminologjie, e cila përdoret nga pjesa më e madhe e manualeve dhe komentareve të së drejtës penale të Italisë, Gjermanisë, Spanjës, Turqisë dhe vendeve të Amerikës Latine. Më ekzaktësisht, pjesëtarët e doktrinës së këtyre shteteve, të cilët përbëjnë pjesën dërrmuese të doktrinës botërore rreth “teorisë së përgjithshme të së drejtës penale”, e cila tashmë është pjesë e kulturës ndërkombëtare edhe të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, përdorin shprehjen “mënyrat e shfaqjes së veprës penale”.¹

Terminologjia në fjalë, shpreh një koncept të përgjithshëm, që synon të mbledh të gjitha ato raste në të cilat vepra penale përveç strukturës së saj elementare shfaq edhe disa elemente të tjerë, të cilët e bëjnë të ndryshojë nga prototipi. Ky i fundit identifikohet me faktin tipik, të kundërligjshëm, me faj apo me faktin objektivisht të paligjshëm me faj, i përbërë nga të gjithë elementët e tij (sjellja, elementi psikologjik, pasojat etj.), i cili realizohet nga një subjekt dhe përputhet me dispozitën e përshkruar në pjesën e posaçme të kodit penal. Këtij modeli klasik të realizimit të veprës penale (i cili identifikon veprën penale të konsumuar në mënyrë të thjeshtë, monosubjektive), i kundërvihen disa mënyra (forma) alternative me anë të cilave vepra penale mund të shfaqet konkretisht.² Mund të ndodh që vepra penale të paraqitet e përealizuar sepse, nuk realizohet prekja e të mirës juridike drejt së cilës sjellja ishte drejtuar (p.sh X qëllon me pistoletë në drejtim të Y-it, por gabon shënjestrën dhe gjuajtja shkon bosh), ose sepse sjellja me anë të së cilës realizohet vepra penale nuk përfundohet p.sh, Z hyn në një banesë për të vjedhur, por pasi shikon të zotin e shtëpisë largohet pa përvetësuar asnjë send.³

¹ Për herë të parë shprehja: “mënyrat e shfaqjes së veprës penale”, në fjalë është përdorur rreth 1910 në Gjermani nga Beling dhe shprehja ishte “erscheinungsformen”. Ferrando MANTOVANI, Diritto penale, Padova, 2007.

² Carlo FIORE – Stefano FIORE, Diritto penale, Botimi i III, Milano 2008

³ Mbi konceptin e tentativës në doktrinën shqiptare: Ismet ELEZI – Skënder KAÇUPI – Maksim HAXHIA, Komentari i kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006. SH. MUÇI, E drejta penale, pjesë e përgjithshme, Tiranë, 2007

Nuk ka dyshim, se një veprë penale e mbetur në tentativë përbën një fakt që nga ana fenomenologjike është krejt ndryshe nga fakti i realizuar. Pra, një gjë është vrasja e një njeriu, që do të thotë përfundimi i funksioneve jetësore të tij, tjetër është tentativa për të vrarë një njeri ku fenomeni i vdekjes nuk realizohet. Por për të ndëshkuar kë tenton, duhet që dispozitës që parashikon një veprë penale t'i shtohet, në mënyrë normative, tipiciteti me anë të një dispozite, e cila parashikon tentativën. Si rrjedhim, në rastin e vrasjes se mbetur në tentativë do të aplikohet neni 76 (vrasja) dhe neni 22 i Kodit Penal (tentativa). Pra, kemi të bëjmë me një fenomen integrimi dispozitash. Gjithashtu, vepra penale mund të jetë fryti i bashkëpunimit të disa njerëzve, vullnetet e të cilëve konvergjojnë në realizimin e një pasoje të dëmshme për të mirën juridike. P.sh A, B dhe C nisen për të bërë një vjedhje. A futet në banesën e marrë në shënjestër, B bën roje poshtë banesës për të parë mos vijtë të zotët e shtëpisë, C është gati me makinën e ndezur për tu nisur menjëherë pas vjedhjes. Raste e marra në shqyrtim i përgjigjen figurave të tentativës dhe të bashkëpunimit në veprën penale monosubjektive. Bëhet fjalë për raste të parashikuara në ligj me anë të të cilave ligjvënësi shtrin tipicitetin, i cili në teorinë e përgjithshme të veprës penale përdoret si në lidhje me faktet e parashikuara nga ligji si veprë penale, ashtu edhe për institutet e tjerë të parashikuara në kodet penale, të cilët modifikojnë ose orientojnë kuptimin e faktit tipik. P.sh tipike është dispozita e bashkëpunimit. Mund të bashkëpunohet vetëm në mënyrat e parashikuara nga kodi penal. P.sh në bazë të nenit 26 të Kodit Penal,⁴ mund të bashkëpunohet me anë të shtyrjes në realizimin e një veprë penale, me anë të dhënies ndihmë, me anë të organizimit për të realizuar një veprë penale. Nuk mund të quhet bashkëpunëtor subjekti i cili, edhe pse në dijëni rreth realizimit të një veprë penale, nuk kallëzon këtë të fundit përpara organeve kompetente. Në këtë rast, subjekti në fjalë nuk mund të cilësohet bashkëpunëtor, por mund të thërritet për gjykim pasi realizon veprën e moskallëzimit të krimit i parashikuar nga neni 300 i K.P.⁵Në rastin e parë tipiciteti shtrihet edhe në rastet e realizimit

⁴ Neni 26 i K.P. Bashkëpunëtorët: “Bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit. Organizatorë quhen ata persona që organizojnë dhe drejojnë veprimtarinë për kryerjen e veprës penale. Ekzekutorë janë personat që kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale. Shtytës quhen personat që nxisin bashkëpunëtorët e tjerë për kryerjen e veprës penale. Ndihmës quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmojnë për kryerjen e saj.”

⁵ Neni 300 i K.P. Moskallëzimi i krimit: “Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me

⁵ Po aty.

vetëm të një pjese të veprës penale; në rastin e dytë tipiciteti i shtrihet edhe bashkëpunëtorëve në veprën penale. Është e qartë se në rastin e tentativës, në qoftë se kjo figurë nuk do të ishte e parashikuar në ligj, mos realizimi i pasojës apo të një pjese të veprimit, duhet të përjashtojë përgjegjësia penale, pasi fakti nuk mund të quhej tipik. Ndëshkimi i një krimi në tentativë mund të bëhet vetëm në prezencë të një dispozite që parashikon tentativën dhe që ka si funksion shtrirjen e tipicitetit edhe rasteve në fjalë. Të njëjtin funksion kanë edhe dispozitat mbi bashkëpunimin e parashikuara në nenet 25, 26, 27 të Kodit Penal. Kjo dispozitë bën të mundur shtrirjen e përgjegjësisë penale edhe ndaj atyre sjelljeve (të mendohet sjellja e shtytësisë apo ajo e ndihmësisë), të cilat nëse konsiderohen në mënyrë individuale nuk prezantojnë karakteristikat e faktit tipik. Tek shembulli i mëparshëm C-ja, i cili ndodhet në makinë nuk realizon faktin tipik të veprës penale të vjedhjes. Në këto raste, fakti tipik prezantohet jo vetëm në aspektet e tij thelbësore, por gjithashtu shpreh edhe disa elemente të tjerë (të cilët janë jashtë tij), si p.sh mënyra e ekzekutimit; koha e ekzekutimit; kryerja e veprës penale i shtyrë nga motive me vlera pozitive, morale e shoqërore; kur vepra kryhet nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokime ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër; paramendimi, lidhjet me viktimën etj, rrethana këto që konsiderohen nga ligji me vlerë për të cilësuar veprën penale si më të lehtë apo më të rëndë. Në bazë të këtyre rrethanave lehtësuese apo rënduese ndryshon edhe masa e dënimit që i aplikohet të pandehurit.⁶

Megjithatë, nuk duhet bërë konfuzion me veprën penale të thjeshtë. Vepra penale e thjeshtë është perfekte në qoftë se paraqet të gjithë elementet thelbësor të saj. Vetëm në qoftë se fakti konkret i realizuar nga i pandehuri paraqet përveç këtyre elementeve, që duhet të jenë prezent, edhe element të tjerë shtesë, atëherë shfaqet vepra penale e cilësuar nga rrethana rënduese ose lehtësuese. Në përfundim, duket e qartë se institutet e veprës penale të cilësuar nga rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe të bashkërealizimit të veprave penale nuk mund të futen në konceptin e “mënyrave të shfaqjes së veprës penale”.

Si konkluzion mund të nxjerrim që, meqenëse një gjë e tillë nuk pranohet nga doktrina italiane, kritika jonë pikërisht për të evituar shpërfytyrimin e konceptimit shkencor, nuk përdor

⁶ Ismet ELEZI – Skënder KAÇUPI – Maksim HAXHIA, Komentari i kodit penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006. Bazuar mbi nenin 48 të Kodit Penal mbi rrethanat lehtësuese dhe nenin 50 të Kodit Penal mbi rrethanat rënduese.

shprehjen “mënyrat e shfaqjes së veprës penale”, por shprehjen “format e veprës penale”⁷ E drejta penale mund të thuhet dhe të shqyrtohet në kuptim të dyfishtë – si degë e së drejtës pozitive juridike dhe si degë e shkencës juridike. Kuptuar mënyrën e parë e drejta penale 1 është sistem i të drejtave dhe rregullave ligjore me të cilin përcaktohen veprat penale dhe sanksionet penale si dhe kushtet për zbatimin e tyre ndaj kryerësve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së të mirave materiale të vlerave më të rëndësishme të shoqërisë. Një definicion i atillë sipas të cilit e drejta penale është sistem i të gjitha dispozitave ligjore me të cilat një shtet i rregullon dhe përcakton sjelljet që konsiderohen vepra penale, dhe cilat dënime dhe sanksione të tjera penale, dhe në çfarë kushtesh mund të zbatohen ndaj kryerësve të tyre. Nga këto definicione del se nocioni i së drejtës penale përmban elementin formal dhe material. Elementin material, respektivisht përmbajtjen e së drejtës penale e përbëjnë definimi i veprës penale, përgjegjësisë penale dhe sanksionit penal, me qëllim të realizimit të mbrojtjes – funksionit garantues. Elementi formal na pasqyrohet që vepra penale si dhe sanksioni penal bashkë me kushtin për zbatimin e tyre mund të definojnë vetëm me ligj, që do të thotë se e drejta penale është e drejtë ligjore. Pasi që rregullimi juridik është i definuar me një varg ligjesh që me tërësinë e tyre e përbëjnë legjislacionin e një shteti, dhe se edhe e drejta penale si e drejtë ligjore mund të vështrohet si degë e legjislacionit, respektivisht si degë e së drejtës pozitive të një shteti. Karakteristika materiale e së drejtës penale është e përbërë nga funksioni i tij i mbrojtjes së të mirave shoqërore dhe e vlerave më të rëndësishme të shtetit të caktuar.

Ajo mbrojtje realizohet duke normuar, duke shqiptuar dhe duke i ekzekutuar sanksionet që kanë karakter detyrimi, që zbatohen ndaj kryerësve të veprave penale me të cilat lëndohet ose rrezikohen vlerat e mbrojtura. E drejta penale, i shpall disa sjellje të njerëzve si vepra penale duke paraparë për kryerësit e tyre llojin e caktuar të masës së Dënimit ose sanksionit tjetër penal. Nga kjo del edhe qëllimi i kësaj dege të drejtësisë. Dhe se në të vërtetë përbëhet nga ndikimi në sjelljet njerëzore duke i orientuar se çka është e pa lejueshme dhe e ndaluar të veprohet, a çka jo, që do të thotë, ndikon që njerëzit të sjellën në harmoni me ligjet dhe rregullat juridike. Sipas kësaj, qëllimi i së drejtës penale nuk është vetëm në zbatimin e Dënimit ndaj të padëgjueshmëve. Edhe përkundër këtij definicioni materialo-formal të nocionit të së drejtës penale, në teorinë e së drejtës penale, na paraqiten definicione të njëanshme formale ose materiale.

⁷ Gjithashtu shih edhe: Fabrizio RAMACCI, Il tentativo, në Studi Senesi, cit

Definicionet formale e definojnë të drejtën penale si tërësi ligjesh ose norma penale juridike në bazë të së cilave organet e caktuara shtetërore – gjykatat i shqiptojnë dhe i zbatojnë sanksionet penale ndaj kryerësve të veprave të ndaluara. Definicionet materiale megjithatë bazohen në atë se e drejta penale është degë e drejtësisë me të cilën mbrohen interesat e caktuara, respektivisht të mirat materiale ose vlerat tjera shoqërore.⁸ Vepra penale është vepër e rrezikshme shoqërore, që rendi juridik e ndalon me kërcënim të aplikimit të sanksioneve penale. Ajo është rezultat i sjelljes të njeriut, kështu që mund të caktohet si sjellje e njeriut me të cilën shkelen dispozitat juridike dhe shkaktohen pasoja të dëmshme për shoqërinë, për çka edhe reagohet me aplikimin e sanksioneve penale. Si sjellje e njeriut, si akt i njeriut të caktuar, kjo bartë karakteristika të vetë personalitetit: kushteve të tij të jetës, konfliktit me vetvete, konfliktit me individë të tjerë, grupet shoqërore dhe shoqërinë në tërësi. Vepra penale është akt negativ i njeriut dhe i dëmshëm për shoqërinë. Ajo më së shpeshti paraqitet si rezultat u konflikteve ndërmjet individëve dhe interesave të tyre, individëve dhe shoqërisë, si mospajtim ndërmjet dëshirave, nevojave dhe mundësisë për përmbushjen e tyre, si rezultat i ndonjë tronditjeje ose si dalje nga kriza, përkatësisht si zgjidhje negative e ndonjë situatë konflikti ose situatë stresi. Ajo është më së shpeshti akt i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm, por mund të jetë edhe akt i pamatur, si dhe akt i projektimit të imagjinatës së sëmurë dhe halucinacionit, përkatësisht rezultat i sëmundjes ose çrregullimit shpirtëror. Vepra penale nuk është akt i njeriut, përkatësisht prodhim i njeriut, por njëkohësisht është edhe dukuri e shoqërisë. Kjo nuk është vetëm akt i rastësishëm dhe i izoluar, por akt që përsëritet dhe e bën dukurinë, rrënjët e së cilës janë në kushtet shoqërore të njeriut. Jashtë shoqërisë njerëzore nuk ka vepër. Ajo është dukuri negative e shoqërisë, ngase me këtë akt sulmohen vlerat shoqërore dhe njerëzore dhe rrezikohet ekzistenca e shoqërisë si bashkësi njerëzish. Vepra penale si dukuri shoqërore lidhet me shoqërinë e klasave, sepse me krijimin e shoqërisë klasore, vepra penale si veprimtari kundër shoqërore bëhet dukuri ligjvënëse e kësaj shoqërie, e pandarë nga ajo dhe shoqëruet i përhershëm i saj.⁹

⁸ Të drejtën penale si degë e së drejtës pozitive juridike në Kosovë e përbën Kodi i përkohshëm penal i Kosovës.

⁹ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.66

2.1 Përmbajtja dhe elementet përbërës të përgjegjesisë penale

Kryerja e veprës penale paraqet supozimin për zbatimin e dënimit ose të masave të paralajmërimit sipas kryesit të saj, si reaksion i domosdoshëm i shoqërisë-shtetit për lëndimin e shkaktuar ose rrezikimin e vlerave të mbrojtura me cenimin e normave të rendit juridik. Por, për tu zbatuar dënimi ose sanksioni i paralajmërimit për kryesit, është e domosdoshme që ai të jetë përgjegjës për veprën e kryer, d.m.th të ketë raport të caktuar psikik për veprën e kryer si kryes i saj. Prandaj, për zbatimin e dënimit dhe masave administrative (ose sanksioneve paralajmëruese) është e domosdoshme që përveç ekzistimit të veprës penale të ekziston edhe përgjegjësia penale për kryerësin e veprës. Nga kjo mund të konstatohet që ekzistimi i përgjegjesisë penale është kusht i domosdoshëm për shqiptimin e dënimit ndaj kryesit të veprës penale. Përgjegjësia penale paraqet një grumbull kushtesh subjektive me të cilat përcaktohet gjendja psikike e kryesit të veprës dhe raporti i ti ndaj veprës penale¹⁰. Ajo përcaktohet si grumbull i kushteve subjektive të cilat e karakterizojnë kryerësin e veprës penale si të aftë mendor dhe fajtor (neni 11 KP). D.m.th, ky është nocioni genus i cili nënkupton aftësinë mentale dhe fajësinë. Nga ky nocion i përcaktuar mund të konstatohet se përgjegjësia penale është subjektive dhe kategori psikike. Përgjegjësia penale paraqet një grumbull kushtesh subjektive me të cilat përcaktohet gjendja psikike e kryesit të veprës dhe raporti i ti ndaj veprës penale. Ajo përcaktohet si grumbull i kushteve subjektive të cilat e karakterizojnë kryerësin e veprës penale si të aftë mendor dhe fajtor (neni 11 KP). D.m.th, ky është nocioni genus i cili nënkupton aftësinë mentale dhe fajësinë. Nga ky nocion i përcaktuar mund të konstatohet se përgjegjësia penale është subjektive dhe kategori psikike. Përveç këtij mendimi subjektiv, në teorinë e së drejtës ekziston dhe mendim më i gjerë, ose mendim objektiv-subjektiv i përgjegjesisë penale. Sipas këtij botëkuptimi, përgjegjësia penale përbëhet nga 3 elemente: 1) veprës penale (element objektiv), 2) aftësisë mendore dhe 3) dhe fajësisë (element subjektiv). Përgjegjësia penale me të vërtetë presupozon ekzistimin e veprës penale, sepse problemi i përcaktimit të përgjegjesisë penale paraqitet pasi që është kryer një vepër e rrezikshme dhe e kundërligjshme shoqërore dhe me ligj është përcaktuar si vepër penale për të cilin parashihet dënimi. Pa ekzistimin e veprës penale nuk mund as të parashtrahet çështja e përgjegjesisë penale. Ky fakt tregon se përgjegjësia penale mund të kuptohet edhe në vështrimin objektiv-subjektiv.

¹⁰ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.66

Në teorinë e së drejtës penale mund të hasim edhe mendime të tilla sipas të cilave instituti qendror i kësaj fushe është fajtori i vërtete, por përgjegjësia penale paraqet vetëm konstatimin d.m.th përcaktimin se një individ i përmbush kushtet për fajësi. Përgjegjësia penale kështu është vetëm pasoj e kryerjes së veprës penale siç është përgjegjësia juridiko-civile vetëm pasojë e kryerjes së deliktit juridiko-civil ose të deliktit civil (shkaktimi i dëmit). D.m.th, përgjegjësia penale është vetëm term teknik i cili tregon se një individ ka kryer veprën penale dhe që për atë veprën ai është përgjegjës. Kjo d.m.th që nocioni përgjegjësi penale ka vetëm karakter deklarativ, e jo thelbësor.¹¹ Duke filluar nga mendimi i paraqitur në dispozitën e nenit 11 KP, që përgjegjësia penale është kategori subjektive dhe psikike e cila është e lidhur me personalitetin e kryesit të veprës penale mund të vërejmë se ajo përbëhet nga dy elemente kryesore. Këto elemente janë aftësia mendore dhe fajësia .Aftësia mendore përcakton ekzistimin e aftësive psikike të kryesi i veprës penale të cilat e bëjnë të aftë ta kuptoj rëndësinë e veprave të tij dhe të udhëheq me veprimet e veta. Fajësia përcakton ekzistimin e raportit të caktuar të kryesit ndaj veprës së tij si kryes i saj. Për t iu ngarkuar vepra penale kryesit është e domosdoshme përmbushja e dy elementeve.

D.m.th, për ekzistimin e përgjegjësisë penale është e domosdoshme ekzistimi i aftësisë mendore dhe fajësia (fajësia e cila paraqitet me paramendim ose nga pakujdesia). Kjo është e kuptueshme, se pa ekzistimin e aftësisë mendore nuk mund të ekzistoi as fajësia duke pas parasysh që aftësia mendore është bazë mbi të cilën paraqitet fajësia. Në anën tjetër, aftësia mendore mund të ekzistoj dhe atëherë kur te kryesi nuk ka fajësi për veprën e kryer, në të dyja rastet nuk ka përgjegjësi penale, kështu që nuk mund të vjen as deri te dënimi për veprat e kryera në mungesë të elementeve të cekura më lart. Aftësia mendore dhe fajësia mund të maten sipas shkallës , d.m.th mund të ekzistoj shkallë më e lart ose më e ultë e aftësisë mendore si dhe shkallë më e lartë ose më e ultë e fajësisë në varësi nga shkalla dhe intensitetit i paraqitjes së elementeve subjektive dhe psikike (vetëdijes dhe dëshirës) të kryesit të rastit konkret. Kjo d.m.th që përgjegjësia penale mund të matet me shkallë. Ky fakt është shumë i rëndësishëm , sepse nga shkalla e përgjegjësisë penale, varet jo vetëm lloji dhe lartësia e dënimit për veprën e kryer, por në disa raste dhe ekzistimi i dënimit e me këtë ekzistimi i veprës penale.

¹¹ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006,fq.66

Pasi që përgjegjësia penale është kusht për zbatimin e dënimeve sipas kryesit të veprës, ajo duhet të ekzistoi dhe në kohën e kryerjes të veprës penale. Kjo d.m.th që aftësia mendore dhe fajësia duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes të veprës penale në raport me veprën penale konkrete të kryer.¹²

2.2 Veprimi ose mosveprimi

Veprimi apo sjellja e caktuar e njeriut është një ndër elementet themelore të çdo vepre penale. Veprimi shprehet të veprat penale që kryhen me veprim dhe mosveprim, të veprat penale të kryera me dashje dhe nga pakujdesia, të tentativa apo vepra penale e kryer, etj. Me termin veprim nënkuptojmë të gjitha sjelljet apo veprimet e njeriut që manifestohen në botën e jashtme dhe të cilat janë të përcaktuara me ligj si vepra penale.¹³ Veprimet që ngjajnë në psikën dhe vullnetin e brendshëm të njeriut, siç janë: mendimi, dëshira, vendimi dhe qëllimi për të kryer vepër penale, nuk mund të konsiderohen veprime në kuptimin penalo-juridik dhe nuk mund të ndëshkohet po që se ato nuk manifestohen në botën e jashtme. Për tu konsideruar një veprim relevant në të dr. penale, ai duhet të jetë i vullnetshëm. I vullnetshëm konsiderohet ai veprim i cili është ndërmarrë dhe dirigjuar nga ana e personit të vetëdijshëm dhe në bazë të vullnetit të lirë. Sipas së dr. penale nuk do të konsiderohen si veprim dhe nuk do të ndëshkohen sjelljet apo veprimet që ndërmerren apo shkaktohen pa vetëdije, rastësisht apo nënndikimin e dhunës apo kanosjes, psh., veprimi në gjumë, me ç' rast nëna ja zë frymën fongjës së vetë të posa lindur dhe e mbytë; apo personi duke ecur në trotuar për shkak të ngricës rrshqet dhe me atë rast i shkakton lëndim tjetrit që është gjendur pranë tij. Kurse personi vepron me vetëdije, përkundër vullnetit të tij, në rastin kur nën ndikimin e dhunës apo kanosjes detyrohet të ndërmarrë veprimin e caktuar, psh., kur personi A ja drejton revolën personit B, që është duke punuar në sportelin e bankës dhe në këtë mënyrë e detyron që t'ia dorëzojë të gjitha të hollat që gjenden në kasafortë. Në të dr. penale janë të rëndësishme vetëm ato veprime të njeriut të cilat i përgjigjen ndonjë veprimi të përcaktuar në figurën ligjore të veprës penale përkatëse. Kjo është në harmoni me parimet e ligjshmërisë së veprës penale.

¹² Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.66

¹³ ELEZI.I, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2008

Sipas kodit penal, vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim.¹⁴ Mënyrën ndërmjet të së cilës manifestohet veprimi i kryerjes së veprës penale, në të dr. penale njihen dy lloje të veprave penale: vepra penale të kryera me veprim dhe me mosveprim. Veprat penale të kryera me veprim – Në kuptimin penalo-juridik, veprimi është lëvizje trupore e vullnetshme e njeriut me të cilin kryhet vepra penale (psh., shkrepja me armë të vepra penale e vrasjes, marrja e sendit të huaj të vepra penale e vjedhjes, etj.). Me anë të veprave penale të kryera me veprim, apo siç quhen ndryshe, delikte komosive, cenohen normat penalo-juridike, të cilat e ndalojnë veprimin e caktuar. Këto norma ndryshe quhen norma prohibitive. Veprat penale të kryera me mosveprim – Veprat penale me mosveprim, apo siç quhen ndryshe delikte omisive, kryhen me mos ndërmarrjen apo abstenimin nga veprimi që ka qenë i detyruar ta ndërmarrë. Kjo mënyrë e kryerjes së veprës penale shprehet si qëndrim pasiv i njeriut me rrethanat e caktuara, për shkak të cilit qëndrim shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Si vepër penale e kryer me mosveprim është psh., mos dhënia e ndihmës mjeksore. Me veprat penale me mosveprim cenohen normat të cilat urdhërojnë apo obligojnë që të ndërmerret veprimi i caktuar. Këto norma quhen norma imperative apo perceptive.

Sipas përkufizimit ligjor rezulton se veprat penale me mosveprim mund ti kryejnë vetëm ata persona që sipas ndonjë baze juridike kanë pasur obligim apo detyrë që ti ndërmarrin veprimet e caktuara, psh., është obligim ligjor që prindëritë të kujdesen, ti edukojnë dhe ti mbajnë fëmijët e tyre, nëse këtë obligim nuk e përmbushin, atëherë mund të shprehet vepra penale e shkeljes së detyrimeve familjare. Veprat penale të kryera me mosveprim mund të ndahen në dy grupe: në vepra penale të drejta të kryera me mosveprim dhe në vepra penale jo të drejta të kryera me mosveprim. Veprat penale të drejta të kryera me mosveprim – Janë ato lloje të veprave penale të cilat edhe në kodin penal janë përcaktuar se mund të kryhen vetëm me mosveprim, psh., mos dhënia e ndihmës personit, jeta e të cilit gjendet në rrezik të drejtpërdrejtë. Veprat penale jo të drejta të kryera me mosveprim – Janë ato vepra të cilat zakonisht kryhen me veprim, mirëpo në disa raste mund të kryhen edhe me mosveprim, psh., vepra penale e vrasjes, zakonisht kryhet me veprim, mirëpo mund të kryhet edhe me mosveprim në rastin kur e ëma me

¹⁴ ELEZI.I, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2008

qëllim që ta privojë nga jeta fëmijën e vetë nuk i jep ushqim dhe kështu fëmija vdes. Në këtë rast është fjala për veprë penale me veprim, e cila është kryer me mos veprim.¹⁵

2.3 Nocioni i rrezikut shoqëror

Secila veprë më të cilën cenohet dhe rrezikohet pasuria e mbrojtur individuale ose shoqërore), ose vlerat e rëndësishme më të madhe, është veprë e rrezikshme shoqërore. Rreziku shoqëror realizohet duke shkaktuar pasoja në objekt të veprimit të ndërmarr me veprë njerëzore, ajo është përfshirë në efektet e veprimit dhe pasojës dhe bënë përmbajtjen sociale të veprës penale. Praktikisht përmes rrezikut shoqëror paraqitet përmbajtja me vlerë të veprës së kryer penale. Ky është element material i veprës penale i cili mbështetet në sjellje reale të kryesit të veprës i cili tregon raportin në mes veprës së ndërmarr dhe pasojës së realizuar. Pa ekzistimin e rrezikut shoqëror nuk ka veprë penale. Do të thotë vepra penale mund të ekzistojnë vetëm nëse ajo është veprë e rrezikshme shoqërore. Ky element i përgjithshëm i nocionit të veprës penale nuk është i përcaktuar në ligjin e përkohshëm të Kosovës por mund të themi se nuk ka veprë penale e cila nuk është në të njëjtën kohë e rrezikshme për shoqërinë sepse është e drejtuar në lëndim ose kërcënim të lirive personale dhe drejtave të njeriut , drejtave tjera dhe vlerave shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me kushtetutë , drejtën kombëtare gjegjësisht rendin juridik. Sipas mendimit tonë , rreziku shoqëror është element i pavarur.¹⁶

Ajo nuk është përbërë në elementin e kundër ligjësisë por në veprë penale si akt material në botën e jashtme. Rreziku shoqëror nuk është kategori abstrakte e cila është e përhershme dhe nuk është e ndryshueshme. Përkundrazi ajo është dukuri shoqërore reale dhe si e tillë historike dhe kushtëzuar në mënyrë klasore.¹⁷ Do të thotë se ajo është kategori e ndryshueshme varësisht nga kushtet konkrete të jetës së bashkësisë së caktuar shoqërore. Kështu që veprat të cilat kanë qenë të rrezikshme shoqërore në një epokë në tjetrën nuk janë. Madje dhe në të njëjtën shoqëri rreziku shoqëror ndryshon varësisht prej zhvillimit të kësaj shoqërie prej etapës në etapë. Kështu në një etapë disa vepra mund të jenë të rrezikshme për shoqërinë dhe anasjelltas.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ I. Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë 2010, fq 230

¹⁷ S.Spiro., Cikël leksionesh, “Nocioni i veprës penale, elementët përbërës të saj”, UET, Tiranë 2008, Fq 1

Prej kësaj del se veprë e rrezikshme shoqërore është vetëm ajo veprë e cila është e rrezikshme për shoqëri të caktuar në kohën e caktuar. Veprat e rrezikshme shoqërore duhet të dallohen prej veprës së rrezikshme. Do të thotë se në shoqëri ekziston një varg i tërë i veprave të cilat janë të rrezikshme për sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë, dhe sipas kësaj të dëmshme, por të cilat nuk konsiderohen si vepra të rrezikshme shoqërore se janë në të njëjtën kohë dhe të dobishme, kështu që dobia shoqërore nga kryerja së këtyre veprave është shumë ma e madhe, se rrezikshmëria dhe dëmi i tyre. Por çdo veprë e rrezikshme shoqërore nuk është në të njëjtën kohë dhe veprë penale. Për të qenë veprë e rrezikshme shoqërore, vepra penale duhet të jetë e paraparë në ligj si veprë penale, dhe nëse është caktuar për kryesin e kësaj veprë sanksioni penal. Prej kësaj rrjedh se nuk është çdo veprë e rrezikshme shoqërore veprë penale , dhe se çdo veprë penale nuk është e rrezikshme shoqërore. Vepra penale e cila humb karakterin e veprës së rrezikshme shoqërore pushon të jetë veprë penale. Nëse vepra e tillë mbetet inkriminuese në ligj , ajo ka vetëm karakter formal juridik të veprës penale. Rreziku i përgjithshëm shoqëror i veprës është rreziku të cilin e posedon një veprë penale në raport me veprën tjetër penale si pr. sh: spiunazhi, hajnia, falsifikimi i të hollave, dhe tj.

Veprat penale kanë rrezik të ndryshëm për shoqëri, duke marr parasysh se janë të drejtuara në të mirat e vlerave të ndryshme për bashkësinë shoqërore. Sipas rrezikut të përgjithshëm shoqëror ligjdhënësi përcakton llojin dhe masën e dënimit për secilën veprë penale në pjesën e posaçme të ligjit penal.¹⁸ Do të thënë atë e përcakton ligjdhënësi në bazë të vlerësimit abstrakt të rëndësisë së objektit të mbrojtjes dhe vëllimit dhe intensitetit të mundshëm të pasojës. Rreziku i veçantë shoqëror ekziston në format konkrete të paraqitjes së veprës së njëjtë penale. Rrezikun e veçantë shoqëror e përcakton gjykata në secilin rast konkret në bazë të pasojave reale dhe të shkaktuara në mënyrë direkt. Rëndësia e rrezikut të veçantë shoqëror pasqyrohet në atë se ai tregon në diferencat të cilat ekzistojnë në mes të shumë veprave të kryera të kualifikimit të njëjtë (gjegjësisht, llojit të njëjtë si pr. sh: vrasje, hajni ose përvetësim). Rreziku i veçantë shoqëror është i rëndësishëm për peshimin (matjen) e dënimit, e vetëm në raste të jashtëzakonshme për ekzistimin e veprës penale.¹⁹

¹⁸ I. Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë 2010, fq 230

¹⁹ S.Spiro., Cikël leksionesh, “Nocioni i veprës penale, elementët përbërës të saj”, UET, Tiranë 2008, Fq 1

2.4 Kundërligjshmëria

Përcaktimi i kuptimit të veprës penale është një ndër detyrat kryesore të legjislacionit penal dhe të shkencës së të drejtës penale. Do të thotë, përcaktimi i nocionit të veprës penale, ipërgjegjësisë penale dhe i sanksioneve penale përbëjnë tre çështje kryesore të cilat i shqyrton edhe drejta penale. Në rradhën e ketyre tre çështjeve, vepra penale zë vëndin e parë sepse vepra penale shërben si bazë për përgjegjësinë penale. Kur ligjvënësi parashikon një fakt si vepër penale ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Bëhet fjalë për të mira juridike, të cilat mund të jenë të drejta personale të individit, por edhe interesa të tij apo të shoqërisë.²⁰ Vepra penale konsiderohet si fenomen juridik apo fakt juridik, i cili shkakëton pasoja juridike të jashtëme. Pra, me vepër penale në aspektin formal do të kuptojmë atë sjellje të cilat me ligj është sanksionuar si vepër penale. Sipas këtij përkufizimi, nuk shqyrtohet se vepra penale është vepër penale kundër moralit dhe shoqërisë, por vetëm nëse ajo është e kundërligjshme. Një përkufizim i tillë nuk parashikon se për cilat shkaqe kjo sjellje konsiderohet vepër penale, por e lidh vetëm me atë që kjo sjellje duhet të jetë e kundërligjshme. Përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore ligjvënësi e bën në bazë të kushteve objektive të shoqërisë. Vlerësimi, nëse një veprim apo mosveprim paraqet rrezikshmëri shoqërore, bëhet duke u nisur nga interesat e kësaj shoqërie. Nga këto nocione të veprës penale vihet re se kuptimi formal e shpjegon faktin vetëm në aspektin juridik formal. Kurse, nocioni material, jep përgjigje se për çfarë shkaqesh një vepër konsiderohet vepër penale, arësyet se përse ai veprim është i dëmshëm. Të marra në mënyrë të shkëputur, këto dy teori, nuk e përcaktojnë në mënyrë adekuate dhe në tërësi nocionin e veprës penale. Si konkluzion, mund të thuhet se vepra penale përkufizohet vetëm nëse merren parasysh elementët formal dhe material të saj.²¹ Një veprim ose mosveprim si element përbërës i veprës penale që të jetë i kundërligjshëm duhet të vijë në kundërshtim me normat dhe rendin juridik, pra duhet të jetë në kundërshtim me ligjin. Kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e veprës penale. Në asnjë rast, veprimi ose mosveprimi, nuk mund të përbëjë vepër penale pa u parashikuar shprehimisht në ligj një gjë e tillë. Përkufizimi për kundërligjshmërinë e veprës rezulton nga përshkrimi që ibëhet veprës nga norma e caktuar.

²⁰ F. Mantovani, Diritto Penale, parte generale, Padova, 2007, fq. 100

²¹ V. Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme. Shkup 2010, fq. 123

Vepra mund të jetë e kundërligjeshme, por jo gjithmonë mund të përbëjë një vepër penale. Ajo mund të jetë shkelje administrative ose civile. Përshëmbull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor mund të përbëjë kundravajtje administrativenëse nuk ka sjellë pasojat e parashikuara me ligj. Ajo mund të përbëjë vepër penale dhe ka sjellë donjëriën prej pasojave, që parashikohen në dispozitën e nenit 290 të Kodit Penal.²² Që të jetë i kundërligjshëm veprimi ose mosveprimi, duhet të parashikohet nga normajuridike-penale. Kërkesa e kundërligjshmërisë, buron nga parimi i ligjshmërisë, i parashikuar nënenin 2 të Kodit Penal se “askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është parashikuar shprehimisht me ligj si krim ose kundërvajtje penale”. Parim ky i shprehur edhe me shprehjen :“Nullum crimen sine lege”, “Nullum poena sine crimen”²³ Kundërligjshmëria, sipas brendësisë së saj, është e natyrës objektive. Kjo përcaktohet duke vënë në relacion veprimin ose mosveprimin e individit me normat e së drejtës penale. Kështu, në të gjitha rastet kur sjellja e njëriut është në kundërshtim me normat e legjislativitetit penal, të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim, mund të konstatojmë se sjellja e njëriut është e kundërligjeshme. Mirëpo, kundërligjshmëria, edhe pse sipas natyrës së saj është komponent i natyrës objektive, në disa raste ajo përmban edhe elementë subjektive. Si shëmbull mund të merret neni 247 i Kodit Penal sipas të cilit “mbajtja pa të drejtë e uniformës, e njëdokumenti apo e një shenje dalluese që tregojnë cilësinë e një punonjësi që kryen detyrështetërore apo një shërbim publik”. Në kuadër të këtij paragrafi kemi kundravajtje penale dhedënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet, por nëse kjo mbajtje e uniformës është bërë me qëllim fitimi ose ka prekur liritë apo të drejtat e shtetasve përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.²⁴ Një veprim ose mosveprim si element përbërës i veprës penale që të jetë i kundërligjshëm duhet të vijë në kundërshtim me normat dhe rendin juridik, pra duhet të jetë në kundërshtim me ligjin. Kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e veprës penale. Në asnjë rast, veprimi ose mosveprimi, nuk mund të përbëjë vepër penale pa u parashikuar shprehimisht në ligj një gjë e tillë. Përkufizimi për kundërligjshmërinë e veprës rezulton nga përshkrimi që i bëhet veprës nga norma e caktuar. Vepra mund të jetë e kundërligjeshme, por jo gjithmonë mund të përbëjë një vepër penale.

²² Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet më” nëse nuk janë sjellë këto pasoja atëherë nuk jemi përpara kësaj figure krimi, edhe nëse jemipëballë shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor por nuk ka ardhur pasoja, personi do të përgjigjet administrativisht

²³ V. Kambovski., E Drejta Penale, Pjesë e Pergjithshme, Shkup 2010, Fq.201

²⁴ Po aty.

Ajo mund të jetë shkelje administrative ose civile. Përsëmbull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor mund të përbëjë kundravajtje administrativenëse nuk ka sjellë pasojat e parashikuara me ligj. Ajo mund të përbëjë veprë penale dhe ka sjellëndonjëerën prej pasojave, që parashikohen në dispozitën e nenit 290 të Kodit Penal.²⁵

2.5 Faji

Për fajin është e parëndësishme gjendja e papërgjegjshmërisë para ose pas kryerjes së veprës penale por ajo që ka rëndësi është vullneti i lirë i personit në momentin që kryen veprën penale, në bazë të nenit 17 të Kodit Penal. Faji është element i domosdoshëm i figurës së veprës penale të përgjithëshme, sepse fajiështë një nga shtyllat kryesore mbi të cilën mbështetet sistemi i së drejtës penale. Veprë penale, faj, denim. Por, nëse nocioni i tillë i fajit largohet nga ky sistem, bëhet problematik dhe vetënocioni i veprës penale, i cili në atë rast nuk do të duhej të koncentrohet në veprimin e njeriutdhe shkakëtimin e cënimit të marrëdhënieve shoqërore të mbrojtura nga ligji penal. Nuk ka veprëpenale, nuk ka dënim pa faj(nullum crimen, nulla poena, sine culpa) Gjykimi për fajin është gjykim konkret, i përqendruar në aftësinë e kryesit për faj në kohën e kryerjes së veprës dhe në lidhje me veprën penale konkrete. Kjo duhet të interpretohet si kusht që vepra penale të paraqitet si pasojë e drejtpërdrejtë e sëmundjes psikike, e çrregullimit apo zhvillimit të prapambetur.

Që kryerja e veprës penale në gjendje të papërgjegjshme të ketë rëndësi nevojitet konstatimi i lidhjes shkak-pasojë ndërmjet gjendjes së tillë dhe veprës së kryer. Vetëm atëherë mund të flasim për kryerje të veprës penale.Neni 17 i Kodit Penal i cili i referohet kohës së kryerjes së veprës penale ka një kuptim të dyfishtë.²⁶ Më saktë neni 18 parashikon se : “Faji penal konsiderohet i kryer kur autori ka vepruar ose detyrohej të vepronte pa marrë parasysh kohën që ka ndodhur pasoja e veprës penale”. Parashikim që nuk parashikohet në kodin penal aktual, duke ia lënë doktrinës dhe praktikës përcaktimin e saj në aplikimin e instituteve të

²⁵ Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë tëdisa personave, dënohet më” nëse nuk janë sjellë këto pasoja atëhere nuk jemi përpara kësaj figure krimi, edhe nëse jemipërballë shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor por nuk ka ardhur pasoja, peroni do të përgjigjet administrativise

²⁶ Kambovski Vllado, E drejta penale. Pjesa e përgjithshme, Furkan, 2010, fq. 260

ndryshme. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1950, në lidhje me veprimin në kohë të ligjit penal nuk parashikon asnjë dispozitë në dallim me dy statutet e para që analizuar më sipër. Aty sanksionohet vetëm parimi i ligjshmërisë i cili garanton mosdënueshmërinë e personit i cili nuk ka kryer faj (vepër penale) dhe dënime të cilat duhet të jepen vetëm në bazë të ligjit, pasi ashtu siç shprehet edhe dispozita kushtetuese: Dënimet nuk mund të caktohen dhe të jepen veçse në bazë të ligjit. Duket mëse e qartë që, vakume të tilla ligjore, aq më shumë në rang kushtetues, çënojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në një plan krahasues këto garanci ecin me hapa prapa vetëm në lidhje me atë që parashikohet shprehimisht në ligj dhe jo më të analizohet zbatimi konkret i tyre. Për më tepër Kodi Penal i viti 1952 në parashikimet e tij shkel një sërë parimesh të cilat komprometojnë dukshëm dhënien e drejtësisë dhe hapin rrugë për vendime diskrecionale, subjektive të gjykatave²⁷ Në përkufizimin i cili u dha për veprën penale, përveç kundërligjshmërisë dherrezikshmërisë shoqërore, si element të përbashkët me figurën e veprës penale, është edhe faji. Realizimi i figurës së veprës penale, në mënyrë të kundërligjshme nuk është mjaftueshëm që aiveprim të trajtohet si vepër penale në kuptimin objektiv. Por, për të drejtën penale është ipranueshëm nocioni objektiv-subjektiv. Për të ekzistuar vepra penalenuk mjafton vetëmrealizimi i figurës së veprës penale, është i nevojshëm edhe faji nga ana e autorit. Faji paraqet nëvetvete qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës shoqërisht të rrezikëshme që vijnë apomund të vijnë prej saj, të kundërligjshme dhe pasojës së dëmshme.

Faji shprehet ne formën edashjes ose të pakujdesise. Në të drejtën penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes se veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse të ai ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar psikike ndaj veprës të cilën e ka kryer, dmth., ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjësia penale është vetëm element subjektiv apo psikik i veprës penale. Ky është njëherit kuptim i ngushtë i përgjegjësisë penale. Në teorinë e se dr. penale njihet edhe kuptimi i gjerë apo kuptimi objektiv-subjektiv i përgjegjësisë penale. Sipas këtij kuptimi përgjegjësia penale përbëhet prej veprës penale si element objektiv dhe përgjegjësisë dhe fajësisë si elemente subjektive.²⁸

²⁷ Neni 3 i Kodit Penal te vitit 1952 parashikon: “Kur një vepër penale e rrezikshme nuk është parashikuar drejtpërdrejt nga ligja, baza dhe kufijtë e përgjegjësisë penale që parashikojnë krime të një natyre sa më të ngjashme. Analogjia zbatohet në raste të jashtëzakonshme”

²⁸ Po aty.

Përgjegjësia penale është e përafërt me fajin. Në të drejtën penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse të ai ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar psikike ndaj veprës të cilën e ka kryer, dmth., ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjësia penale është vetëm element subjektiv apo psikik i veprës penale. Ky është njëherit kuptim i ngushtë i përgjegjësisë penale. Në teorinë e së dr. penale njihet edhe kuptimi i gjerë apo kuptimi objektiv-subjektiv i përgjegjësisë penale. Sipas këtij kuptimi përgjegjësia penale përbëhet prej veprës penale si element objektiv dhe përgjegjësisë dhe fajësisë si elemente subjektive.

2.6 Figura e e veprës penale si parakusht i përgjegjësisë penale

Momenti i lindjes së marrëdhënieve juridiko-penale është momenti i kryerjes së veprës penale. Që nga ky moment lind edhe përgjegjësia për personin që e ka kryer atë. Pra ajo bashkëekziston dhe është një kusht për lindjen dhe vazhdimin e këtyre marrëdhënieve. Për rjedhojë me mbarimin e përgjegjësisë penale merr fund edhe ekzistenca e marrëdhënieve juridiko-penale. Për të pasur përgjegjësi penale është e nevojshme që të vërtetohen një tërësi elementësh objektivë e subjektivë dhe të mos ndodhemi në një nga rastet e përjashtimit nga përgjegjësia penale. Të gjitha legjislacionet penale njohin përgjegjësinë subjektive domethënë që penalisht përgjigjet vetëm personi i cili e ka kryer veprën penale.

Në këtë drejtim e drejta penale dallohet nga e drejta civile, e cila në raste të caktuara njeh edhe përgjegjësinë objektive, përgjegjësi që personat kanë edhe në rastin kur ata nuk e kanë kryer veprimin ose mosveprimin që ka sjellë cënimin e të drejtave të personave të tjerë pra edhe në rastin kur ata nuk kanë qenë subjekte të marrëdhënies. E drejta zakonore shqiptare gjithashtu njeh përgjegjësinë objektive. Kështu persona të caktuar dhe në raste të veçanta e gjithë familia ose deri edhe fisi mund të ishin përgjegjës personalisht apo materialisht për veprimet e kryera nga një antar i saj. Këtu fare mirë mund të përmendim rastin e gjakmarrjes, e cila shtrihej jo vetëm mbi dorërasin që ishte personi që kishte kryer vrasjen por edhe mbi çdo mashkull të fisit të tij të familjes së tij.

Kjo pasqyrohet në dispozitën kanunore “*gjaku shkon për fis*”,²⁹ e cila është shprehje e parimit të përgjegjësisë objektive. Me figurë të veprës penale kuptojmë tërësinë e elementëve objektivë e subjektivë të veprës penale të marra sëbashku.³⁰ Siç thamë për të pasur përgjegjësi penale është e domosdoshme që të plotësohen disa elementë objektivë e subjektivë, të cilët janë pikërisht elementët e figurës së veprës penale. Në qoftë se edhe njëri prej këtyre elementëve të figurës së veprës penale do të mungonte atëherë nuk do të kishim përgjegjësi penale.

Konceptet e veprës penale dhe të figurës së veprës penale megjithëse të ngjashme me njëri-tjetrin nuk duhet të njësohen. Figura e veprës penale është forma juridike në të cilën shfaqet vepra penale konkrete.³¹ Një dallim i tillë duhet të bëhet edhe më tepër nga fakti se për një veprë penale mund të kemi disa figura veprash penale. Kështu për krimin e vrasjes, në kodet penale ekzistojnë disa norma që parashikojnë figura të ndryshme të vrasjes, si: vrasje me paramendim, vrasje me dashje, vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit, vrasje nga pakujdesia etj, ose për veprën penale të vdhjedhjes: vjedhje me mashtrim, vjedhje nëpërmjet shpërdorimit të detyrës, vjedhje me armë etj. Nga ana tjetër në një normë penale mund të parashikohen disa figura veprash penale si psh: vjedhja me pasojë vdekjen, tortura dhe çdo akt tjetër çnjerëzor etj.

Elementët e figurës së veprës penale janë: *1. objekti, 2. ana objektive, 3. subjekti dhe 4. ana subjektive.*

1. Objekti.

Me objekt të veprës penale kuptohen marrdhëniet juridike si lloj i marrdhënieve shoqërore, të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e të mirave juridike apo vlerave të rëndësishme të personit, të shoqërisë apo edhe të shtetit, që preken ose vihen në rrezik nga veprat penale, e që mbrohen posaçërisht nëpërmjet normave penale.³² Ashtu siç u theksua, ndarja kryesore e veprave penale bëhet pikërisht duke u bazuar në objektin e veprës penale.

Në teorinë e së drejtës penale njihen tre lloj objektesh:

- a) objekt i përgjithshëm
- b) objekt grupor ose i veçantë

²⁹ Kërkime mbi kanunin e Skënderbeut – Cani. Xh, fq.128

³⁰ E drejta zakonore penale e shqiptarëve – vep cit, fq.106

³¹ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – Elezi. I, Kaçupi. S, Haxhia. M, fq.89

³² Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq.90

c) objekt i drejtpërdrejtë

- a) Me objekt të përgjithshëm të veprave penale kuptohet tërësia e marrdhënieve juridike, të vendosura për të siguruar personin, shoqërinë apo edhe shtetin, të mbrojtura posaçërisht nga normat penale.³³ Objekti i përgjithshëm i veprave penale përfshin në vetvete objektet grupore dhe të drejtpërdrejta të tyre.
- b) Me objekt grupor ose të veçantë të veprave penale kuptohen ato marrdhënie juridike, të vendosura, që kanë karakteristika të përbashkëta apo të ngjashme dhe konkretizojnë në grupe objektin e përgjithshëm të veprave penale, që preken prej tyre dhe që vihen në mbrojtje të posaçme nga normat penale.³⁴ Për shembull veprat penale kundër personit kanë për objekt marrdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e personit, ato kundër pronës marrdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtën e pronës etj.
- c) Me objekt të drejtpërdrejtë të veprës penale kuptohet marrdhënia juridike konkrete, ajo e mirë juridike apo vlerë shoqërore e rëndësishme, që preket prej saj, e që mbrohet posaçërisht nga normat penale.³⁵ Objekti i drejtpërdrejtë i veprës penale të vrasjes p.sh janë marrdhëniet juridike, të vendosura për të siguruar jetën e personit, në plagosje shëndetin e tij, në fyerje nderin e dinjitetin etj. Nga objekti i veprës penale, si marrdhënie juridike që preket prej saj, në çdo rast duhet të dallohet objekti material, që është sendi konkret kundër të cilit drejtohet vepra penale. Kështu në veprën penale të vjedhjes objekti material janë sendet që një person zotëron në një moment të caktuar ndërsa objekti i veprës penale janë marrdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e pronës domethënë të drejtën e pronës.

2. *Ana objektive.*

Ana objektive e veprës penale është tërësia e veprimeve ose mosveprimeve shoqërisht të rrezikshme dhe të kundërligjshme, të cilat vënë në rrezik ose çënojnë të mirat juridike. Elementët e anës objektive të veprës penale janë: a) veprimi ose mosveprimi, b) pasoja, c) lidhja shkakësore, d) mënyra e kryerjes së veprës penale dhe e) koha, vendi dhe ambienti i kryerjes së veprës penale.

³³ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq.91

³⁴ Po aty, fq.92

³⁵ Po aty, fq.92

a) Veprimi ose mosveprimi.

Pothuajse të gjithë legjislacionet nga ana objektive i njohin të dyja format e kryerjes së veprës penale, si me veprim ashtu edhe me mosveprim. Me veprim në kuptimin juridiko-penal kuptohet ajo sjellje e një njeriu të caktuar, që shfaqet në botën e jashtme, që përbën element të domosdoshëm të veprës penale.³⁶ Ndërsa me mosveprim kuptohet moskryerja e atyre veprimeve apo qëndrimi pasiv i personit, i cili ishte i detyruar t'i kryente, të vepronte dhe si rrjedhojë e këtij qëndrimi, është shkaktuar pasoja e dëmshme.³⁷ Edhe sipas të drejtës zakonore shqiptare njiheshin të dyja format e kryerjes së veprës penale. Kështu me veprime aktive kryheshin vepra të tilla penale si vrasja, plagosja, vjedhja etj, ndërsa me mosveprim mund të kryhej p.sh vrasja e foshnjës.

b) Pasoja.

Një element tjetër i rëndësishëm i anës objektive të veprës penale është edhe pasoja. Me pasoja të veprës penale kuptohen ndryshimet që ndodhin nga veprimi ose mosveprimi i paligjshëm i personit dhe që prekin ose cenojnë marrdhëniet juridike të mbrojtura posaçërisht me norma penale.³⁸ Që një person të ketë përgjegjësi penale, nuk është e domosdoshme që në çdo rast të jetë vërtetuar ardhja e pasojës. Pra vepra penale mund të mbetet në tentativë dhe personi të ketë përsëri përgjegjësi penale. E drejta zakonore shqiptare gjithashtu njeh rastin kur personi mban përgjegjësi penale edhe kur nuk kanë ardhur pasojat. Për shembull në kanunin e Lekë Dukagjinit në një dispozitë parashikohet "*pushka e nisun ka gjobë*".³⁹

c) Lidhja shkakësore.

Lidhja shkakësore është një tjetër element i anës objektive, e cila është përcaktuese për ekzistencën e përgjegjësisë penale. Kështu mungesa e lidhjes shkakësore pasjell mungesën e përgjegjësisë penale. Ajo konsiston në lidhjen e domosdoshme e të drejtpërdrejtë ndërmjet veprimeve e mosveprimeve dhe pasojës së ardhur. Këtu duhet të mbajmë parasysh se lidhja shkakësore nuk ekziston ndërmjet çdo veprimi ose mosveprimi dhe pasojës. Ajo realizohet

³⁶ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq.93

³⁷ Po aty, fq.95

³⁸ Po aty, fq.106

³⁹ E drejta zakonore shqiptare 1 – vep cit, fq. 321

vetëm ndërmjet veprimit ose mosveprimit që ka qënë shkaku përcaktues dhe pasojës. Edhe e drejta zakonore shqiptare njeh ekzistencën e lidhjes shkaksore si kusht për përgjegjësinë penale.

d) Mënyra e kryerjes së veprës penale.

Mënyra e kryerjes së veprës penale si element i anës objektive të veprës penale, nënkupton renditjen e veprimeve, metodave dhe mjeteve të përdorura, karakteri kronologjik dhe veçoritë e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale.⁴⁰ Mënyra e kryerjes së veprës penale është një element që veç të tjerëve jo vetëm bën dallimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të njëjta por që gjithashtu shërben për cilësimin e saktë ligjor të veprës. Edhe po ti referoheshim kanuneve shqiptare, mënyra e kryerjes së veprës penale në disa raste shërben për të dalluar veprat penale të ngjashme dhe që kanë objekt të njëjtë si p.sh vjedhjen e thejshtë nga grabitja.

e) Vendi koha dhe ambienti i kryerjes së veprës penale.

Vendi koha dhe ambienti i kryerjes së veprës penale janë gjithashtu elementë të anës objektive të veprës penale. Me vend, kohë dhe ambient të kryerjes së veprës penale, kuptohet tërësia e kushteve konkrete të marra së bashku, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm dhe shoqërisht i rrezikshëm, zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjen pasoja e dëmshme.⁴¹ Por vendi, koha dhe ambienti i kryerjes së veprës penale, në ndryshim nga elementët e tjerë të anës objektive të veprës penale, në shumicën e rasteve janë dytësorë dhe jo të domosdoshëm për çdo figurë vepre penale. Ato mbahen parasysht për të përcaktuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore si dhe për të individualizuar dënimin nga gjykata. Megjithatë në të drejtën zakonore, vendi i kryerjes së veprës penale në disa raste shërben edhe për të individualizuar figurën e veprës penale, si p.sh fyerja e bërë në kuvend.

3. *Subjekti.*

Me subjekt të veprës penale kuptohet njeriu, personi fizik, i cili ka mbushur moshën e caktuar për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm.⁴² Pra për të qënë subjekt i veprës penale kërkohet përmbushja e njëkohëshme e tre kushteve:

a. personi të ketë kryer një vepër penale

⁴⁰ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq. 108

⁴¹ Po aty, fq. 109

⁴² Po aty, fq. 97

- b. të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale
- c. të jetë i përgjegjshëm domethënë të jetë i aftë për të kontrolluar veprimet e tij.

Subjektet e veprës penale ndahen në subjekte të përgjithshëm dhe subjekte të posaçëm. Subjektet e përgjithshëm janë ata që plotësojnë kushtet e mësipërme ndërsa subjektet e posaçëm të veprës penale janë personat që kanë disa cilësi konkrete, të veçanta dhe i përdorin ato për kryerjen e veprës penale si dhe vepra penale që kryhet të kërkojë përdorimin e këtyre cilësive. Në këtë mënyrë për subjektet e posaçëm kërkohet të plotësohet edhe një kusht i katërt. Subjektet e veprave penale ndahen gjithashtu në subjekte aktivë dhe subjekte pasivë. Subjekte aktivë janë personat që kryejnë veprën penale ndërsa subjektet pasivë personat që dëmtohen apo janë viktimë e veprës penale. Edhe sipas normave penale të së drejtës tonë zakonore njiheshin dy kategoritë e subjekteve, subjektet e përgjithshëm dhe të posaçëm. Për sa i përket subjekteve të përgjithshëm, ata kanë po ato karakteristika që u përmendën më lart ndërsa në lidhje me subjektet e posaçëm, mund të përmendim pleqtë në rolin e gjyqtarëve, për veprën penale të dhënies së drejtësisë me krahubajtje apo betarët për be të rreme. Ndërsa në lidhje me klasifikimin e dytë në subjekte aktivë dhe pasivë vlen të përmendet se sipas të drejtës zakonore subjekti pasiv në disa raste bëhej element përcaktues për kualifikimin ligjor të veprës penale. Kështu tek vrasjet në familie subjekt pasiv mund të ishin vetëm pjestarët e families si nëna, babai, vëllai, djali, kunata etj. Nëse vepra do të drejtohej ndaj një subjekti tjetër, të ndryshëm nga pjestarët e families atëherë vepra do të kualifikohej në bazë të ndonjë dispozite tjetër.

Në lidhje me moshën për përgjegjësi penale, legjislacionet mbajnë qëndrime të ndryshme për sa i përket pragut. Gjithashtu kjo moshë në disa raste ndryshon në lidhje me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Kështu kodi ynë penal parashikon moshën katërbëdhjetë vjeç për krimet dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç për kundërvajtjet penale. Pragu i moshës për përgjegjësinë penale lidhet me aftësinë e njeriut për të kontrolluar dhe drejtuar veprimet e tij. E drejta zakonore shqiptare nga ana e saj nuk përcakton një kufi minimal të moshës për përgjegjësi penale. Ajo e lidhte këtë gjë me aftësinë për të mbajtur armë dhe kjo moshë në përgjithësi ishte rreth pesëmbëdhjetë vjeç. Në raste të veçanta kjo moshë mund të zbriste deri në dymbëdhjetë vjeç, siç ishte rasti i dëmtimit të pasurisë. Për një kategori veprash penale subjekte nuk mund të ishin as pleqtë, të cilët i kishin hequr armët. Në këtë drejtim e rëndësishme është të theksohet se nuk mund të mbanin përgjegjësi penale pra nuk mund të ishin subjekte të veprës penale gratë dhe klerikët. E drejta zakonore penale njih përgjegjësinë objektive dhe në përputhje me këtë, gratë

nuk përgjigjeshin për veprat penale që kryenin. Përgjegjësinë në këtë rast e mbanin prindërit ose burri i saj. Për shembull kur gruaja kryente vrasje, gjakmarrja binte mbi prindërit e saj ndërsa kur vidhte përgjegjës ishte burri dhe familia e tij. Kjo pozitë e gruas vjen nga fakti se ajo trajtohej si një subjekt me pak të drejta dhe për rrjedhojë edhe detyrime në marrëdhëniet juridike në përgjithsi. Klerikët gjithashtu nuk mund të ishin përgjegjës për një vepër penale të kryer nga ana e tyre për faktin se ata konsideroheshin të paprekshëm. Përgjegjësinë për veprimet e tyre e mbanin familiarët. Të papërgjegjshëm konsideroheshin edhe personat të cilët vuanin nga sëmundje mendore që i bënin të paaftë për të kuptuar veprimet e tyre ose siç thuhej në gjuhën e kanuneve, të marrët.

4. *Ana subjektive.*

Ana subjektive është elementi i fundit i figurës së veprës penale. Elementët përbërës të anës subjektive të veprës penale janë: a) faji, b) motivet dhe c) qëllimi.

a) Faji.

Me faj kuptohet qëndrimi psikik që mban personi ndaj veprimit ose mosveprimit të tij të paligjshëm dhe pasojave të dëmshme që kanë ardhur si pasojë e këtyre veprimeve ose mosveprimeve.⁴³ Faji si element i anës objektive, përbëhet nga dy momente: momenti intelektual dhe momenti volitiv. Momenti intelektual ka të bëjë me aftësinë e personit për të parashikuar veprimet ose mosveprimet e tij dhe pasojën ndërsa momenti volitiv, me dëshirën e personit për t'i kryer këto veprime ose mosveprime dhe ardhjen e pasojës. Nga kombinimi i këtyre dy momenteve kemi format e ndryshme të shfaqjes së fajit. Në këtë mënyrë faji shfaqet në dy forma: në formën e dashjes dhe në formën e pakujdesisë.

Dashjen e kemi disa llojesh:

- 1) Dashje direkte, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre.⁴⁴
- 2) Dashje indirekte, kur personi megjithëse parashikon ardhjen e pasojës, nuk e dëshiron atë por me ndërgjegje lejon ardhjen e saj.⁴⁵

⁴³ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq. 112

⁴⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - neni 15

⁴⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - neni 15

Dashjen e kemi edhe në këto forma: dashje e përcaktuar dhe dashje e papërcaktuar si dhe dashje e paramenduar dhe dashje e menjëherëshme ose e atypëratyshme.⁴⁶

- a. Me dashjen e përcaktuar (dolus determinatus), fajtori parashikon ardhjen e një pasoje të caktuar, konkrete.⁴⁷
- b. Me dashjen e papërcaktuar (dolus indeterminatus), fajtori parashikon ardhjen e pasojave të dëmshme por jo të ndonjë pasoje të caktuar, konkrete dhe nuk lejon me vetëdije ardhjen e një pasoje të tillë konkrete.⁴⁸
- c. Dashja e paramenduar (dolus praemeditatus) është atëhere kur te personi mendimi për të kryer veprën penale lind mjaft kohë përpara se ajo të kryhet.⁴⁹
- d. Dashja e menjëherëshme, në gjaknxehtësi ose e atypëratyshme (dolus repentinus) është atëherë kur vepra kryhet me dashje të lindur aty për aty, në gjaknxehtësi e sipër.⁵⁰

Pakujdesia është forma tjetër e shfaqes së fajtit. Ekzistojnë dy lloje pakujdesish: në formën e vetëbesimit të tepruar dhe në formën e neglizhencës.

- 1) Pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar kemi atëherë kur personi e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme nga veprimet ose mosveprimet e tij por nuk e ka dëshiruar ardhjen e tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t'i shmangë ato.⁵¹
- 2) Neglizhenca është ajo formë pakujdesie në të cilën personi fajtor nuk e parashikon ardhjen e pasojave megjithëse në kushtet e dhëna ishte i detyruar dhe mundej t'i parashikonte ato.⁵²

Nëse do ti referoheshim dispozitave penale të kanuneve në lidhje me format e fajtisë, do të dallonim si veprat penale të kryera me dashje ashtu edhe ato me pakujdesi. E drejta zakonore shqiptare nuk ishte shumë e përpunuar në lidhje me format e fajtisë në raport me legjislacionet

⁴⁶ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq. 115

³² Po aty, fq. 115

⁴⁸ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq. 116

⁴⁹ Po aty, fq. 116

⁵⁰ Po aty, fq. 116

⁵¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - neni 16

⁵² Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - neni 16

bashkëkohore. Në këtë mënyrë përveç dy formave kryesore të fajsisë, ajo nuk njihet format e veçanta në të cilat shfaqëshin ato kryesore.

b) Motivet.

Motivet si elemente të anës objektive të veprës penale, janë shtytjet e brendshme, të cilat bëjnë që personi të kryejë vepra penale.⁵³ Motivet mund të shërbejnë si rrethana lehtësuese, rënduese ose edhe cilësuese për veprën penale.

c) Qëllimi.

Qëllimi është elementi tjetër i anës subjektive të veprës penale. Me qëllim kuptohet synimi që dëshiron të arrijë personi me anë të veprës penale.⁵⁴ Edhe qëllimi ashtu si motivet mund të shërbejë si rrethana lehtësuese, rënduese ose cilësuese. Motivët dhe qëllimi parashikoheshin edhe në kanune si rrethana cilësuese si p.sh vrasja për interes, e cila parashikon motivin si rrethana cilësuese apo vrasja për trashëgimi, që parashikon qëllimin.

2.7 Dallimet dhe ngjajshmëritë midis veprës penale dhe figures së veprës penale

Vepra penale është kategoria kryesore në sistemin e së drejtës penale. Vepra penale legjitimon të drejtën e ndëshkimit dhe përcakton gjerësinë e represionin penal-juridik, kurse nganocioni i saj nxirren edhe kategori të tjera themelore, si përgjegjësia penale dhe dënimi.⁵⁵ Për dallimin e figurës së veprës penale nga vepra penale, (si nocione juridiko-penale, megjithëse në lidhje të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshme njëri me tjetrin), në teorinë e së Drejtës Penale janë mbajtur dhe vazhdojnë të ekzistojnë qëndrime të ndryshme. Dallimi kryesor midis këtyre qëndrimeve, për mendimin tim, gjënden në faktin se, ndërsa për kuptimin e vetëveprës penale nuk janë të pakta kodet penale, që në njëërën apo tjetrën formë, shprehen për të; përfigurën e veprës penale nuk ndodh një gjë e tillë. Analiza e dallimit të figurës së veprës penale nga vepra penale, ka rëndësi të dyfishtë.

⁵³ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq. 117

⁵⁴ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – vep cit, fq. 118

⁵⁵ .Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme. Shkup 2010, fq 123

Rëndësia e saj qëndron, së pari në aspektin teorik, për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj dege të sëdrejtës, sidomos të pjesës së përgjithshme të saj. Nëpërmjet studimit të kuptimit të figurës së veprës penale, të elementëve përbërës të saj dhe llojet e figurave të veprave penale në përgjithësi, Drejta Penale përpunon kriteret teorike të cilat shërbejnë për të përcaktuar llojin dhe rrethin e veprave që duhet të mbrohen në mënyrë të posaçme nga shoqëria, nëpërmjet parashikimit të veprave, të cilat çënojnë apo vënë në rrezik ato, si vepra penale në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj.⁵⁶

2.8 Elementet përbërës të figurës së veprës penale

Kundërligjshmëria është element i përbashkët, përbërës, si për veprën penale, ashtu edhe për anën objektive të figurës së veprës penale. Në këtë element, gjen shprehje konkrete njëri prej parimeve kryesore të së Drejtës Penale, sikurse është parimi i ligjshmërisë, apo legalitetit. Thelbin e përbërjes së këtij parimi e përbën fakti sipas së cilit, që vepra, veprimi ose mosveprimi, të përbëjë element të veprës penale dhe të anës objektive të saj, nuk mjafton vetëm që të çënojë vlera të rëndësishme shoqërore, pra të jetë shoqërisht i rrezikshëm, por duhet të jetë edhe i kundërligjshëm. Për sa i përketanës së jashtme të veprës penale dhe figurës së saj, vepra me veprim ose mosveprim, përveçse të qenit shoqërisht e rrezikshme, duhet të jetë e parashikuar në një nga dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal në të cilat parashikohen të gjitha veprat, që konsiderohen vepra penale krime apo kundërvajtje penale.⁵⁷ Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ky parim gjen shprehje, më së miri në dispozitën e nenit 2 të Kodit Penal. Sikurse u përmend sipas kësaj dispozite, askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë, e cila më parë, nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale, si veprë penale, paragrafi i parë dhe askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të parashikuar në ligj, paragrafi i dytë. Ky parim plotësohet edhe me një parim tjetër i cili rrjedh prej tij, parimin e ligjit të kohës që gjen shprehje juridike në paragrafin e parë të dispozitës së nenit 3 të Kodit Penal.

⁵⁶ E Drejta Penale, Pjesa Përgjithëshme, Dr. Sh.Muçi, Tiranë 2007.

⁵⁷ S.Spiro., Cikël leksionesh, “Ana Objektive të Figurës së Veprës Penale”, UET, Tiranë 2008, Fq. 4

Sipas kësaj dispozite, askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale, që përbën rregullim². Kundërligjshmëria, konsiderohet se është e natyrës objektive. Kjo përcaktohet duke vënë në korrelacion veprimin ose mosveprimin e individit me normat e së drejtës penale, në të gjitha rastet kur sjellja e njeriut është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim atëherë mund të themi se sjellja e njeriut është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim atëherë mund të konstatojnë se sjellja e njeriut është e kundërligjshme. Sipas përkufizimit ligjor, kundërvajtjet janë cenime të rendit publik të përcaktuara me ligj dhe dispozita të tjera, për të cilat janë parashikuar dënime kundërvajtëse dhe masa mbrojtëse.⁵⁸ Veprat penale janë vepra të rrezikshme, kundërvajtjet janë cenime të rendit publik dhe si të tilla paraqesin cenime të disiplinës shoqërore³. Me anë të veprave penale cenohen apo dëmtohen vlerat themelore të individit dhe të shoqërisë, kurse me kundërvajtje cenohen vlerat më të vogla të individit dhe të shoqërisë. Në teori mbizotëron mendimi se kriteri kryesor për dallimin e veprave penale nga kundërvajtjet është shkalla apo intensiteti i rrezikshmërisë shoqërore.⁵⁹ Vepra penale është vepër e rrezikshme shoqërore, që rendi juridik e ndalon me kërcënim të aplikimit të sanksioneve penale. Ajo është rezultat i sjelljes të njeriut, kështu që mund të caktohet si sjellje e njeriut me të cilën shkelen dispozitat juridike dhe shkaktohen pasoja të dëmshme për shoqërinë, për çka edhe reagohet me aplikimin e sanksioneve penale. Si sjellje e njeriut, si akt i njeriut të caktuar, kjo bartë karakteristika të vetë personalitetit: kushteve të tij të jetës, konfliktit me vetvete, konfliktit me individë të tjerë, grupet shoqërore dhe shoqërinë në tërësi. Vepra penale është akt negativ i njeriut dhe i dëmshëm për shoqërinë. Ajo më së shpeshti paraqitet si rezultat u konflikteve ndërmjet individëve dhe interesave të tyre, individëve dhe shoqërisë, si mospajtim ndërmjet dëshirave, nevojave dhe mundësisë për përmbushjen e tyre, si rezultat i ndonjë tronditjeje ose si dalje nga kriza, përkatësisht si zgjidhje negative e ndonjë situatë konflikti ose situatë stresi. Ajo është më së shpeshti akt i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm, por mund të jetë edhe akt i pamatur, si dhe akt i projektimit të imagjinatës së sëmurë dhe halucinacionit, përkatësisht rezultat i sëmundjes ose çrregullimit shpirtëror. Vepra penale nuk është akt i njeriut, përkatësisht prodhim i njeriut, por njëkohësisht është edhe dukuri e shoqërisë. Kjo nuk është vetëm akt i rastësishëm dhe i izoluar,

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ S.Spiro., Cikël leksionesh, “Objekti I Figurës së Veprës Penale”, UET, Tiranë 2008, Fq. 6

por akt që përsëritet dhe e bën dukurinë, rrënjët e së cilës janë në kushtet shoqërore të njeriut. Jashtë shoqërisë njerëzore nuk ka veprë. Ajo është dukuri negative e shoqërisë, ngase me këtë akt sulmohen vlerat shoqërore dhe njerëzore dhe rrezikohet ekzistenca e shoqërisë si bashkësi njerëzish. Vepra penale si dukuri shoqërore lidhet me shoqërinë e klasave, sepse me krijimin e shoqërisë klasore, vepra penale si veprimtari kundër shoqërore bëhet dukuri ligjvënëse e kësaj shoqërie, e pandarë nga ajo dhe shoqërues i përhershëm i saj.

2.8.1 Objekti i figurës së veprës penale

Sipas mendimit tim me objekt të veprimit nënkuptojmë personin apo vlerën tjetër juridike ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes me ç'rast dëmtohet objekti që mbrohet nga e drejta penale. Vlera juridike ndaj së cilës është e drejtuar vepra penale paraqet objektin e veprimit p.sh te vrasja- objekti i veprimit është jeta e njeriut. ë shkencën e së drejtës penale objekti i veprimit ndahet në objektin Sulmues dhe Gramatik. Objekti Sulmues - është lënda ndaj së cilës është i drejtuar veprimi i veprës penale p.sh te vepra penale e vjedhjes objekti sulmues është prona në sendin e tundshëm, te vrasja është njeriu etj. Objekti Gramatik - është lënda në të cilën kryhet veprimi i veprës penale p.sh te vepra penale e falsifikimit të monedhave-objekt gramatik është monedha e falsifikuar. Veprat penale janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura me sistemin juridik të vendit dhe me të drejtën ndërkombëtare. Të mirat juridike që janë të mbrojtura me të drejtën penale janë edhe objekt i veprës penale. Objekt i veprës penale është e mira juridike ndaj të cilës është e drejtuar vepra penale. Objekt i veprës penale janë të mirat apo vlerat vitale të njeriut, të popullit të një vendi dhe të komunitetit ndërkombëtar.⁶⁰

Këto janë:

- Jeta e njeriut,
- Integriteti i tij trupor,
- Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut

⁶⁰ E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982.

Dhe

- Qytetarit,
- Siguria,
- Paqja,
- Barazia
- Prona,
- Rregullimi shoqërorë politik dhe siguria evendit,
- Martesa, familja, nderi autoritetitj.

Për shkak të rëndësisë së madhe që kanë këto vlera për shoqërinë dhe qytetarin, këto dhe vlerat e ngjashme janë të mbrojtura me të drejtën nacionale dhe të drejtën penale ndërkombëtare. Në të drejtën penale dallohen dy lloje të objektit të veprës penale dhe atë: objekti i përgjithshëm dhe grupor. E mira juridike si object i së drejtës penale na intereson së pari nga aspekti i mbrojtjet penalolo-juridike për arsye se e quajmë edhe object i mbrojtjes.⁶¹

2.8.2 Ana objektive e figurës së veprës penale

Kundërligjshmëria është element i përbashkët, përbërës, si për veprën penale, ashtu edhe për anën objektive të figurës së veprës penale. Në këtë element, gjen shprehje konkrete njëri prej parimeve kryesore të së Drejtës Penale, sikurse është parimi i ligjshmërisë, apo legalitetit. Thelbin e përbërjes së këtij parimi e përbën fakti sipas së cilit, që vepra, veprimi ose mosveprimi, të përbëjë element të veprës penale dhe të anës objektive të saj, nuk mjafton vetëm që të cenojë vlera të rëndësishme shoqërore, pra të jetë shoqërisht i rrezikshëm, por duhet të jetë edhe i kundërligjshëm. Për sa i përketanës së jashtme të veprës penale dhe figurës së saj, vepra me veprim ose mosveprim, përveçse të qenit shoqërisht e rrezikshme, duhet të jetë e parashikuar në një nga dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal në të cilat parashikohen të gjitha veprat, që konsiderohen vepra penale krime apo kundërvajtje penale. Ky parim është shumë i hershëm i së drejtës penale dhe prej kohësh është i shprehur në terminologjinë latine, *Nulla crimen sine lege*, nuk ka krim pa ligj, parim nga i cili rrjedhin edhe dy parime të tjera komplementare me të si;

⁶¹ S.Spiro., Cikël leksionesh, “Ana Objekti i Figurës së Veprës Penale”, UET, Tiranë 2008, Fq. 4

Nulla poena sine crimem, nuk ka dënim pa ligj dhe Nullum poena sine crimem, nuk ka dënim pa krim. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, me kalimin e viteve , me kalimin nga e drejta zakonore në të drejtën pozitive, shprehja Nullumcrimen sine lege, penalistët e kushtëzuan edhe me mbiemrin shtesë “scriptium”, duke e formuluar, Nulla crimesine lege scriptium, nuk ka krim pa ligj të shkruar.⁶²

Në doktrinën e së drejtës penale shqiptare, me pasoja të veprës penale kuptohen ndryshimet që ndodhin nga veprimi ose mosveprimi i paligjshëm i personit dhe që prekin apo cenojnë marrëdhëniet juridike të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.⁶³

Pasoja që vjen ose që mund të vijë nga kryerja e veprës penale, në literature juridike ka gjetur trajtim të gjerë dhe të gjithanshëm. Kjo, për shkak të rëndësisë që ajo paraqet si, nga pikëpamja teorike, për dallimin e figurave të veprave penale në figura materiale dhe formale në përgjithësi, ashtu edhe nga pikëpamja praktike. Vetë veprimi, nuk ka rëndësi nëse nuk prodhon ndonjë efekt në marrëdhëniet shoqërore të mbrojtura nga ligji penal ëndësia e studimit të pasojës, nga pikëpamjapraktike, qëndron:

- Së pari, në faktin se, duke u nisur prej saj, bëhet dallimi ndërmjet fazave të veprimtarisë përmes të cilave kalon vepra penale (kategoria e veprave penale që kryhen me dashje), veçanërisht, ndërmjet fazës së tentativës dhe kryerjes së plotë të veprës.
- Së dyti, shprehet në faktin, se duke u nisur nga prania ose jo e saj (pasojës), në disa raste, arrihet në përfundimin nëse veprimet ose mosveprimet e një personi përbëjnë ose jo vepër penale.⁶⁴

Teoria objektive e përcaktimit të ndëshkueshmërisë së tentativës, në krahasim me teorinë subjektive dhe atë të përzier, është më e preferuar, kjo për shkak se lidhet në mënyrë më koherente me principet e pakontestueshme të një të drejte penale të faktit. Tentativa përbën dëmtimin potencial të së mirës së mbrojtur dhe për shkak të këtij dëmtimi potencial, ku ka një shkallë më të ulët të dhunës së ushtruar ndaj së mirës së mbrojtur, justifikon në llogjikën e përgjithëshme të së drejtës penale të faktit, ndeshkimin më të ulët që legjislatori parashikon për këtë figure kriminale.

⁶² Po aty.

⁶³ Elezi,I., Kaçupi, S., Haxhia, M., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2012, fq 118.

⁶⁴ Kambovski,V., “E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)”, Shkup 2010, fq 156

Vlen të theksohet se linja perfundimtare që bën të mundur përcaktimin e tentativës, dhe si pasojë të ndëshkueshmërisë se subjektit veprues, behet atëherë kur arrihet venia në rrezik e të mirës së mbrojtur. Megjithatë duhet patur kujdes në përcaktimin e tentativës. Kjo për shkak se, vet figura në fjalë paraqet të gjithë elementet e veprës penale perfekte edhe pse rezultati final i dëshiruar nuk realizohet, prapë elementet përbërëse të saj si fakti tipik, fajësia dhe kryerja e një sjellje ligjërishit të ndaluar, realizohen në tërësinë unitare të parashikuar nga norma ligjore. Pra, nga ana normative – ligjore, tentativa përben një titull të posaçëm veprës penale, e karakterizuar nga një profil fyerje tipike të saj, edhe pse ruan, në çdo rast, nomen juris, të figurës kriminale të posaçme. Në bazë të këtij definicioni, konfigurimi i tentativës si një shkelje ligjore autonome lind nga takimi i dy neneve: neni ndëshkues i pjesës së posaçme, që parashikon si veprë penale një fakt dhe neni 22 e vazhdim të kodit penal.

2.8.3 Ana subjektive e figurës së veprës penale

Ana objektive: që mund të konsistojë në një veprim – levizje muskulore, fjale, plotësim dokumenti etj; ose në një mosveprim kur subjekti ka qenë i detyruar në bazë të ligjit apo të rrethanave që të veprojë dhe nuk ka vepruar. Detyrimi për të vepruar **mund të burojë nga ligji:** punonjësi i policisë ka detyrimin për të nderhyrë në një situatë që cenon rendin publik; punonjësi i doganës ka detyrimin që të bëjë kontrollin fizik të mallrave; **nga detyra:** rasti i mjekut që ka detyrimin për të mjekuar pacientin; **vete personi ka shkaktuar situatën e rrezikshme** – p.sh i ka vënë zjarrin në ndertësi; nga pakujdesia gjatë punës me lëndet plasëse ka shkaktuar rënien e një zjarri etj.⁶⁵

Subjekti aktiv: është personi i cili kryen veprimet ose mosveprimet e kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme, të dënueshme nga legjislacioni penal. Subjekt aktiv mund të jetë jo vetëm personi fizik por edhe personi juridik.

Subjekti pasiv: personi i cili pëson pasojat e veprimeve ose mosveprimeve kriminale të autorit të veprës penale. Personi të drejtat apo interesat e të cilit preken ose tentohen të çënohen nga vepra penale. Subjekt pasiv mund të jenë si personat fizikë ashtu edhe personat juridikë.

⁶⁵ Salihu, I., “E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)”, Prishtinë 2010, fq 261

Subjekti aktiv mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm

Subjekti i përgjithshëm është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm.

Subjekti aktiv është i posaçëm kur ai ka disa cilësi të veçanta, të cilat i përdor për kryerjen e veprës penale dhe për efekt të cilësimit juridik kryerja e veprës penale kërkon përdorimin e këtyre cilësive. P.sh shpërdorimi i detyres, kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore etj.

Ana subjektive: çdo sjellje e kundraligjshme për t'u cilësuar si veper penale duhet të jete kryer me faj. Faji perfaqeson qendrimin psikik te autorit te vepres penale ndaj sjelljes se tij te kundraligjshme dhe pasojave qe vijne nga kjo sjellje. Ne te drejten penale, faji ndeshet ne dy forma:

a) Dashja direkte – personi parashikon ardhjen e pasojave nga sjellja e tij dhe deshiron ardhjen e tyre; ose **indirekte** – personi parashikon pasojat, nuk i deshiron ato por me vetedije lejon ardhjen e tyre (p.sh kur nje punonjes i administrates se nje institucioni ka dijeni per shkeljet qe jane duke u kryer nga vartesis dhe nuk merr masa per te nderprere gjendjen e paligjshme.⁶⁶

b) Pakujdesia- e cila mund te shfaqet ne formen e neglizhences ose vetebesimit te tepruar.

Në teorinë juridike dallojnë dy lloje të subjekteve të veprës penale: subjekti aktiv dhe pasiv. Subjekti aktiv i veprës penale është personi që me veprimin e vet realizon pasojën e veprës penale. Ky është kryes i veprës penale (kryesi dhe bashkëpjesëmarrësit). Sipas rregullës, çdo person mund të jetë kryes i veprës penale me kusht se i ka mbushur 14 vjet, por te disa vepra penale ligji kërkon karakteristika të veçanta personale, marrëdhëniet ose rrethanat e personit që mund të jetë kryes i veprës – delicta propria (veprat penale me subjekt të veçantë special p.sh. Veprat penale zyrtare apo ushtarake). Nga nocioni objektiv i veprës penale nënkuptohet se si kryes (subjekt aktiv) mund të paraqitet edhe personi i papërgjegjshëm, personi juridik dhe i mituri. Kjo do të thotë se mund të bëhet dallimi ndërmjet nocioneve: kryesi dhe fajtori. Kështu kryesi i veprës penale mund të jetë çdo person që e kryen aktin e veprës të parashikuar me ligj, si element qenësor i asaj vepre, ndërsa bashkëpjesëmarrës, përveç kryesit është çdo person që me

⁶⁶ Salihu, I., “E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)”, Prishtinë 2010, fq 261

veprimtari të vet kontribuon për realizimin e veprës, ndërsa fajtor është ai kryes që është i moshës së caktuar, përgjegjësi penale dhe dashjen.⁶⁷ Përveç personit fizik, në kushte të caktuara, si subjekt aktiv mund të paraqitet edhe personi juridik. Subjekti aktiv i veprës penale mund të realizohet si vepër penale e kryer apo e tentuar. Ligjet penale dallojnë kryesit, duke marrë parasysh moshën, përshtatshmëria për përgjegjësi dhe a ka qenë më herët i dënuar. Sipas moshës, kryesit ndahen në të mitur (më të ri apo më të vjetër), të moshës së re madhore dhe moshës madhore. Sipas përshtatshmërisë për përgjegjësi dallohen: me përgjegjësi penale, pa përgjegjësi penale dhe ata kryes me përgjegjësi penale dukshëm të zvogëluar, ndërsa duke marrë parasysh dënimin e mëhershëm dallojmë: personat e padënuar (delikuent primar) recidivistë(ata që e përsërisin veprën penale). Gjinia dhe mosha nuk janë të rëndësishme për kryesit . Kryesi mund të jetë person që vet e ndërmerr aktin e veprës penale (kryes i drejtpërdrejtë) ose mund ta shfrytëzojë personin tjetër si mjet për të ndërmarr akte të veprës penale (kryes jo i drejtpërdrejtë). Më në fund në rolin e kryesit mund të paraqitet një apo më shumë persona (bashkëpjesëmarrës). Subjekti pasiv i veprës penale është person që i është shkaktuar lëndim apo është e dëmtuar me vepër penale, përkatësisht viktimë e veprës penale. Cilësia e subjektit pasiv nuk ka rolin e njëjtë në të Drejtën Penale, siç është rasti me subjektin aktiv. Cilësia e subjektit pasiv i rëndësishëm për aplikimin e instituteve të veçanta të drejtës penale: mbrojtja e domosdoshme, nevoja ekstreme, pajtueshmëria e të lënduarit, vetëlëndimi. Përcaktimi i subjektit pasiv ndonjëherë shkakton vështirësi për shkak se më shumë persona, për një vepër, mund të paraqiten si persona të lënduar apo të dëmtuar.⁶⁸ Kështu te vrasjet, përveç të vrarit, që është viktimë e veprës së kryer, si subjekt pasiv mund të paraqiten edhe të afërmit e tij, prindërit ose fëmijët e të vrarit. Për shkak të vështirësive rreth përcaktimit të personave, që mund të paraqiten si subjekt pasiv merret se këta janë persona, që janë bartës të së drejtave dhe interesave, që janë shkelur me aktin e veprës penale. Subjekt pasiv mund të jetë çdo person fizik. Për ekzistimin e subjektivitetit pasiv nuk është e nevojshme që personi fizik të jetë i aftë për afarizëm, madje as juridikisht i aftë. Ashtu siç në aktin e veprës penale mund të paraqiten më shumë subjekte (bashkëpjesëmarrës), ashtu mund të paraqitet numri më i madh i subjekteve pasive (të lënduar).

⁶⁷ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë, 2006, fq.35

⁶⁸ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë, 2006, fq.35

Në disa raste objekti i veprës penale dhe subjekti pasiv nuk përputhen, për shembull te vrasja dhe lëndimi trupor.⁶⁹

2.9 Faji si element përbërës i veprës penale dhe figurës së veprës penale

Nocioni i përgjegjësisë në drejtësi ka kuptime të ndyrshme. Për shembull dallon katër kuptime të saj: pozita e përgjegjshmë, përgjegjësi për pasojën e shkaktuar me veprimet e veta, përgjegjësi si obligim për përmbushjen e detyrave të caktuara dhe përgjegjësi në kuptimin e përgjegjësisë. Fajësia është raport psikik i kryesit të veprës ndaj veprës së kryer. Ky raport psikik shpre vetëdijen për veprimin, pasojën, marrëdhënien reciproke në mes veprimit dhe pasojës së paraqitur për të gjitha rrethanat e veprës penale të kryer në ekzistimin dëshirës ose në pajtimin me pasojën e shkaktuar. Ky nocion i fajësisë paraqet element subjektiv të veprës penale. Fajësia d.m.th është lidhja në mes personalitetit psikologjik të kryesit me veprën si dukuri objektive e cila është e paraqitur në botën e jashtme. Fjala fajësi përcakton të kundërtën e pafajësisë. Fajësia është supozim i domosdoshëm për ekzistimin e përgjithësisë penale dhe dënimit. Për të mundur kryerësi i veprës penale të jetë i dënuar për vepër e kryer ai duhet të ketë raport të caktuar psikik ndaj veprës së ti. Nëse nuk ekziston ky raport, atëherë nuk ekziston as përgjegjësia penale, do të thotë as dënimi. Fajësia është pjesë e përgjegjësisë penale. A ekziston apo nuk ekziston fajësia (e paraqitur si pakujdesi ose qëllim) si raport i caktuar psikik ndaj veprës penale të caktuar, duhet të përcaktohet në procedurën penale në bazë të gjitha dëshmive të mbledhura.⁷⁰ Fajësia të kryesi i veprës penale ekziston atëherë kur personi është i aftë mendërisht. Pa aftësi mendore nuk fajësi por nuk d.m.th që çdo kryes i veprës penale i aftë mendërisht duhet të jetë në të njëjtën kohë edhe fajtorë, të ketë qëndrim psikologjik ndaj veprimit e ti si vepër objektive e realizuar në botën e jashtme. Aftësia mendore si bazë e fajësisë paraqitet atëherë kur kryesi është i aftë të ketë raport të caktuar ndaj veprës së vet, por a ka qen fajtor, duhet të caktohet në çdo rast konkret nga ana e gjyqit. Pasi që gjyqi e përcakton ekzistimin e fajësisë të kryerësi i veprës, mund të shqiptohet dënimi i paraparë me ligj për atë vepër. Përcaktimi i vetëdijes dhe i dëshirës në rast

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë, 2006, fq.35

konkret do të thotë paraqitje të përmbajtjes për veprën dhe intensitetin e dëshiruar ndaj pasojës (shkalla e fajësisë). Kështu përjashtohet përgjegjësia objektive në të drejtën penale. Kjo nënkupton se kryesi i veprës penale mund të dënohet vetëm në bazë të fajësisë së dëshmuar, e jo vetëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar dhe shkaktim të pasojave të ndaluara. Kjo përgjegjësi do të ishte klauzole ose përgjegjësi pa fajësi. Përgjegjësia objektive është e pa pranueshme për të drejtën penale bashkëkohore, por nuk është edhe e pa panjohur. Ajo paraqitet në disa raste të jashtëzakonshme në formë të presupozimit të fajësisë. Kodi penal i Kosovës nisët nga parimi se përgjithësia penale subjektive është kusht për zbatimin e dënimit, elementi kryesor është fajësia. Ky parim është i paraqitur në nenin 11 KP në të cilin shkruan se: personi konsiderohet penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtorë për kryerjen e një veprë penale, gjegjësisht personi është fajtor për kryerjen e një veprë penale në rast se ai e kryen veprën penale me dashje apo pa kujdesia. Parimi i përcaktimit të fajësisë si kusht për zbatimin e dënimit është me rëndësi të madhe për mbrojtjen efiçase të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe për realizimin e parimit të dënimit të drejtë.⁷¹

2.9.1 Përkufizimi i fajit dhe funksionet e tij

Në teorinë e së drejtës bashkëkohore dhe legjislacionit penal ekziston mendim unik që përgjegjësia penale bazohet në fajësinë si raport psikik subjektiv i kryesit ndaj veprës së tij. Ekzistojnë më shumë teori lidhur me përcaktimin e fajësisë: psikologjike, normative, dhe e përzier psikologjiko-normative. Sipas teorisë psikologjike fajësia është raport psikik i kryesit të veprës ndaj veprës së tij si veprim ndaj botës së jashtme. Për ekzistimin e fajësisë nuk është e rëndësishme vetëdija për veprën e kryer. Raporti psikologjik paraqitet në ekzistimin e :1). vetëdijes për veprën, pasojën, raportin reciprok në mes tyre dhe rrethanave në të cilat kryet veprimi, dhe 2). dëshirës e cila paraqitet në kuptim të dashjes ose pajtimit me pasojën, gjegjësisht ekzistimin e vetëdijes ose mundësisë së ekzistimit të vetëdijes në krijimin e pasojave të cilat janë të padëshiruara dhe të papranuara. Sipas teorisë normative fajësia paraqet dënimin të cilin gjyqi në emër të shoqërisë i ja shqipton kryesit të veprës penale për veprën e ndaluar penale. Fajësia

⁷¹ Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë, 2006, fq.35

paraqitet si vlerësim social-etik i shoqërisë të përfaqësuar nga këshilli gjyqësorë lidhur më atë se a ka qenë veprimi i kryerësit kundër detyrave të cilat dalin nga normat juridike. Sipas kësaj, fajësia është vlerësim rreth asaj se a mundet kryerësi i veprës të qortohet penalisht për veprën e kryer dhe gjyqësori ta nxjerr vendimin lidhur me përgjegjësinë penale. Sipas teorisë psikologjiko-normative, fajësia është kategori psikologjike dhe normative. Për ekzistimin e fajësisë nuk është i mjaftueshëm fakti që te kryesi i veprës ekziston vetëdija dhe dëshira në raport me veprimin dhe pasojat, d.m.th në raport me veprimin si dukuri reale në botën e jashtme, por është e domosdoshme që te personi të ekzistojë vetëdija rreth asaj që veprimi i tij është kundër rregullave shoqërore. Ekzistojnë dhe autor të cilët mendojnë se elementi normativ i fajësisë ekziston në vetëdijen e kryesit që vepra e tij është e kundër ligjshme d.m.th e ndaluar, për deri sa disa autorë normativitetin e paraqesin si vetëdije te kryesit që veprimi i tij është veprim i dëmshëm shoqërorë ose që është kundër rregullave morale.⁷²

2.9.2 Zhvillimi i konceptit të Fajit

Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, eparashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mëndjehetësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk iprashikon, megjithëse sipas rrethanave duhet dhe kishte mundësi ti parashikonte. Pakujdesia sidhe dashja përbëhet nga dy pjesë që i dallon qëndrimi i ndryshëm psikik i personit ndaj veprimitose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm.⁷³ Vetbesimi i tepruar ekziston vetëm atëhere kur personi e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, nuk i dëshiron ato por me mëndjehetësi mendon se do t'i shmangë. Dallimi kryesorndërmjet pakujdesisë me vetbesimin e tepruar dhe dashjes indirekte është mënyra e të menduarit rreth pasojave të mundshme të cilat mund t'i parandalojë ato. Shkalla dhe karakteri i parashikimttë pasojave në pakujdesi me vetbesim të tepruar nuk janë as të barabarta dhe as të njëjta me atotë dashjes indirekte. Dallim tjetër përbën edhe shkalla e dëshirës lidhur me mosardhjen e pasojës. Pakujdesia në formën e vetbesimit të tepruar është karakteristikë e veprave penale të shkeljeve të rregullave të mbrojtjes në punë, të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj.

⁷² Eissen, M. A. (1996, The length of civil and criminal proceedings on the case laëof the European court of human rights, Council of Europe Publishing, 1996

⁷³ Vllado Kambovski (2003), E drejta Penale –pjesa e posaçme, botimi i katërt i shtuar, Prosvetno delo, Shkup

Neglizhenca ekziston atëhere kur personi nuk e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, megjithëse sipas rrethanave duhej të kishte mundësi t'i parashikonte. Përgjegjësia penale ekziston në ato raste kur personi i ka aftësitë për të parashikuar pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij, kur nuk ka rrethana objektive penguese në këtë veprim. Ekzistenca e neglizhencës lidhet me detyrimin e personit për t'i parashikuar pasojat dhe mundësinë e parashikimit. Kodi Penal përmban disa figura veprash penale të cilat kryhenvetëm me pakujdesi në formën e neglizhencës, si mjekimi i pakujdesshëm ose humbja e disadokumentave sekrete, ndërsa shumica e figurave të veprave penale të cilat parashikohen në Kodin Penal zhvillohen me të dy format e pakujdesisë.⁷⁴

2.9.3 Përmbajtja e Fajit, koncepti psikologjik dhe normativ

Në të drejtën penale rëndësi të posaçme paraqet nocioni i veprës penale, që trajtohet në mënyrë të detajuar, duke i kushtuar një kujdes i veçantë nga shumë autor. Në këtë punim jam përcaktuar që të trajtoj çështjen e nocionit dhe rëndësisë së fajit, si një nga katër elementet e veprës penale, duke marrë për bazë rëndësinë e këtij elementi të veprës penale, sepse ka të bëjë me qëndrimin apo mardhënien e kryesit ndaj veprës penale që e ka kryer. Arsyeja e rëndësisë së fajit të kryesit të veprës penale, çëndron në faktin se është element kyç për t'u krijuar përgjegjësia e kryesit të veprës penale. Duke marrë për bazë faktine rëndësisë së madhe të këtij elementi të veprës penale, që ka qenë motivi im për përcaktimin e kësaj teme, është sepse në të drejtën penale, në praktikën e përditshme gjyqësore shfaqen probleme dhe dilema të ndryshme lidhur me vërtetimin e fajësisë së kryesit të veprës penale, që është e domosdoshme që në çdo rast konkret, fajësia e kryesit të veprës penale të vërtetohet me prova konkrete edhe pse paraqet vështirësi, varësisht prej rastit dhe rrethanave.⁷⁵ Vepra penale në aspektin material, është sjellje enjeriut e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik. Elementet themelore të veprës penale janë: veprimi i njeriut, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria e veprës penale në ligj dhe përgjegjësia penale e kryesit (fajësia).⁷⁶ Meqenëse

⁷⁴ Vllado Kambovski (2003), E drejta Penale – pjesa e posaçme, botimi i katërt i shtuar, Prosvetno delo, Shkup

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Lazhëtiq –G. Buzhžarovska, (2004 -2005), Vlerësimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Vjetori i Fakultetit Juridik "Justiniani i parë", Shkup, Vol. 41, 2004/2005

faji është një nga dy elementet e përgjegjesisë penale, pasi që përgjegjësia penale përbëhet nga: vetitë e caktuara psikike të kryesit (përgjegjësia) dhe qëndrimi apo marrëdhënia e kryesit ndaj veprës penale që e ka kryer (fajësia), andaj kam paraqitur lidhshmërinë e këtyre dy elementëve të përgjegjesisë penale. Para trajtimit të temës së fajit, kam trajtuar përgjegjësinë penale dhe përgjegjshmërinë, pastaj format e fajit si: dashja dhe pakujdesia në bazë të së drejtës penale si dhe literaturës shtesë po ashtu kam analizuar dhe trajtuar llojet e dashjes si: dashja direkte dhe eventuale, llojet e pakujdesisë si: pakujdesia me vetëdije dhe pakujdesia pavetëdije, pastaj përgjegjësia dhe ndëshkimi i kryesit të veprës penale, varësisht nga forma e faji.⁷⁷ Përgjegjësia penale në të drejtën penale përbëhet prej përgjegjesisë dhe fajësisë, ashtu që një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso aftësi (cilësi) psikike që e bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Ndërsa, kryesi i veprës penale konsiderohet i fajshëm, atëher kur ndaj veprës së kryer, ka pasur asi qëndrimi apo raporti i cili bën të mundshme që t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të vetën. Nga kjo rezulton se për të ekzistuar përgjegjësia penale, kryesi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjësia dhe fajësia si elemente përbërëse të veprës penale, janë të lidhura ngushtë midis vete.

Ashtu që, nëse një person nuk është i përgjegjshëm, nuk është i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta, atëherë nuk mund të konsiderohet fajshëm. Me fjalë të tjera, përgjegjësia është kusht për t'u sajuar fajësia, në anën tjetër një person nuk mund të jetë i përgjegjshëm, por të mos jetë i fajshëm për veprën e kryer.⁷⁸ Në të drejtën penale bashkëkohore është përvetësuar parimi i përgjithshëm, se që të mund të dënohet kryesi, përveç që vepra duhet të jetë e paraparë me ligj si vepër penale, duhet që kryesi të jetë penalisht i përgjegjshëm. Përgjegjësia penale, përkatësisht fajësia, është një ndër elementet e përgjithshme që duhet të shprehen tek çdo vepër penale. Kjo njëherësh është garanci e të drejtave të njeriut dhe kufizim i së drejtës së shtetit që t'i ndëshkojë qytetarët (ius puniendi). Pra, përgjegjësia penale, përkatësisht fajësia, është kusht që duhet të plotësohet doemos që të mund t'i shqiptohet dënimi kryesit të veprës penale, parim ky që është formësuar me maksimën “nulla poena sine culpa” (nuk ka dënim pa fajësi).

⁷⁷ Vllado Kambovski (2003), E drejta Penale – pjesa e posaçme, botimi i katërt i shtuar, Prosvetno delo, Shkup

⁷⁸ Ismet Salihu, E drejta penale, Prishtinë, 2008, fq. 275.

Fajësia është digë mbrojtëse nga arbitrariteti i mundshëm i gjykatës, ngase gjykata nuk mund të dënojë asnjë person nëse nuk e konstaton fajësinë e tij.⁷⁹ Siç u theksua më lart, për t'u konsideruar kryesi i veprës penale person penalisht përgjegjës për veprën e kryer, duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm, kështu që përgjegjshmëria dhe fajësia janë elemente përbërse të përgjegjësisë penale, ndërsa kur flasim për elementet e veprës penale, faji është element subjektiv i veprës penale. Përkundër faktit se përgjegjshmëria mund të supozohet, se një person veprën penale ka kryer në gjendje të përgjegjshme, fajësia nuk mund të supozohet por ajo medoemos për çdo rast konkret të veprës penale duhet të vërtetohet, duhet që në procedurë penale të administrohen provat e nevojshme, në mënyrë që të konstatohet se personi veprën penale të caktuar e ka kryer me fajin e tij. aji është përgjegjësia personale e kryesit për veprën e vet. Një person konsiderohet se veprën penale e ka kryer me faj, në rastet kur ka ditur se me veprimin apo mosveprimin e tij, do të shkaktojë pasojë të ndaluar në botën e jashtme, pasojë kjo që në ligj është paraparë si vepër penale dhe nëse ndaj pasojës –ndaj veprës, ka pasur asomarrëdhënie, relacion e cila i bën të mundshme gjykatës që t'ia ngarkojë, tia vëjë në barrë atë vepër.⁸⁰ Në rastet kur vepra penale kryehet me dashje, kryesi çdoherë konsiderohet përgjegjës, ndërsa pakujdesia është formë më e lehtë e fajit dhe për veprat penale të kryera nga pakujdesia, kryesi dënohet vetëm në rastet kur me ligj shprehimisht parashihet se do të dënohet edhe për vepër penale nga pakujdesia. aji në një shkallë a në një tjetër, është vlerësuar gjithmonë nga e drejta penale, e hershme a e vonët, si element i rëndësishëm për ekzistencën e veprës penale. Parimi i fajësisë është shprehur me formulën e njohur romake “Nullum crimen, nulla poena sine culpa”, nuk ka krim nuk ka dënim pa faj.⁸¹

Në shkencën e së drejtës penale njihen tri konceptione apo teori. Këto janë: Teoria psikologjike, teoria normative dhe teoria psikologjike–normative. Sipas teorisë psikologjike, faji është marrëdhënie (relacion) psikik i kryesit ndaj veprës së vet dhe pasojës së asaj vepre, e cila shprehet me dashje dhe nga pakujdesia. Kjo teori mbështetet në logjikën se kur personi është i përgjegjshëm, ai është i aftë edhe të konkludojë, të dijë se veprën që e kryen në shoqëri vlerësohet si vepër e dëmshme, e keqe dhe kriminale. Me fjalë të tjera, sipas teorisë psikologjike, një person konsiderohet i fajshëm kur psikikisht është i aftë të bëjë dallimin midis veprës së

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Ismet Salihu, vep. e cit., fq. 291.

⁸¹ Shefqet Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2012, fq. 162.

mirë, në një anë, dhe veprës së keqe, të dëmshme, në anën tjetër. Sipas teorisë normative, një person konsiderohet se e kryen veprën me fajin e tij në rastet kur veprën e vet e vlerëson si të kundërligjshme. Pra, sipas kësaj teorie, fajti ekziston nëse kryesi ka qenë i vetëdijshëm ose duhet të ishte i vetëdijshëm, ka qenë i detyruar të jetë i vetëdijshëm se vepra e tij është e kundërligjshme, në ligj është e përcaktuar si veprë penale. Brenda e kësaj teorie konsiston në faktin se një person e konsideron të fajshëm ngase nuk është sjellë, nuk ka vepruar ashtu si e obligojnë normat juridike, sociale dhe morale. Vlerësimin lidhur me atë se a është sjellë, a ka vepruar në kundërshtim me ligjin, e jep gjykata. Kësaj teorie i bëhet vërejtje ngase në masë të konsiderueshme lë pas dore elementin psikik të fajësisë dhe kësaj anon më tepër në drejtim të përgjegjësisë objektive. Sipas teorisë psikologjike-normative, një person konsiderohet se e ka kryer veprën me faj në rastet kur janë shprehur elementet e përmendura të teorisë psikologjike dhe të teorisë normative. Rrjedhimisht, sipas kësaj teorie, kryesi konsiderohet i fajshëm atëherë kur ka qenë i vetëdijshëm se me veprimin apo mosveprimin e tij do të shkaktojë pasojë të dëmshme, dhe nëse e ka ditur se ajo veprë është e ndaluar, është në kundërshtim dhe dënohet sipas normave juridike, morale dhe sociale.⁸²

2.9.4 Struktura e Fajit

Sipas nenit 11 dispozita 1 KP kryesi është fajtor për veprën penale të kryer me dashje apo nga pakujdesia. Nga kjo del se fajësia paraqitet në dy forma, me dashje dhe nga pakujdesia. Fajësia paraqet raport psikik të kryerësit të veprës ndaj veprës së tij. Ky në fakt është qëndrim psikik i personalitetit të njeriut ndaj veprës si veprim i ti dhe këtu bëjnë pjesë: vetëdija, dëshira, ndjenjat, afekti, instinkti, nxitja etj. Të gjitha këto procese psikike përmbajnë fajësinë. Rolin më të madh e kanë vetëdija dhe dëshira. Vetëdija dhe dëshira janë elemente kryesore të sjelljes të njeriut dhe nëpërmjet tyre më së miri paraqitet raporti i personalitetit ndaj sjelljes së vet dhe rezultatet e asaj sjelljeje. Elementet e cekura më lartë janë gjithashtu elemente kryesore të aftësisë mendore dhe fajësisë. Kjo rrethanë kërkon të përcaktohet raporti ndërmjet këtyre dy elementeve të përgjegjësisë penale. Te aftësia mendore përcaktohet se a ka mundur kryesi i veprës penale të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprimit të vet, dhe a ka mundur të udhëheqë

⁸² Shefqet Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2012, fq .162

me veprimet e veta në kohën e kryerjes së veprimit . Do te thotë përcaktohet aftësia e ti për gjykim dhe vendim. Te fajësia përcaktohet se a ka qen kryesi i veprës i vetëdijshëm për veprën penale konkrete të cilën e ka kryer dhe a ka dashur ose pajtuar me kryerjen e kësaj vepre. D.m.th aftësia mendore paraqet aftësi psikike te kryesit veprës, aftësinë psikologjike (mundësinë, fuqinë) dhe vetëdijen dhe dëshirën të veprojë, përderisa fajësia nënkupton kryerjen e veprës penale me vetëdije dhe dëshirë. Sipas kësaj, raporti në mes aftësisë mendore dhe fajësisë paraqitet baze dhe supozim te fajësisë.

Gjyqi në procedurë penale nuk përcakton aftësinë mendore por paaftësinë mendore dhe vetëm ne raste kur të paraqitet dyshimi në aftësinë psikike te kryesi i veprës. Do te thotë që ekziston supozimi i aftësisë mendore. Ky supozim është relativ. Përkundër presupozimit të aftësisë mendore ekziston parimi i përcaktimit të fajësisë ne procedurë penale ne çdo rast konkret. Domethënë në të drejtën penale bashkëkohore njëri nga elementet kryesor i përgjegjësisë penale është presupozimi i fajësisë. Presupozimi i fajësisë i përgjigjet përgjegjësisë penale objektive nga koha feudale e të drejtës penale. Përgjegjësia penale subjektive, e cila bazohet në raportin psikik te kryesit ndaj veprës së kryer, kërkon, që ky raport psikik të jetë i caktuar. Përcaktimi i fajësisë kryhet në gjyqe me procedurë penale dhe dëshmi në çdo rast konkret, d.m.th në raport me veprën e cila gjykohet përcaktohet dhe fajësia. Kodi Penal parashikon një figurë vepre penale të tillë e cila është e parashikuar nëdispozitën e nenit 88 paragrafi 2, e cila është plagosja e rëndë me dashje e cila ka sjellë si pasojëvdekjen.Rasti fatkeq është kur në kryerjen e veprës penale nga personi nuk vërtetohet asnjë formëfajsie, domethënë kur vepra kryhet pa faj ngjarja quhet rast fatkeq. Këtu mungon lidhjashkakësore midis sjelljes së personit dhe pasojës së ardhur prej saj. Ai në rrethanat e ndodhjes sëngjarjes, objektivisht nuk ka patur mundësi ta parashikonte dhe as ishte i detyruar ta parashikonteatë, rasti fatkeq e përjashton përgjegjësinë penale të autorit të veprës.⁸³

⁸³ S.Spiro., Cikël leksionesh, “Ana Objekti I Figurës së Veprës Penale”, UET, Tiranë 2008, Fq. 3

2.9.5 Përgjegjshmëria dhe komponentat e saj

Përgjegjshmëria është cilësi e njeriut të shëndosh mendor, të mendojë dhe vendos në mënyrë të duhur. Ajo, veç kësaj, njohja e duhur e dispozitave juridike dhe mundësia për sjellje në paj-time ato dispozita, respektivisht rregulla. Në përgjegjshmëri bëjnë pjesë këto aftësi: aftësia të kuptojë domethënien e veprës dhe aftësia për menaxhimin me veprimet e veta. Aftësia për të kuptuar domethënien e veprës, d.m.th. të kuptohet si ngjarje, qoftë me ose pa pasoja, nga pikëpamja e qëndrimit të shoqërisë dhe qëndrimit të tij për atë vepër. Aftësia për menaxhim me veprimet e veta d.m.th. aftësia për vendosmëri, pasi do të kuptojë domethënien e veprës. Ajo, veç kësaj d.m.th. edhe aftësi për gjykim. Për çdo njeri si qenie e vetëdijshme, me përgjegjësi dhe të lirë supozohet është i përgjegjshëm. Sepse përgjegjshmëria nënkuptohet, në kodin penal tonin nuk është thënë çfarë është përgjegjshmëri, por çfarë është papërgjegjshmëri.

I papërgjegjshëm është ai njeri, kryerës i veprës i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mundur të kuptojë veprën e tij ose nuk ka mundur të menaxhojë me veprimet e veta dhe ajo papërgjegjësi ka shkaktuar sëmundje mendore të përhershme ose të përkohshme, çrregullim i përkohshëm ose zhvillim të prapambetur mendore. Vlerësimi për përgjegjshmërinë e kryerësit ka të bëjë vetëm për veprën konkrete dhe jo në përgjithësi. Papërgjegjshmërinë sa i përket veprës penale të kryer e përcakton gjykata – në bazë të ekspertizës psikiatrike. Papërgjegjshmëria e përjashton përgjegjësinë penale, ashtu që kryeri me papërgjegjshmëri nuk mund të dënohet.⁸⁴ Për kryerësin e papërgjegjshëm i cili është i rrezikshëm për bashkësinë shtetërore, mund të zbatohen, këto masa për siguri:

- 1) Shërim i domosdoshëm psikiatrik dhe mbajtje në institucion shën-detësor dhe

⁸⁴ Ekzistojnë tri metoda për përcaktimin e papërgjegjshmërisë: biologjike, psikologjike dhe metoda bio-psikologjike. Gjatë përcaktimit të papërgjegjshmërisë analizohet ekzistimi i disa gjendjeve biologjike (sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, çrregullim mendore i përkohshëm, ose zhvillim i prapambetur mendore), si dhe shprehja e këtyre gjendjeve mbi aftësinë e kryerësit për gjykim. Këto gjendje përcaktohen përmes ekspertizës psikiatrike me kontroll të akuzuarit për të konstatuar nëse ajo ka pasur ndikim mbi përgjegjshmërinë e të akuzuarit. Gjykata është e obliguar të caktojë ekspertizë psikiatrike kur ka prova të sigurta se i akuzuari vuan prej ndonjë sëmundje mendore. Çrregullimet mendore të përkohshme mund të paraqiten prej temperaturës së lartë, etheve, çrregullime në gjumë dhe faktorë tjerë të brendshëm. Faktorët e jashtëm, të cilët më shpesh shkaktojnë çrregullime të këtilla, janë si p.sh., përdorimi i alkoolit dhe drogës. Zhvillimi i prapambetur mendore është karakterizuese, respektivisht përmbajtje e mendore për shkak të shkurtësisë në zhvillimin mendore. Pazhvillueshmëria mund të jetë e shkallëve të ndryshme (budal-lallëkut, imbecilitetit, idiotësisë, marrësisë).

2) Shërim i domosdoshëm psikiatrik në liri, me të cilin mund të shqiptohen edhe masa tjera (ndalesë të ushtrijë profesion, veprimtari ose detyrë të caktuar; ndalesë të drejtojë automjet mo-torik. Rrethana e cila në kohën e kryerjes së veprës penale, ka ndikuar në aftësinë e kryerësit ta kup-tojë domethënien e veprës së vet ose të menaxhojë me veprimet e veta për shkak të gjendjes biop-sikologjike e cila ishte ulur (përgjegjshmëria e ulur ndjeshëm) nuk e përjashton përgjegjësinë dhe fajin e kryerësit, por vetëm e zvogëlon.

Kryeri i tillë mund të dënohet më butë, kurse mund bashkë me dënimin t'i shqiptohen masa për siguri, siç janë, shërimi i domosdoshëm psikiatrik në institucion shëndetësor ose shërim i domosdoshëm psikiatrik në liri. Përgjegjshmëria e ulur ndjeshëm përcaktohet, njëjtë sikurse papërgjegjshmëria. Kryerësi i veprës penale i cili me vetëdije ka ardhur në gjendje të papërgjegjshmërisë me përdorimin e alkoolit, drogës dhe mënyrave tjera (p.sh., prej rraskapitjes së vozitësit prej vozitjes së gjetë), pe-nalisht është përgjegjës: nëse ishte me paramendim të tillë (paramendim ose pakujdesi), para se kryhet vepra. Kjo është kështu sepse kemi të bëjmë me vepër për të cilën kryerësi ka vendosur ta bëjë, derisa ka qenë i përgjegjshëm, kurse këtë veprim e ka kryer derisa ka qenë në gjendje të papërgjegjshme, respektivisht derisa ishte i përgjegjshëm në raport me atë vepër ka vepruar me pakujdesi. Për përgjegjësi penale dhe për shqiptimin e dënimit penal nuk mjafton kryeri në kohën e kryerjes së veprës penale të jetë i përgjegjshëm, por edhe të jetë i fajshëm. Përgjegjshmëria është vetëm supozim për faj, respektivisht fajësi. Ndërsa tek përgjegjshmëria analizohet gjendja psikologjike e kryerësit në kohën e kryerjes së veprës penale, tek faji analizohet (me prezumim se ai psikologjikisht është i shëndosh) si është raporti i tij psikologjik me veprën. Ekzistojnë këto shkallë ose forma të fajit:

1) Paramendim si formë më e fajit dhe

2) Pakujdesi si formë më e lehtë e fajit. Paramendimi është kundërshtim i vetëdijshëm i të drejtës (rendit juridik), kurse pakujdesia është sjellje e padëshiruar e pakujdesshme, në një farë kuptimi mendjehetësi.

Për çdo vepër penale të kryer me paramendim është paraparë dënim, kurse për veprën e kryer prej pakujdesisë vetëm nëse ajo me ligj është paraparë. Vepra penale e kryer me paramendim kur kryerësi është i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e dëshiron kryerjen e saj (paramendim direkt) ose kur është i vetëdijshëm se për shkak të veprimit ose mosveprimit të tij

mund mund të paraqitet pasoja e ndaluar, kurse ai edhe përkundër kësaj pajtohet të paraqitet pasoja (paramendim eventual). Paramendimi, sipas kësaj, mund të shprehet si paramendim direkt ose eventual. Tek paramendimi direkt kryerësi me vetëdije dhe me dëshirë shkon në atë ta kryejë veprën penale, kurse tek paramendimi eventual kryerësi është i vetëdijshëm se ka rrezik të madh prej kryerjes së veprës penale, si edhe për mundësinë prej paraqitjes së pasojave të ndaluara, por ajo vetëdije nuk ndikon për të kthyer (heq dorë) prej kryerjes së asaj vepre (p.sh., gjuetari gjuan në kafshë të egër edhe pse është i vetëdijshëm se mund të godas ndonjë gjuetar i cili është në afërsi të kafshës së egër). Ai për realizimin e asaj që është cak i tij, (gjuajtjen e kafshës së egër), pajtohet të paraqiten pasojat e ndaluara (vrasja e gjuetarit i cili është në afërsi direkte) si qëllim i tij i dytë. Pakujdesia (vëmendje e pamjaftueshme e nevojshme gjatë ndonjë aktiviteti), është kryerje e padëshiruar e veprës penale. Kryerësi, edhe nuk e dëshiron veprën e cila nuk është dëshirë e tij, përgjigjet për pasojat e padëshiruara. Pakujdesia mund të jetë e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme. Pakujdesia e vetëdijshme ekziston kur kryerësi është i vetëdijshëm se me veprimin ose mos-veprimin e tij mund të paraqiten pasojat e ndalura, megjithatë, pamenduar, llogarit se ato pasoja nuk do të paraqiten ose se do të mund të pengohen, p.sh., mësuesi i notit është i vetëdijshëm se fëmija (nxënësi) të cilin e mëson mund të mbytet në pishinë, me mendjehetësi llogarit se një gjë e tillë nuk do të ndodh, respektivisht se fëmija nëse mbytet do ta shpëtojë.⁸⁵ Pakujdesia pavetëdije ekziston kur kryerësi nuk ka mundur të di se mund të paraqitet pasoja e ndaluar, edhe pse sipas rrethanave dhe cilësive të veta personale mund të jetë i vetëdijshëm për atë mundësi (p.sh., vozitësi i autobusit e dinte se frenat e autobusit nuk janë në rregullt, por për shkak të pamundësisë të frenojë paraqitet ndeshje). Tek pakujdesia nuk ka vëmendje të mjaftueshme të nevojshme dhe të mundshme. Kjo d.m.th. nëse kryerësi në situatën e dhënë kishte vëmendje të mjaftueshme, vepra penale e kryer prej pakujdesisë, do të mund të shmangej.⁸⁶

⁸⁵ Makedon Sllavkoski, Bazat e të Drejtës publike, Shkup, 2012, fq.105

⁸⁶ Po aty.

2.9.6.1 Papërgjegjshmëria

Legjislacionet dhe teoria e së drejtës penale trajtojnë disa raste kur megjithesë plotësohen të gjithë elementët e figurës së veprës penale, përsëri personat përkatës nuk mbajnë përgjegjësi penale si pasojë e vërtetimit të disa rrethanave objektive, pra që nuk varen nga vullneti i tyre. Këto raste parashikohen edhe nga kodi ynë penal dhe konkretisht: mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme dhe rasti fatkeq. Për sa i përket të drejtës zakonore, ajo nuk njih asnjë rast të përjashtimit nga përgjegjësia penale për shkak të rrethanave objektive. Madje duke ju referuar rastit fatkeq, i cili konsiderohet rasti i ardhjes së pasojave të dëmshme, të cilat ndonëse ndodhen në lidhje shkakësore me veprimin ose mosveprimin e personit, i cili jo vetëm nuk e parashikon por nuk duhej dhe nuk kish mundësi reale të parashikonte ardhjen e tyre,⁸⁷ ai klasifikohet si formë e pakujdesisë. Një gjë e tillë shprehet në dispozitën e kanunit të Lekë Dukagjinit:

Përgjegjësia e të zotit të pushkës dhe të krrabës:

Me shkrepë pushka pa hiri, i zoti i pushkës bjen në gjak po vrau a shitoi kend.

Po hini kush në ship të huej e, porsa ta vjerrë pushkën në krrabë, i kputet rrypi, shkrep pushka dhe vret ndonji të shpisë a këdo, i zoti i pushkës bjen në gjak.

Po e la miku pushkën të ngrefë edhe shkrepë e vrau kend, i zoti i pushkës bjen në gjak.

Po e vuer miku pushkën në krrabë e kjo u thye e ra pushka në tokë, shkrepë edhe vrau kend, i zoti i krrabës bjen në gjak. Kuji e krraba janë vue për të vjerrun të pushkëve, pra i zoti i krrabës a i kuj do tu vete menden e mos t'i lete brejshin prej kriet.⁸⁸

Edhe për mbrojtjen e nevojshme parashikohej shprehimisht se ajo nuk njihet e konkretisht, në kanunin e Lekë Dukagjinit parashikohej:

Po më shau kush e unë e vrava, ja kam gjakun.

T'u mat kush e të ra, ti e vrave, bjen në gjak.

Të hypi kush në qafë, edhe pse janë dy duer për një krye, po e vrave, i ke gjakun.

⁸⁷ Po aty, fq. 129

⁸⁸ E drejta zakonore shqiptare 1 – vep cit, fq. 322

Po erdh kush me të vjedhë, edhe e shef tuj t'a zbërthye derën, e vrave i ke gjakun.

*Erdh kush me ta dliurë vathin, e shef tuj t'a vu tufën e gjasë përpara, rrane me nxjerrë gjanë tande e atij si lidhet mendja me t'a lshue po e vrave bjen në gjak.*⁸⁹

2.9.6.2 Veprimi i lirë në shkak (Actio libera in causa)

Parimi që përmbahet në nenin 17 paragrafi i dyte të Kodit Penal nuk aplikohet apo përjashtohet në rastet e nenit 18 paragrafi i tretë të Kodit Penal të kryerjes së veprës penale në gjendje të dehur apo siç njihet në doktrinë me action libera in causa me paramendim (veprimi i lirë në vendim e jo në kryerje). Ky paragraf parashikon dehjen e bërë me paramendim për të kryer veprën penale, duke aplikuar të njëjtat rregulla edhe kur dehja është bërë nën efektin e narkotikëve apo simulantëve të tjerë, neni 18/4. Ky përjashtim shprehet në rastet kur vetë personi e sjell veten në gjendje të papërgjegjshme dhe në atë gjendje kryen veprën penale. Neni 18/3 është një rast i veçantë i veprimit të kryer sipas një gjendje të programuar me dashje ku personi dënohet dhe mbahet parasysht nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit si më rënduese edhe pse e ka kryer veprën penale në gjendje papërgjegjshmërie, pasi ai vetë me vullnet të lirë ka krijuar këtë gjendje me qëllim për të kryer veprën penale.⁹⁰

Lidhur me institutin e actions libera in causa, në mënyrë figurative mund të thuhet se këtu bëhet fjalë për situatat kur personi e përdor veten si mjet për të kryer veprën penale në gjendje të papërgjegjshme pjesërisht. Në dehjen me paramendim mund të ndodhë kur një person në gjendje normale nuk ka kurajo që të kryejë veprën penale të vrasjes, dhe për të evituar frikën konsumon alkool dhe në gjendje të dehur e kryen këtë veprë. Duke ndjekur analizën tonë të këtij instituti me kohën e kryerjes së veprës penale, mund të themi që qëllimi i institutit të actions libera in causa, është që të pengojë keqpërdorimin e parimit se, mund të konsiderohet penalisht i përgjegjshëm personi i cilinë kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm.

⁸⁹ E drejta zakonore penale e shqiptarëve – vep cit, fq. 108

⁹⁰ Pra, shprehja, action libera in causa, nënkupton faktin që vepra penale e kryer në gjendje të dehur me paramendim është një pasojë e një zgjedhje e vullnetit të lirë të subjektit, e cila përfaqëson një mënyrë e zgjedhur nga autori për të kryer veprën penale

Përndryshe, po të mos njihej instituti actions libera in causa, nuk do të ishte e mundur të dënohen personat që me vetëdije, me qëllim e sjellin veten në gjendje të papërgjegjshme dhe në këtë gjendje kryejnë veprën penale. Aplikimi i institutit të actions libera in causame paramendimkërkon përmbushjen e disa kushteve si; a) personi të jetë i vetëdijshëm në kohën kur sjell veten në gjendje papërgjegjshmërie; b) që personi me dashje vihet në këtë gjendje para kohës së kryerjes së veprës penale; c) që të ketë kryer veprën penale me dashje. Nëse janë përmbushur këto kushte dhe personi kryen veprën penale, atëherë nuk kemi shmangie nga parimi se personi konsiderohet penalisht i përgjegjshëm vetëm në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje ta kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Përgjegjshmëria duhet të ekzistojë në kohën kur personi duke konsumuar alkool, drogë apo në ndonjë mënyrë tjetër e sjell veten në gjendje të papërgjegjshme. Në këtë rast ligjvënësi ka paraqitur një mospërputhje kohore midis veprimit dhe përgjegjshmërisë duke spostuar parandë kohë momentin për të cilën duhet të ekzistojë përgjegjshmëria në raport me momentin që kryhet e vepra penale duke thyer rregullin e përputhjes së nevojshme kohore të përgjegjshmërisë dhe kryerjes së veprimit apo mosveprimit⁵⁰, pasi shume autorë mendojnë që kryerja e veprës penale fillon që në momentin e krijimit të papërgjegjshmërisë.⁹¹

2.10 Dashja dhe kuptimi i saj sipas Legjislacionit vendas

Dashja (dollar) është kryerja e veprës penale me vetëdije dhe dëshirë. Kjo është forma e fajësisë e cila paraqitet më së shpeshti dhe me të cilën më së miri paraqitet raporti psikik i kryesit të veprës ndaj veprës, qëndrimi tij ndaj pasojave, qëndrimin e tij ndaj pasojave si ndryshime në objekt të sulmit të cilin ai e ka shkaktuar ose ka kontribuar në shkaktimin e tij. Për veprën penale të kryer me dashje personi gjithëherë përgjigjet dhe dënohet. Në teorinë e së drejtës kemi shumë kuptime lidhur me nocionin dhe përmbajtjen e dashjes. Kemi këto teori: Teoria e vetëdijes, teoria e dëshirës dhe teoria e kompromisit. Sipas teorisë së vetëdijes (teoria e paraqitjes ose teoria intelektuale) dashja ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm që me veprim të vetin do të

⁹¹ Për Mantovanin, në Diritto penale, Parte generale, Padova, 1986, fq. 477, kemi të bëjmë me ekzekutim të veprës penale, që në momentin kur subjekti ka vendosur i lirë një sjellje, që i ka shkaktuar atij një ulje të ekuilibrit mendor nga i cili vijnë dhe pasojat. Këto pasoja vijnë nga një sjellje e vullnetshme e mëparshme e tij, për të cilën subjekti është transformuar në një mjet për të kryer veprën penale.

shkaktoj pasojën. Dashja paraqet vetëdije përkatësisht dijen , shfaqjen e tipareve të veprës penale, d.m.th vetëdijen për veprimin, raportin reciprok ndërmjet veprimit dhe pasojës si dhe rrethanave të tjera të cilat përmbajnë tipare të elementit qenësor të veprës së caktuar penale. Dëshira e kryesit të veprës penale, sipas këtij mendimi nuk është me rëndësi për ekzistimin e dashjes. Sipas kësaj, dashja do të ekzistojë atëherë kur kryesi parasheh si të sigurt ose të mundshme paraqitjen e pasojave ne pajtim me rrethanat tjera pa marrë parasysh a i ka dëshiruar apo jo ato pasoja. Sipas teorisë së dëshirës (teorisë voluntaristike) dashja ekziston atëherë kur kryesi e ka dëshiruar paraqitjen e pasojave të parapara. Dashja, do të thotë dëshirë për paraqitjen e pasojave të parapara. Vetëm pasojat e parapara, edhe nëse ato janë të sigurta, nuk janë të mjaftueshme për ekzistimin e dashjes, nëse nuk ka dëshirë. Do të them, nuk ka dashje edhe me ekzistimin e vetëdijes për pasojën nëse kryesi nuk i ka dëshiruar atë paraqitje. Të dyja teoritë e përmendura kanë kundërshtime të mëdha. Teoria e vetëdijes ka vërejtje në përhapjen e nocionit dhe përmbajtjes së dashjes, ndërsa e ngushton nocionin e pakujdesisë. Kjo teori e përjashton ekzistimin e dashjes së vetëdijshme, sepse e transformon në dashje. Teoria e dëshirës ngushton nocionin e dashjes, por e përhap nocionin e pakujdesisë. Kjo teori e konteston, përjashton ekzistimin e dashjes eventuale sepse e kualifikon në pakujdesi të vetëdijshme. Teoria e kompromisit i ka ruajtur konceptet themelore të dy kuptimeve të cekura më lartë, por e ka përjashtuar miratimin e tyre.

Sipas kësaj teorie dashja ekziston atëherë kurrë ekzistojnë vetëdija dhe dëshira. Ky element i dashjes si dëshirë dhe pajtim e ka mundësuar që dashja të marrë përmbajtjen reale dhe të ndahet nga pakujdesia. Për ekzistimin e dashjes është e duhur të ekzistojë dhe elementet i vetëdijes dhe i dëshirës. Vetëdija paraqitet me dije, paraqet rrethanë të vërteta (tiparet), të veprës penale, e dëshira pajtimin e veprës së kryer, d.m.th pajtimi me paraqitjen e saj. Nëse mungon njëri nga këto elemente atëherë nuk ekziston as dashja. Sipas nenit 15 KP të Kosovës vepra penale e kryer me dashje kur kryesi është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj, ose kur është i vetëdijshëm që për shkak të veprimit ose mosveprimit të tij mund të paraqiten pasojat e ndaluara, atëherë ai është pajtuar me shkaktimin e saj. Nga ky definicion del që Kodi përkohshëm i Kosovës e pranon teorinë e kompromisit, duke filluar nga fakti që elementi i vetëdijes dhe i dëshirës ngatërrohet në raportin psikik në mes kryesit dhe veprës, dhe dashja nuk mund të kuptohet në bazë të ekzistimit vetëm të vetëdijes ose vetëm të dëshirës.

Sipas kësaj, për të ekzistuar dashja është e nevojshme që të ekzistoj dhe vetëdija dhe dëshira, d.m.th elementi intelektual dhe voluntaristik (emocional). Kodi penal në pjesën e përgjithshme dallon dy forma të dashjes: dashjen direkte dhe indirekte, për deri sa në pjesën e veçantë parashihet dhe forma e tretë e dashjes-dashja në afekt, të dy veprat penale: vrasja e kryer në gjendje të afektit mendor (neni 148 KP) dhe të ashtuquajtura lëndime të rënda trupore në afekt (neni 154. paragrafi 6. KP)

2.10.1 Llojet e Dashjes

a) Dashja direkte (dellus directus)

Dashja direkte ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e asaj vepre. Për të ekzistuar dashja direkte të kryesi duhet të ekzistoj vetëdija për veprën e kryer, d.m.th të ekzistoj elementi intelektual dhe voluntaristik në raport me veprën e kryer. 1) Vetëdija për veprën e kryer d.m.th që kryesi ka dijeni, përkatësisht paraqitje për veprën dhe pasojën, lidhjen reciproke ndërmjet tyre, objektet si dhe rrethanat të cilat paraqesin tiparet e elementeve qenësore të veprës penale siç janë: vendi, koha, mënyra dhe mjetet e kryerjes së veprës penale. D.m.th, vetëdija për veprën duhet ta përmban vetëdijen për të gjitha rrethanat e vërteta të cilat paraqesin tipare të veprës penale. Nëse kryerësi i veprës penale nuk ka qenë i vetëdijshëm për disa rrethana të vërteta të cilat paraqesin tiparet e veprës penale, atëherë të ai nuk ekziston dashja në raport me atë vepër. Në rrethana të vërteta bëjnë pjesë jo vetëm faktet fizike, por edhe juridike nëse paraqesin elemente, përkatësisht tipare të elementit qenësor veprës penale të caktuar. Por, për dashje direkte nuk është e domosdoshme çdo herë të ekzistojë vetëdija e kryesit për kualifikime të fakteve të vërteta, siç nuk është e domosdoshme as vetëdija për vepra kundërligjore, sepse fillohet nga supozimi juridik që çdo person i aftë mendërisht mund ta vlerëson rëndësinë e veprës shoqërore dhe juridike. Ky supozim megjithatë ka karakter relativ, sepse mund të dëshmohet dhe e kundërta. Vetëdija për veprën kundër ligjore kërkohet në ato raste kur ekziston elementi qenësor kundërligjor i veprës juridike.⁹²

⁹² Vllado Kambovski (2011), Komentari i Kodit Penal të RM-së, 2011;

Vetëdija te dashja nuk duhet të kuptohet si kusht objektiv të inkriminimit (motivin i dënimit në legjisllacion) sepse ai nuk parqet element qenësor të veprës penale. 2) Dëshira për kryerjen e veprës ekziston atëherë kur kryerësi ka dëshiruar paraqitjen e pasojave të parapa të veprës, përkatësisht kur kryerësi e ka ndërmarrë kryerjen e veprës (në kuptim të veprimit ose mos veprimit) me synim të plotësimit të pasojës në objektin e sulmit e cila paraqet tipare të elementit qenësorë të veprës penale e paraparë në ligj (P.sh.: vrasja nga xhelozia ose vrasja për hakmarrje të paskrupullt). Kryerësi gjithashtu gjatë paraqitjes të kësaj forme të dashjes dëshiron paraqitjen dhe pasojave të cilat duhet të shërbejnë si mjet për realizimin e pasojës kryesore, e ashtuquajtura pasoja paraprake (p.sh.: vrasja për trashëgimi, ose falsifikimi i dokumenteve për shkak të punësimit). Gjithashtu, dëshira e kryerësit përfshin dhe pasojën e cila domosdo ekziston së bashku me pasojën kryesore në të cilën është orientuar vepra, to te thotë pasoja e rastit (p.sh. personi A me dashje e vranë personin B, e gjuan mjetin eksploziv në hapësirën në të cilën përveç personit B gjenden dhe personat C dhe D). Më në fund, kryesi e ka dëshiruar pasojën dhe atëherë kur është i vetëdijshëm që pasoja do të paraqitet pas plotësimit të qëllimit të tij (p.sh. vrasja e nënës e cila e ushqen me gji fëmijën e porsalindur, ose vrasja e mjekut i cili është i vetmi me aftësi profesionale i cili në moment mund ta shpëtojë pacientit e caktuar). Elementi i dëshirës presupozon nxjerrjen e vendimit paraprak të kryesit që të ndërmerr veprimin me të cilin do të realizojë pasojën e veprës penale.⁹³

b) Dashja eventuale (dollus eventualis)

Dashja eventuale ekziston atëherë kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm që për shakë të kryerjes së veprës së tij, përkatësisht moskryerjes mund të paraqitet pasoja e ndaluar, dhe kështu është pajtuar me paraqitjen e veprës. Për dallim nga dashja direkte këto elemente te vetëdijes dhe dëshirës janë të paraqitura më pak. Kjo formë e dashjes përbëhet nga dy elemente: vetëdija për mundësinë e paraqitjes së pasojës dhe pajtimi me pasojën. Vetëdija për mundësinë e paraqitjes së pasojave ekziston atëherë kur kryesi parasheh që nga veprimi i tij mund të paraqitet pasoja e ndaluar.

⁹³ D. Kiprijanovska , (2009) Disa aspekte të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e saj, Përmbledhje e veprave për nder të prof. Dr Todor Xhunov, Fakulteti i Drejtësisë "Justiniani i parë", Shkup, 2009;

D.m.th, këtu nuk ekziston në formë të pasojës së sigurisë dhe të vërtet, por vetëm mundësia e paraqitjes së saj. Vetëdija për mundësinë e paraqitjes së pasojës duhet të përfshij të gjitha rrethanat e vërteta të cilat përmbajnë tiparet e elementit qenësorë të veprës penale, kështu që në përmbajtje vetëdija nuk dallohet në mes të dashjes direkte dhe eventuale, por ajo pasqyrohet në intensitetin, përkatësisht shkallën e vetëdijes. Ekzistimi i vetëdijes për mundësinë e paraqitjes së pasojës d.m.th që kryesi i veprës penale nuk parasheh pasojë të veprës së vetë si diçka e sigurt dhe të vërtet, por si diçka që është e pranishme si rrezik. Më së shpeshti deri te dashja eventuale vihet për shkak të mungesës së marrëdhënies reciproke në mes të veprës të ndërmarrë dhe pasojës, paraqitja e së cilës parashihet ashtu që nuk shihet paraqitja e sigurtë e pasojës por vetëm supozimi për paraqitje të saj. 2) Pëlqimi për paraqitjen e pasojës, për dallim nga dashja direkte në të cilin elementi i dëshirës është i paraqitur me dëshirë për pasojë të paraparë, te dashja eventuale elementi i dëshirës është i paraqitur në pajtim me paraqitjen e sajë. Pajtimi do të thotë pajtimi i kryesit me pasojat e mundshme të paraqitura të cilat nuk dëshirohen në mënyrë direkte.⁹⁴ Me fjalë të tjera, pasoja e cila parashihet si e mundshme arsyetohet si pajtim i saj me paraqitje të saj. Te dashja eventuale vepra merret me synim që të kryhet një pasojë tjetër, e jo ajo me të cilën pajtohem. Objektivi i veprës është një rezultat tjetër, një pasojë tjetër, me të cilën kjo shkon si mundësi, si rrezik i shkalles së lartë me të cilat kryesi pajtohet për të mundur të arrijë pasojën e dëshiruar dhe të synuar. Sipas kësaj, pajtimi do të thotë pranim i rrezikut, pajtim me paraqitjen e pasojës së padëshiruar.

c) Dollus antecedent dhe dolus subsequens (consequent)

Dollus antecedents (dashja paraprake) i paraprinë ndërmarrjes së veprave të kryera. Meqë dashja duhet të paraprinë veprës së kryesit ky lloj i dashjes nuk ka rëndësi të posaçme dhe barazohet me nocionin e përgjithshëm të dashjes. Dollus supcuenes (dashja e ndërkohëshme) paraqitet pas kryerjes së veprës penale dhe nuk ka ndikim në shkallën e përgjithësisë penale e cila përcaktohet sipas kohës së kryerjes së veprimit. Lejimi i ndërkohshëm i veprës penale të kryer nga pa kujdesia veprën penale mund ta shendroj në vepër të kryer me dashje.

⁹⁴ D. Kiprijanovska , (2009) Disa aspekte të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e saj, Përmbledhje e veprave për nder të prof. Dr Todor Xhunov, Fakulteti i Drejtësisë "Justiniani i parë", Shkup, 2009;

Dashja e ndërkohshme merret vetëm si rrethanë e caktimit të dënimit, sepse ajo përcakton qëndrimin e kryesit pas kryerjes së veprës.

d) Dolus repentinus i dollus praemeditatus

Dolus repentinus është dashje e ndërkohshme e cila paraqitet pa mendim paraprak për veprën penale. Kjo është dashje në afekt. Kodi penal vetëm në dy raste vërteton dashjen e ndërkohshme si rrethanë zbutëse, dhe atë të vrasjet në afekt dhe të lëndimet e rënda trupore të shkaktuara në afekt. Në raste të tjera mund të jetë e rëndësishme vetëm të shqiptimi i dënimit. Dollus repentinus ose paramendimi ekziston të rastet kur vendimi është marrë me paramendim, d.m.th. kur kryerësi një kohë të gjatë me gjak ftohtësi dhe në detaje ka menduar për veprën, para se e ka kryer atë. Në disa legjislacione para dashja merret si forma më e rëndë e dashjes, e në disa legjislacione paramendimi merret si formë më e rëndë e dashjes, e në disa të tjera rrethanë e ashpërsuar.

e) Dolus determinatus i dolus indeterminatus

Dolus determinatus është dashje e caktuar e cila ekziston kurrë kryesi e ka realizuar pasojën të cilën dhe e ka paraparë. Ajo i përgjigjet nocionit dhe përmbajtjes së dashjes direkte. Dolus indeterminatus është dashje e papërcaktuar e cila ekziston atëherë kurrë kryesi e ka paraparë pasojën, por vetëm në kornizat e përgjithshme. Dolus indeterminatus mund të paraqitet në dy forma si: dolus alternativus dhe dolus eventualis. Dolus alternativus paraqitet atëherë kurrë kryesi i ka parapa më shumë pasoja në atë mënyrë që vetëm njëra prej tyre mund të paraqitet (Kruglikov, et al, 1999:202). Për shembull, nëse dikush gjuan në dy persona të cilët bisedojnë ai është i vetishëm se njërin nga ata mund ta plagos ose vranë, por ju të dy personat. Dolus eventualis ekziston atëherë kurrë kryesi i ka parapa më shumë pasoja, por njërin e parashe si të sigurt, të tjerat vetëm si të mundshme.

Për shembull, kurrë kryesi në rrugë gjuan me revole në një person, ai është i vetishëm që nga revolja do ta vranë atë, por parashe që edhe dikën tjetër mund ta plagos ose vranë, dhe ai person pajtohet me pasoja të mundshme.

f) Dolus generalis dhe dolus specialis

Dolus generalis ekziston atëherë kur kryesi gabimisht beson që me veprën të kryer ka shkaktuar pasojën të cilën e ka dëshiruar, dhe ndërmerr veprim tjetër ndaj objektit të njëjtë, por në drejtim tjetër (p.sh. ti mënjanoj gjurmët) dhe me veprimin e dytë ai arrin pasojën e dëshiruar për të cilën mendon se e ka shkaktuar me këtë veprim. Tjetri dolus specialis përmban nocionin e përgjithshëm të dashjes.⁹⁵

2.11 Pakujdesia (culpa), kuptimi sipas Legjislacionit penal vendas

Pakujdesia është forma e dytë e fajit dhe për nga intensiteti i përgjegjësisë penale është formë më e lehtë e fajësisë. Marrë në përgjithësi në aspektin e së drejtës penale, pakujdesia ekziston atëherë kur kryesi nuk e dëshiron pasojën e shkaktuar, përkatësisht kur pasoja shkaktohet kundër vullnetit të tij. Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, në nenin 23 është paraparë instituti i pakujdesisë. Në paragrafin e parë është përcaktuar se vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Në paragrafin e dytë ceket se, personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj. Ndërsa, në paragrafin e tretë të po këtij neni ceket se personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.

⁹⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elshani: Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, 2014.

Në të drejtën penale konsiderohet se një person e ka kryer veprën penale nga pakujdesia në rastet kur nuk i ka respektuar kërkesat e shoqërisë që në veprimtarinë apo sjelljet e tij të jetë i kujdesshëm. Me fjalë të tjera, konsiderohet se një person e kryen veprën penale nga pakujdesia kur pasoja e dëmshme është rezultat i moskujdesit, indiferencës apo joseriozitetit të tij. Me pakujdesi shkaktohet pasoja e dëmshme (vepra penale), e cila ka mundur të mos shkaktohet po të ishte kryesi më i kujdesshëm. Ky moskujdes, i cili rezulton në veprë penale, kryesisht tregon mungesë të adaptimit social të kryesit dhe mungesë të ndjesisë që të respektohen vlerat e jetës së përbashkët dhe në një masë është edhe mungesë e kulturës.⁹⁶ Pakujdesia (culpa) është formë e dytë e fajësisë, dhe paraqet raport psikik ndaj veprës e paraqitur dhe pasojës se shkaktuar e cila nuk është e dëshiruar. Kjo është kryerja e veprës penale pa dashje. Raporti psikik i kryesit shfaqet përmes një komponente, vetëdijes për mundësinë e paraqitjes se pasojës se padëshiruar ose ne mundësin e ekzistimit të vetëdijes. Kur komponenta psikologjike është e paraqitur vetëm me ekzistimin e vetëdijes, e cila nuk ka ekzistuar në momentin e ndërmarrjes së veprimeve në raport me pasojën, është e duhur dhe komponenta socialo- etike e shprehur në ekzistimin e detyrimit që pasoja të parashihet.

Pra parashikimi i pasojës së ndaluar e cila ka mund të parashihet, do të thotë që nuk ka ekzistuar vëmendje e posaçme të cilën rendi juridik e kërkon nga çdo qytetar si njeri mesatar. Pasi që dashja është formë e fajësisë e cila paraqitet sipas rregullave, nuk përcaktohet në elementin qenësor të veprës penale siç është rasti me pakujdesin. Pakujdesia në teorinë bashkëkohore (posaçërisht atë gjermane) është përshkruar si element qenësor i veprës penale. Për dallim nga dashja pakujdesia nuk nënkupton çdo herë përgjegjësin dhe cenimin. Përgjegjësia dhe dënimi për veprat e kryera nga pakujdesia ekzistojnë vetëm atëherë kurrë ligji e shqipton atë. Lidhur me nocionin, përmbajtjen e dashjes ekzistojnë më shumë teori: teoria e vetëdijes, teoria e dëshirës dhe teoria normative. Sipas teorisë së vetëdijes (teoria intelektuale) pakujdesia është mungesë e vetëdijes në raport me pasojën. Pakujdesia ekziston kur kryesi nuk ka pas vetëdije dhe parafytyrim për pasojat, por ka mundur të këtë po të ishte më preciz në vlerësimin e veprimit të ti. Sipas kësaj, esenca e pakujdesisë përbëhet nga parashikimi i pasojës e cila ka mund të parashikohet.

⁹⁶ Borisllav Petroviq, vep e cit, fq. 82

Pakujdesia paraqitet si gabim i mendjes. Sipas teorisë se dëshirës (teoria voluntaristike) pakujdesia paraqitet si mosekzistim i vetëdijes ne raport me pasojën, për shkak te përpjekjes se pamjaftueshme te kryesit ta aktivizoj fuqinë e vet te gjykimit dhe vlerësimit te mundësisë kauzole te shkaktuar si pasoj. ⁹⁷Pakujdesia paraqitet si jo dëshirë, si mungesë e përpjekjes për dëshirë. Sipas teorisë normative pakujdesia është mungesë e kujdesit te duhur. Pakujdesia si dhe fajësia ekzistojnë atëherë kur përcaktohet se kryesi gjatë ndërmarrjes se veprimit nuk ka treguar atë kujdes të cilin e kërkon rendi juridik, te cilën ai ka mundur ta tregoj duke i pasur parasysh rrethanat e rastit si dhe aftësitë e veta personale. Pakujdesisë është cenim i kujdesit te duhur, duke mos përfillur dhe duke u sjellur me joseriozitet ndaj kërkesës së shoqërisë. Në kuadër të kësaj teorie dallohen kuptime sipas të cilave pakujdesia është formë e posaçme e sjelljes së dënueshme e cila ngërthen në veti padrejtësinë dhe fajësinë. Mos ekzistimi i kujdesit të detyruar përkatësisht “sjellja e kundërligjme” mund të rezultojë nga pakujdesia dhe jo serioziteti ose nga mungesa e kuptimit për tu përshtatur kushteve shoqërore të jetës dhe duke i respektuar vlerat, ose kjo sjellje paraqitet si rezultat i lajthitjes e cila ekziston te kryesi ndaj lidhjes reciproke ndërmjet veprimit dhe pasojës ose në kuptim të aftësisë së vet për parandalimin e pasojave. Struktura e pakujdesisë është hibride⁹⁸. Përveç elementeve psikologjike ajo në veti përmban dhe elemente normative, sociale dhe etike. Mungesa psikologjike siç është mos ekzistimi i precizitetit në vlerësimin e ndikimeve të veprave të kryera, d.m.th vlerësimit të gabuar të mundësisë kausale të paraqitjes së pasojave ose mos ekzistimit te paraqitjes për shkak të lajthitjes. Kësaj i bashkëngjitet edhe moskujdesi për tu tërëhjekur lajthitja dhe për tu vlerësuar pa shmangja ose siguria. Në teorinë bashkëkohore të legjislacionit është e përfaqësuar teoria e kombinuar e vetëdijes dhe dëshirës me elemente normative. Përcaktimi i pakujdesisë nisët nga fakti qe te kryesi duhet të ekzistojë raport i caktuar psikik ndaj veprës se paraqitur ose vetëdijen për mundësin e pasojave ose shkakut dhe mundësisë për parashikimin e pasojës. Kështu në nenin 16 KP të Kosovës vepër e kryer nga pakujdesia konsiderohet ajo vepër ne te cilën kryerësi ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund te shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit te ti, por, me mendjelehtësi, mendon se ajo nuk do te shkaktohet apo se ai do te mund te parandaloj shkaktimin e saj. Do te thotë se dallimi në mes të dashjes dhe pakujdesisë paraqitet ne në elementin e dëshirës për pakujdesi. Elementi i dëshirës paraqitet në pajtimin më pasojën,

⁹⁷ 83ekziston fare. Nga këto nene ligjore del që ekzistojnë dy lloje të pakujdesisë: pakujdesia e vetëdijshme dhe pavetëdijshme. Teoria juridike e pranon dhe pakujdesinë profesionale.

⁹⁸ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 104 -105

përderisa te pakujdesia elementi i dëshirës nuk 83ekziston fare. Nga këto nene ligjore del që ekzistojnë dy lloje të pakujdesisë: pakujdesia e vetëdijshme dhe pavetëdijshme. Teoria juridike e pranon dhe pakujdesinë profesionale.⁹⁹

2.11.1 Llojet e Pakujdesisë

2.11.2 Pakujdesia me vetëdije (luxuria).

Sipas paragrafit 2 të nenit 23, ekziston atëherë kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, apo se ai do të mund të parandalojë shkaktimin e saj. Karakteristikë kryesore dhe tipike e pakujdesisë me vetëdije është se kryesi nuk e dëshiron pasojën, madje as nuk e pranon, nuk dakordohet me shkaktimin e saj. Shprehja mendjelehtësi apo pakujdesi me vetëdije, të cilën e përdor ligjdhënësi për ta përcaktuar këtë lloj të fajësisë, ka për qëllim që veprimin e kryesit ta kualifikojë si sjellje mendjelehtë, sipërfaqësore, të papërgjegjshme, indolente, apo sjellje me të cilën ai i ka mbivlerësuar aftësitë e veta. Nga përkufizimi i pakujdesisë që është përcaktuar në Kodin Penal dhe nga kjo që u tha, del se kjo formë e fajit përbëhet prej dy elementeve:

a) Prej vetëdijes mbimundësinë e shkakimit të pasojës dhe

b) Prej shpresës apo bindjes se do të mund ta parandalojë shkaktimin e pasojës, apo pasoja nuk do të shkaktohet fare.¹⁰⁰

Dallimi i dashjes eventuale nga pakujdesia me vetëdije. Në aspektin teorik janë përcaktuar kritere mjaft të qarta, në bazë të të cilave mund të bëhet dallimi midis dashjes eventuale dhe pakujdesisë me vetëdije. Mirëpo, në praktikën gjyqësore është mjaft vështirë të bëhet dallimi i dashjes eventuale nga pakujdesia; ngase siç pamë më sipër, shumica e kritereve, në bazë të të cilave bëhet dallimi midis këtyre dy llojeve të fajësisë, janë të natyrës subjektive, dhe i përkasin elementit intelektual dhe volitiv të kryesit.

⁹⁹ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 104 -105

¹⁰⁰ Po aty.

Për këtë arsye, me të drejtë thuhet se tërheqja e paraleles midis dashjes eventuale dhe pakujdesisë është njëra ndër çështjet më të vështira dhe më diskutabile në të drejtën penale.¹⁰¹

2.11.3 Pakujdesia pa vetëdije (negligentia).

Pakujdesia pa vetëdije apo neglizhenca ekziston kur personi nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mos veprimit të tij edhe pse në rrethana dhe sipas vetive të tijpersonale ka mundur të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.¹⁰²Kështu që te pakujdesia pa vetëdije na paraqitet situatëkur kryesi i veprës penale, veprën penale nuk dëshiron që ta kryej por as që ka supozuar se me veprimin ose mosveprimin e tij do të kryej vepër penale.Prandaj,dallimi në mes pakujdesisë me vetëdije dhe pakujdesisë pa vetëdije ekziston se te pakujdesia me vetëdije, kryesi e parashih mundësinë se me veprimin ose mosveprimin e tij mund të kryhet vepër penale, ndërsa te pakujdesia pa vetëdije, kryesi nuk është i vetëdijshëm, nuk e parashih mundësinë që nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të kryhet vepër penale. Kështu që,pakujdesia pa vetëdije dallon nga llojet e tjera të fajësisë sepse këtu mungon raporti psikik ndaj veprës penale, pra mungon elementi intelektual dhe i vetëdijës, si për shembull gjuetari shtien në egërsirë, mirëpo me atë rast godet njeriun që ka qenë duke prerë dru në mal; një i ri në shaka gjuan tjetrin me top bore me ç'rast e godet në sy dhe i shkakton lëndim të rëndë trupor.

Neglizhenca ekziston atëher kur personi nuk e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, megjithëse sipas rregullave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte.¹⁰³Mosparashikimi i pasojave mund të vijë nga paaftësia intelektuale e personit për të parashikuar, kuptuar dhe vlerësuar lidhjet që krijohen midis fenomeneve ose nga pamundësia objektive e këtij parashikimi në rrethanat ku kryhet vepra. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për përgjegjësinë penale.¹⁰⁴Përgjegjësia penale ekziston kurpersoni i ka aftësitë për të parashikuar pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij, kur nuk ka rrethana objektive penguese në këtë

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Ismet Salihu, vep. e cit., fq. 312.

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Ismet Salihu, vep. e cit., fq. 312.

aspekt. Sigurisht ndonëse në këtë lloj pakujdesie mungon shfaqja e vullnetit në sjelljen e personit, ligji ka parashikuar se ai i ka pasur mundësitë për ta shprehur vullnetin, duke parandaluar ardhjen e pasojave të dëmshme.¹⁰⁵ Me rastin e përcaktimit të pakujdesisë pa vetëdije duhet të merren parasysh dhe të ndriçohen dy grupe rrethanash apo faktesh, të cilat edhe pse shqyrtohen ndaras, ato janë të lidhura ngushtë mes vetes dhe e kushtëzojnë njëra-tjetrën. Grupi i parë i rrethanave i përket situatës reale, kushteve objektive në të cilat personi ka vepruar, pra janë a) rrethana të natyrës objektive. Grupi i dytë i rrethanave i përket b) vetive dhe aftësive të kryesit, pra janë rrethana të natyrës subjektive. Obligimi për t'i ndriçuar këto dy grupe rrethanash rrjedh prej nenit 23, par. 3 të Kodit Penal. Në grupin e parë të rrethanave, të kushteve dhe situatës në të cilat është kryer vepra duhet të merren parasysh dhe të ndriçohen rrethanat e ndryshme objektive, siç janë p.sh. a ka qenë natë, a ka pasur mjegull, rruga e rrëshqitshme me borë dhe akull, rruga e terur, çfarë mundësie e të parit ka ekzistuar, mjetet të cilat i ka pasur kryesi, a ka pasur mundësi kryesi të mendojë më gjatë apo është dashur të vendosë shpejt etj. Lidhur me këtë, është më se e domosdoshme të kihet parasysh natyra e situatës dhe karakteri i veprës penale të kryer. Për shembull, në një mënyrë do të vlerësohet pakujdesia e sjelljes gjatë prodhimit të artikujve që ndezën lehtë, dhe ndryshe gjatë prodhimit të artikujve ku nuk ekziston ky rrezik.

Është detyrë e gjykatës, që në çdo rast konkret, t'i marrë parasysh dhe t'i ndriçojë të gjitha rrethanat që mund të ndikojnë, për të mundur të konstatohet nëse kryesi ka qenë i obliguar dhe a ka mundur të jetë i vetëdijshëm se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Në grupin e dytë të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale me pakujdesi pavetëdije duhet marrë parasysh vetitë, aftësitë dhe atributet e tjera subjektive të kryesit të veprës penale, në mënyrë që të konstatohet se kryesi ka qenë i detyruar dhe kamundur të jetë i vetëdijshëm se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Në këtë aspekt, në procedurën penale provat duhet të administrohen ndaj njeriut konkret që e ka kryer veprën penale konkrete në situatën dhe rrethanat e caktuara. Me këtë rast vendimtare janë vetitë, aftësitë dhe gjendja momentale psikike dhe fizike e kryesit të veprës penale, siç janë p.sh.: aftësia e të pamurit, aftësia e perceptimit dhe e reagimit, shëndeti, moshja, zhvillimi psikik, profesioni, përvoja, lodhja, pagjumësia, frika si dhe rrethanat e tjera që e karakterizojnë personalitetin e personit në fjalë dhe të cilat në rastin konkret kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në

¹⁰⁵ Kometari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, faqe 112, Prishtinë 2014

mundësinë për të ditur dhe për të supozuar se nga sjellja dhe veprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Mirëpo, me këtë rast për të mundur të konsiderohet se vepra është kryer me pakujdesinë pavetëdije, duhet mbështetur në supozimin dhe njohuritë se ndonjë person tjetër, i cili sipas vetive, aftësive dhe tipareve të tjera, që më së tepërmi janë të ngjashme me personalitetin e kryesit të veprës, a do të kishte mundësi të parashihte se nga veprimi apo sjellja e tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar.¹⁰⁶

2.11.4 Faji dhe format e tij sipas Kodit Penal të Shqipërisë

Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi. Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale. Nisur nga fakti që ligjvënësi shqiptar në një dispozitë të vetme, sikurse është ajo e nenit 3 të Kodit Penal, ka përcaktuar veprimin e ligjit penal në kohë, jo vetëm në përgjithësi, sipas parimit që askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale, por edhe duke dhënë përjashtimet nga ky parim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, ka përmbajtja e paragrafëve të dytë dhe të tretë të kësaj dispozite, në të cilat parashikohen përjashtimet nga rregulli ipërgjithshëm i veprimit në kohë të ligjit penal dhe brenda tyre, lidhje më të drejtpërdrejtë me këtë çështje, pa dyshim, që ka paragrafi i tretë i saj.¹⁰⁷ Nga përmbajtja e këtij paragrafi, sipas të cilit, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale, arrihet në përfundimin se, në rastet kur, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është më i disfavorshëm se ligji që është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të personit që e ka kryer atë, gjykatat detyrohen të zbatojnë këtë të dytin d.m.th. ligjin e mëvonshëm, i cili është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes.

¹⁰⁶ Ismet Salihu, vep. e cit. fq. 317.

¹⁰⁷ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, Dhjetor 2014

Ky detyrim rrjedh nga fakti që, në rastin konkret, ligji i mëvonshëm përmban dispozita, të cilat janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale ose, duke përdorur terminologjinë kushtetuese, duhet thënë se ligji i mëvonshëm është ligj penal favorizues dhe pikërisht për këtë arsye, ai ka fuqi prapavepruese. Megjithatë, duhet vënë në dukje fakti që fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, në raport me momentin kohor të zbatimit të tij, nuk është e pakufizuar, pasi ky moment është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal, që i përket personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, fazë e cila, duke u bazuar në sa u thanë me hollësi më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në përfundimin se nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar, ka marrë formë të prerë, gjë që vlen edhe për personat e dënuar me vendim penal të formës së prerë të gjykatave të huaja penale, sikurse është rasti objekt gjykimi. Të gjitha çështjet e tjera, që mund të lindin pas këtij momenti, i përkasin një faze tjetër, asaj të ekzekutimit të vendimit penal. Dihet se ndryshe nga fuqia prapavepruese e ligjit penal, që përfshihet në institutin e veprimit penal në kohë, institut, i cili rregullimin e tij ligjor e gjen në normat e ligjit penal material, faza e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet nga normat e ligjit procedural penal, nocione këto që konfondonen në kërkesën e paraqitur nga mbrojtësi i kërkuesit Juan.¹⁰⁸

Bazuar në sa u parashtrua me hollësi në pjesët e përparshme të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin e përgjithshëm se paragrafi i tretë i nenit 3 të Kodit Penal është i zbatueshëm në procedimet penale të vëna në lëvizje pas hyrjes në fuqi të ligjit favorizues, si dhe në procedimet penale, të cilat, megjithëse janë vënë në lëvizje para hyrjes në fuqi të ligjit favorizues, gjykimi për to nuk ka përfunduar ende me vendim të formës së prerë. Kështu që, personat, vendimi i dënimit penal për të cilët ka marrë formë të prerë, sikurse është rasti i kërkuesit Juan, nuk mund të përfitojnë nga ligji i mëvonshëm, edhe pse ai mund të jetë favorizues në raport me ligjin penal që u zbatua nga gjykatat në kohën e dënimit të tyre. I vetmi përjashtim nga ky rregull, në kushtet e zakonshme të zbatimit të Kodit Penal, bëhet vetëm për personat e dënuar me vendim të formës së prerë, kur ligji i ri, veprën për të cilën ata janë deklaruar fajtorë dhe dënuar, nuk e konsideron më vepër penale. Dhe këtë përjashtim e ka bërë vetë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenit 3 të Kodit Penal, sipas të cilit, ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese dhe në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit

¹⁰⁸ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, Dhjetor 2014

nuk mund të fillojë dhe në qoftë se ka filluar, pushon. Thuhet, “në kushtet e zakonshme të zbatimit të Kodit Penal”, pasi ligjvënësi, mbas miratimit të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë me dy ligje të veçanta, të miratuara ad`hoc me nr.7942 dhe 7984 të datave, respektivisht, 31.5.1995 dhe 28.7.1995, miratuar për hyrjen në fuqi të Kodit Penal, ka parashikuar shprehimisht që personave të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë për një ose më shumë vepra penale me masa dënimi, për një ose më shumë prej tyre, më të larta sesa maksimumi që parashikon për to Kodi i ri Penal, ju mbetet për secilën prej tyre, ky maksimum (nenet 2 dhe 1 të ligjeve respektive). Nëpërmjet këtyre dy ligjeve, kanë përfituar vetëm personat që ishin dënuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, d.m.th. me kodet e mëparshme penale dhe një gjë e tillë ishte jo vetëm e domosdoshme, por edhe e kuptueshme, për shkak të disa ndryshimeve jo pak të rëndësishme, që pësoi instituti juridik i përgjegjësishë penale dhe elemente përbërëse të tij në Kodin e ri Penal, në krahasim me të mëparshmet.¹⁰⁹ Sipas nenit 14 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është e kryer me faj. Quhet me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi.¹¹⁰

2.11.5 Faji dhe format e tij sipas Kodit Penal të Kosovës

Veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa dhunën penalo juridike. Parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penalo juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës kemi këta lloje të fajit, neni 14 kemi Dhuna ose kanosja 1.

¹⁰⁹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, Dhjetor 2014

¹¹⁰ Po aty.

Vepra e kryer nën ndikimin e dhunës së papërballueshme ose kanosjes së papërballueshme nuk është veprë penale vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente. 2. Nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e dhunës së përballueshme apo kanosjes së përballueshme, dënimi mund të zbutet vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente. 3. Kushdo që përdor dhunën ose kanosjen sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni konsiderohet kryes i veprës penale. Veprat e kryera nën shtrëngim. 1. Vepra e kryer nën shtrëngim nuk është veprë penale. Vepra kryhet nën shtrëngim kur personi i ballafaquar me dhunën e pashmangshme apo kanosjen e dhunës që nuk mund të shmanget e që rrezikon jetën, trupin ose lirinë, kryen veprë të kundërligjshme për të mënjanuar rrezikun nga vetja ose personi me të cilin ka lidhje familjare. Vepra do të konsiderohet se është kryer nën shtrëngim vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente. 3. Vepra nuk kryhet nën shtrëngim nëse dhe deri në masën që nga kryesi mund të pritët në rrethanat e shkaktuara që të pranojë rrezikun, në veçanti nëse ai ka shkaktuar rrezikun ose nëse ka qenë i detyruar ligjërisht që të ballafaqohet me një dhunë të tillë të atëçastshme apo me kërcënim të dhunës. Në rrethana të tilla dënimi mund të zbutet (neni 15).Përgjegjësia penale Kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.Një person është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji. 3. Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet (neni 17).

Neni 18 Paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore 1. Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor dhe si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje të kuptojë natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ose nuk ka qenë në gjendje t'i kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen veprë penale. 2. Person i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni.

Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm. Dashja Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. 2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj 3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj. Neni 23 Pakujdesia Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj. Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi. Neni 28 Tentativa Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë tjetër vepër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.

2.12 Rëndësia në përcaktimin e përgjegjesisë penale nëse egziston ose jo vepra penale

Kur të se kryesi në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur përgjeksi dukshme të zvogluar mund të dënohet më butë. Zvoglimi i përgjegjshmërisë është bazë fakultative për zbutjen e dënimit. Sipas disa ligjeve penale kur gjykata konstaton se ndonjë person veprën penale e ka kryer në gjendje të përgjegjesisë esencialisht të zvogluar, kryesi duhet të dënohet më butë (e ashtquajtura zbutje obligative). Sipas ligjeve tjera kryerja e veprës penale në gjendje të përgjegjesisë esencialisht të zvogluar është bazë sipas të cilës gjykata mundet kryesin ta gjykojë më butë (e ashtëquajtura zbutje fakultative.).

KPPK, ka akceptuar variantën e zbutjes alternative të zbutjes së dënimit (Prof. Ismeti në librin e tij mendon se kjo rrethanë e obligon gjykatën që ta zbutë dënimin). Nëse kryesi në momentin e kryerjes së veprës penale ka pasur përgjegjësi esencialisht të zvogluar (neni 12, par. 2. të KPPP). Nëse gjykata konsideron se aftësia e të pandehurit që të kuptoj rëndësinë e veprës së vet apo t'i kontrolloj veprimet e tia nuk ka qenë e tillë që do të ishte bazë për zbutjen e dënimit, kjo rrethanë merret parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e matje së dënimit.¹¹¹

Aplikimi i masave siguruese ndaj kryesve të veprave penale me përgjegjësi esencialisht të zvogluar. Nëse gjykata konstaton se kryesi i veprës penale me përgjegjshmëri esenciale të zvogluar është e në të ardhmen i rrezikshëm për rrethin ku jeton, atëherë mundet kryesit të këtillë, krahas dënimit, t'i shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik (neni 76), apo trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri, i cili mund të shqiptohet bash me dënimin me kusht nën mbykqyrjen e shërbimit sprovues (neni 52 KPPP. Ose nenit 3. të rregullorës nr. 2004/04 Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore). Krahas dënimit, njëra prej këtyre dy lloje të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik u shqiptohet posaçërisht kryesve abnormalë të veprave të veprave penale nga radha e psikopatëve, të cilët zakonisht janë, jo vetëm në gjendje të përgjeshmërisë esenciale të zvogluar, por edhe në të ardhmën paraqesin rrezik. Në të drejtën penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse të ai ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar psikike ndaj veprës të cilën e ka kryer, dmth., ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Përgjegjësia penale është vetëm element subjektiv apo psikik i veprës penale. Ky është njëherit kuptim i ngushtë i përgjegjësisë penale. Në teorinë e se dr. penale njihet edhe kuptimi i gjerë apo kuptimi objektivo-subjektiv i përgjegjësisë penale. Sipas këtij kuptimi përgjegjësia penale përbëhet prej veprës penale si element objektiv dhe përgjegjësisë dhe fajësisë si elemente subjektive. Pra, Kodi ynë penal nuk parasheh norma të posaçme me të cilat rregullohet çështja e përgjegjësisë penale për veprat që kryhen nga pakujdesia profesionale. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se pakujdesia profesionale nuk ushtron kurrfarë ndikimi në trajtimin penal-juridik të kryesve të këtillë të veprave penale.

¹¹¹ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 113

Përkundrazi, në rastet kur gjykata konstaton se pasoja e shkaktuar është rezultat i pakujdesisë gjatë ushtrimit të profesionit, kjo konsiderohet formë më e rëndë e pakujdesisë dhe kryesit të veprës penale do t'i merret si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit.¹¹²Përgjegjësia-Siç u theksua për veprat penale të kryera me dashje, kryesi çdoherë konsiderohet penalisht përgjegjës dhe dënohet, ndërsa te veprat penale të kryera nga pakujdesia, kryesi nuk dënohet çdoherë, por dënohet vetëm kur për atë vepër penale është paraparë që kryesi dënohet edhe për rastet kur veprën e kryen nga pakujdesia, kështu që në rastet kur është paraparë që kryesi dënohet edhe për veprat e kryera nga pakujdesia, dënimi është i paraparë më i butë se sa dënimi për veprën e kryer me dashje.Se për cilat vepra të kryera nga pakujdesia kryesi do të dënohet, kjo është çështje e politikës kriminale. Mirëpo, lidhur me këtë vendimtare është rëndësia individuale dhe shoqërore e objektit i cili mbrohet edhe me të drejtën penale. Shikuar në përgjithësi, sipas Kodit tonë penal, për pakujdesi dënohen kryesit e veprave penale kundër shëndetit të njeriut, kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë në trafikun publik, mandej për veprat penale nga pakujdesia të personave që ushtrojnë detyra (funksione) të rëndësishme si dhe për veprat penale kundër jetës dhe trupit.

2.13 Cilësimi ligjor figurave të ngjashme të veprave penale

Studimi i figurës së veprës penale, identifikimi, rast pas rasti, i elementëve përbërës të saj, ndihmon juristin për të bërë dallimin e qartë ndërmjet veprave penale. Kësisoj, do të jemi në gjendje të përcaktojmë saktë dispozitën (nenin) konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, metë cilën do të cilësohet (kualifikohet) juridikisht vepra penale dhe, mbi bazën e së cilës, do të akuzohet autori i saj. Në këtë kuptim, nënvizohet se,figura e veprës penale është kusht paraprak përpërgjegjësine penale. Sa më i bazuar të jetë procesi i përcaktimit të figurës së veprës penale, aq më ligjore do të jetë veprimtaria e organeve të proçedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtejshme.

¹¹² I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 113

Ana objektive e figurës së veprës penale, si një ndër katër¹¹³ elementët e domosdoshëmpërbërës të figurës së veprës penale, nga ana e saj, përbën ndihmesë shumë të rëndësishme në këtë drejtim. Përcaktimi i përpiktë i elementëve përbërës të saj, rast pas rasti, është parakusht për zbatimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal. Është parakusht për shmangien e rasteve tëzbatimit të ligjit penal me analogji, e cila, sikurse përcaktohet në nenin 1/c paragrafi II i Kodit Penal, është e ndaluar. Në rastet, kur prania e elementëve të tillë të anës objektive si: pasoja, vendi, koha, mjetet dhe mënyra (megjithëse nuk janë elemente të domosdoshëm për të gjitha figurat e veprës penale), kërkohet shprehimisht në dispozitën përkatëse të Kodit Penal, zbulimi dhe përcaktimime saktësi i tyre, është kusht për cilësimin e drejtë ligjor të veprës penale. Por, çdo të ndodhte në rastet kur një person nuk ndërmerr ndonjë veprim, të cilin ka patur mundësi ta ndërmerte për të penguar ardhjen e pasojës së ndaluar, por sipas ligjit, nuk ka qënë i detyruar që ta ndërmerte këtë veprim. Në këtë rast, personi nuk mund të ketë përgjegjësi penale. Për sjelljen e tij pasive, do të shtrohet çështja e zbatimit të sanksioneve morale. Kemi konstatuar se ka një prirje në rritje të veprave penale të kryera me mosveprim, ekushtëzuar kjo nga vetë zhvillimi shoqëror-ekonomik, varësia e funksionimit të institucioneve të ndryshme etj. Si rrjedhojë, do të rekomandoja me këtë rast parashikimin nga legjislacioni ynë (Kodi Penal), i një numri më të madh të figurave të veprave penale që mund të kryhen me mosveprim. Këto raste, shërbejnë ose si element cilësues të veprës penale, ose për të bërë dallimin ndërmjet figurave të ndryshme të veprave penale, brenda së njëjtes lloji veprave penale, (në shumë raste të tjera, elementë të tillë shërbejnë për gjykatën ose si rrethana lehtësuese ose sirrethana rënduese). Në këto kushte, pasurimi dhe përditësimi i planeve, programeve e teksteve mësimore universitare të fakulteteve të drejtësisë si dhe të Shkollës së Magjistraturës, përbëjnë detyrë të përherëshme të kohës

¹¹³ Në disa botime juridike penale franceze pranohet se tre janë elemente të domosdoshëm të figurës së veprës penale (objekti, ana objektive dhe ana subjektive). Shih për shembull, profesorin e shquar francez të drejtës penale, Ph. Conte

2.13.1 Përgjegjësia dhe ndëshkimi për veprat e kryera me Dashje dhe nga Pakujdesia

Përgjegjësia penale dhe ajo për kundravajtje përjashtojnë njëra tjetrën, nëse një person është dënuar për vepër penale ai nuk mund të dënohet për të njëjtën çështje edhe për kundravajtje, nëse një person është dënuar për kundravajtje e më pas për të njëjtën çështje është inicuar edhe procedurë penale dënimi i shqiptuar në procedurën për kundravajtje i llogaritet edhe në dënimin e shqiptuar në procedurë penale. Mardhënjet në mes të drejtës penale dhe të drejtës administrative shprehen në pjesën e posacme ku është parapar kaptina veprave penale kundër detyrës zyrtare. Kur të se kryesi në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur përgjesi dukshme të zvogluar mund të dënohet më butë. Zvoglimi i përgjegjshmërisë është bazë fakultative për zbutjen e dënimit. Sipas disa ligjeve penale kur gjykata konstaton se ndonjë person veprën penale e ka kryer në gjendje të përgjegjesisë esencialisht të zvogluar, kryesi duhet të dënohet më butë (e ashtuqitura zbutje obligative). Sipas ligjeve tjera kryerja e veprës penale në gjendje të përgjegjesisë esencialisht të zvogluar është bazë sipas të cilës gjykata mundet kryesin ta gjykoj më butë (e ashtëquajtura zbutje fakultative.). KPPK, ka akceptuar variantën e zbutjes alternative të zbutjes së dënimit (Prof. Ismeti në librin e tij mendon se kjo rrethanë e obligon gjykatën që ta zbutë dënimin). Nëse kryesi në momentin e kryerjes së veprës penale ka pasur përgjegjësi esencialisht të zvogluar. (neni 12.par.2.të KPPP).

Nëse gjykata konsideron se aftësia e të pandehurit që të kuptoj rëndësinë e veprës së vet apo t'i kontrolloj veprimet e tia nuk ka qenë e tillë që do të ishte bazë për zbutjen e dënimit, kjo rrethanë merret parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e matje së dënimit. Dënimi si sanksion për pengimin e kriminalitetit dhe sjelljeve të rrezikshme në shoqëri, të cilat rrezikonin intereset e përgjithshme, vlerat e individit dhe të shoqërisë, ekziston që në shoqëritë primitive. Liritë dhe të drejtat e qytetarëve mbrohen me Kushtetutë si akti më i lartë juridik-politik I një vendi dhe me kodin penal pozitiv të vendit. Që të mund të shqiptohet dhe të zbatohet një dënim me gjobë, së pari duhet të ekzistoj vepra penale. Pasi ekziston vepra penale shihet a janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit me gjobë, bëhet matja e tij dhe cili është qëllimi që duhet të arrihet me këtë sanksion të shqiptuar që ekzekutohet.

Dënimi me gjobë bën pjesë në grupin e dënimeve pasurore. Dënimi me gjobë është dënim i cili shqiptohet dhe ekzekutohet më së shpeshti pas dënimit me burgim në praktikën gjyqësore të shteteve të ndryshme të botës. Lidhur me ekzekutimin e tij në praktikën gjyqësore nuk ka probleme të veçanta kur personi i dënuar në mënyrë vullnetare e zbaton këtë dënim, gjegjësisht e paguan gjobën me të cilën është dënuar nga gjykata kompetente.¹¹⁴

Kërkesat e pasurisë sigurohen me këthimin e lëndëve ose me konfiskimin e shfrytëzimit të pasurisë ose dëmshpërblimin e dënimit. Nga njëra anë dënimi me gjobë do të thotë zvoglim i pasurisë së kryerësit, por nga ana tjetër që është e rëndësishme, zvoglimi i këtillë i pasurisë duhet të ketë pasoja më afat gjatë në pakësimin e mundësisë së kryerësit për harxhime dhe për plotësimin e nevojave të tij që kanë ekuivalencë të të hollave.

2.13.2 Vlersimi i gjykatës në dhënjen e dënimit

Në të drejtën penale, masat të cilat zbatohen ndaj kryesve të veprave penale quhen sanksione penale. Marrë në përgjithësi, masat të cilat janë të parapara në të dr. penale dhe ndërmëerren nga jurisprudenca penale ndaj kryesit të veprës penale, duhet të kenë të vetmin qëllim – mbrojtjen e çdo individi dhe të shoqërisë në përgjithësi nga kriminaliteti. Sanksionet penale janë ndër mjetet që i ndërmerrë shoqëria me qëllim të mbrojtjes nga kriminaliteti. Sanksionet penale kanë për qëllim që të sigurojnë kushtet elementare të jetës së përbashkët. në të kundërtën, nëse zbatimi i sanksioneve penale nuk është në funksion të luftimit të kriminalitetit, por i shërben interesave të ngushta burokratike apo partive politike, gjykatat bëhen vegël e tyre.¹¹⁵ Atëherë në fushën e së dr. penale, veçmas në fushën e sanksioneve penale shprehet arbitrariteti, deformimet dhe cenimi i sigurisë dhe i barazisë si dhe shkelja e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Sanksionet që parashihen në të dr. penale janë masa shtrenguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kryesit të veprës penale. Me anë të sanksioneve penale, kryesit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe vlerat tjera shumë të rëndësishme, siç është liria e lëvizjes, pasuria, etj., ndërsa në disa vende ku ende njihet dënimi me vdekje, kryesit i mirret edhe jeta.

¹¹⁴ Halili Ragip. “Penologjia shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale”, Prishtinë, 2005, fq.251

¹¹⁵ Ismet Salihu, E drejta penale, Prishtinë, 2008

Në fushën e së dr. penale në përgjithësi dhe të sanksioneve penale në veçanti, si imperativ imponohen këto parime: respektimi i drejtësisë, të postulateve sociale etike, ligjshmërisë, legjitimitetit, humanizmit, dinjiteti dhe integritetit të njeriut.¹¹⁶ Një vendim gjyqësor i formës së prerë mbetet abstrakt nëse nuk konkretizohet në jetë me përmbushjen e detyrimit nga i dënuari, për këtë arsye etapa e fundit e një procesi gjyqësor, ekzekutimi i vendimit penal bëhet akoma më i rëndësishëm. Sipas raportit të veçantë të Avokatit të Popullit “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë” të vitit 2012: “Numri i ankesave të qytetarëve drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit për të ndërhyrë pranë autoriteteve përgjegjëse për të realizuar të drejtën e tyre të fituar gjyqësisht, vazhdon të rritet. Bashkë me numrin e ankesave për këtë objekt, rritet dhe fatura financiare e shtetit për detyrimet që ky i fundit (në rastet kur është debitor) i ka individëve gjyqfitues.”¹¹⁷

Në kuptim të nenit 6 të KPK-së, “vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj ...”. Nga kjo rezulton se të përcaktosh veprën penale me ligj, do të thotë të përcaktosh në mënyrë abstrakte dhe precize të gjitha tiparet e figurës së veprës penale. Nga kjo rezulton se të përcaktosh sanksionin penal ose masën e trajtimit të detyrueshëm me ligj do të thotë të përcaktosh në mënyrë abstrakte llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ose llojin e masës së trajtimit të detyrueshëm dhe kohëzgjatjen e tyre, ashtu që të njëjtat, poqë se nuk janë të përcaktuara me ligj, para se të jetë kryer vepra penale, nuk do të mund t’i shqiptohen askujt. Ky element i parimit të ligjshmërisë është garanci për zbatimin e tij në të drejtën penale, me rastin e shqiptimit të sanksionit penal dhe masës së trajtimit të detyrueshëm kundër kryerësit të veprës penale.

¹¹⁶ Ismet Salihu, E drejta penale, Prishtinë, 2008

¹¹⁷ Avokati i Popullit (2012) “Raport i Veçantë për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë”, faqja 2, http://ëëë.parlament.al/ëeb/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf.

PJESA E TRETË

KAPITULLI I TRETË

3. Metodologjia

Gjatë hartimit të punimit kam përdorur metodat shkencore bashkëkohore. Si të tilla kam përfshirë **metodën e analizës dhe sintezës** si dy metodat universale të njohjes. Analiza përfaqëson në punim ndarjen e objektit që studiohet në pjesën e tij përbërëse. Ndërkohë, sinteza përfaqëson një bashkim përmbledhës të elementëve të objektit të studimit. Analiza dhe sinteza në punim janë në unitet me njëra tjetrën.

Metoda historike dhe metoda logjike, të ndjekura gjatë punimit, janë gjithashtu metoda mjaft të rëndësishme. Metoda historike, është një metodë sipas së cilës institutet juridike penale studiohen në zhvillimin e tyre historik, (nga e shkuara në të tashmen). Ndryshe nga metoda historike, metoda logjike dikton që këta institute të shpjegohen jo nga historia e tyre por nga ligjet e zhvillimit. Së fundi, punimi im bazohet edhe mbi **metodën krahasuese dhe metodën normative**. Metoda krahasuese nënkupton konstatimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis dukurive të jetës shoqërore dhe instituteve të së drejtës penale. Me anë të metodës krahasuese dalin në pah të rejtat dhe përparësitë e objektit të studimit. Vetëm pas një metode krahasuese, mund të nxjerrim përfundime të sakta dhe të bazuara në argumenta bindës, po ashtu, edhe problematika në lidhje me objektin e studimit.

Të gjitha këto çështje do të kenë karakter kërkimor, individual dhe kolektiv përmes kërkimeve fundamentale, aplikative dhe zhvillimore, duke paraqitur një kërkim bazik, të pastër, teorik dhe praktik me qëllim të arritjes së njohurive të reja për faktet bazike të cilat do të mundësojnë kuptimin dhe dallimin midis veprave penale të cilat mund të shkaktohen nga forma të ndryshme të veprimit apo mosveprimit të subjekteve të së drejtës që si faktor kryesor e parashohin institutin e fajit. Përmes aplikimeve të këtyre metodave do të arrihet që të elaborohet praktikat dhe dukuritë negative, si dhe të zbardhen lidhjet dhe lidhshmëritë e shkak-pasojave në legjislacion, në shoqëri dhe në vedëdijen njerzore. Po ashtu literatura e përdorur është e gjërë dhe e shumëllojshme. Burimet e shfrytëzuara janë legjislacioni penal, artikuj shkencor, komentare të jurisprudencës, të brëndëshëm dhe të huaj, legjislacioni i shteteve të huaja, etj.

3.1 Vëllimi i veprave penale të kryera nga faji – me dashje dhe nga pakujdesia në Gjykatën penale të Komunës së Gostivarit në periudhën kohore 2011-2015 dhe politika ndëshkuese e Gjykatës

Lëndët e plotëfuqishmë të veprave penale të kryera nga faj me dashje dhe nga pakujdesia në Gjykatën penale të Komunës së Gostivarit.


Viti	Numri i veprave penale nga faji me dashje
2011	41
2012	32
2013	31
2014	30
2015	39
Viti	Numri i veprave penale nga pakujdesia
2011	68
2012	48
2013	29
2014	53
2015	56

Tabela nr.1

Sipas kësaj mund të deklarojmë se numri i veprave penale nga faji me dashje gjatë periudhës 2011-2015 është 173, kurse numri i veprave penale nga faji pakujdesia është 254. Dmth më së shumti vepra penale faj- nga pakujdesia në Komunën e Gostivarit janë paraqitur gjatë kësaj periudhe. Stacioni policor KP gjatë vitit 2011-2015 ndërmori masa permanente dhe aktivitete në kuadër të autorizimeve ligjore me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të të gjitha formave të kriminalitetit dhe veprimeve të tjera kundërligjore.

Viti raportues 2011-2015 u karakterizua me numër të madh të ngjarjeve dhe gjendjeve të cilat kërkonin angazhim maksimal të përbërjes së përgjithshme të SP Gostivar dhe HK za KP. Gjatë vitit u ndërmorën masa preventive dhe aktivitete me qëllim të sigurimit të gjendjes stabile të sigurisë pa prishje më serioze të RQP si dhe forma më të rënda të veprave penale. Në gjysmëvjetorin e parë vitit 2011-2015 u ndërmorën masa shtesë dhe aktivitete rreth zhvillimit të papenguar të procesit zgjedhor *Zgjedhje presidenciale* *Zgjedhje të parakohshme parlamentare 2011-2015 *. Me këtë rast Shërbimi maksimalisht u angazhua me të vetmin qëllim zvogëlimin e incidenteve të mundshme dhe prishjes së RQP si dhe parandalim të kryerjes së formave më të rënda të veprave penale. Me këtë rast procesi i gjithmbarshëm zgjedhor kaloi në atmosferë korrekte dhe demokratike pa shkelje dhe incidente më serioze. Gjendja në sferën e rendit dhe qetësisë publike gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit 2014 është në nivel të kënaqshëm për shkak të numrit të zvogëluar të kundërvajtjeve, dhe nuk janë regjistruar prishje të RQP të përmasave më të mëdha. Nga ana tjetër shërbimi në kontinuitet ndërmori masa dhe aktivitete preventive me vendosje dhe mbulim në kohë të punkteve dhe zhizhave në të shumtën e rasteve është prishur rendi dhe qetësia publike dhe vende kriminogjene. Po ashtu Departamenti për preventive pranë policisë realizoi një pjesë të aktiviteteve të planifikuara në përputhje me përcaktimet programore. Stacioni policor Gostivar gjatë vitit 2014 në përputhje me autorizimet ligjore ndërmori masa dhe aktivitete në kontinuitet me qëllim të gjendjes së sigurisë në rajon, në kontekst të kësaj janë ndërmarrë masa për forcimin e besimit ndëretnik, rritjen e transparencës së policisë dhe afrimin e policit me qytetarët. Edhe krahas numrit të madh të ngjarjeve dhe gjendjeve të cilat e shënuan vitin 2014 nëpërmjet të angazhimit maksimal të përbërjes së gjithmbarshme të policisë me departamentet policore, departamenti policor për STRr dhe Zyrën e jashtme për çështje kriminale, shërbimi ka funksionuar pa pengesa duke realizuar detyrat e përcaktuara pa pasoja serioze mbi sigurinë dhe jetën e zyrtarëve të policisë. Në këtë mënyrë me ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve preventive si dhe represive ndaj kryerësve të veprave penale dhe kundërvajtjeve siguroi gjendje të sigurt me çka u mundësua mbrojtja e jetës, sigurisë personale dhe pronës së qytetarëve, pengimi i kryerjes së veprave të dënueshme, zbulim, gjetje dhe kapje e kryerësve të veprave të dënueshme dhe dorëzimi i tyre organeve kompetente, mbrojtje e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike, rregullimi dhe kontrolli i trafikut rrugor dhe punë të tjera që lidhen me sigurinë në trafikun rrugor, si dhe çështje nga sfera

e statusit qytetar. Vepra penale të regjistruara-numri i përgjithshëm i veprave penale të regjistruara, kryerës të paraqitur Gjatë vitit 2015 kriminaliteti në zonën e Stacionit Policor të Gostivarit shënon rritje për 12,74% (në vitin e kaluar 2014 po ashtu rritje për 2,27% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak 2014).



Grafikoni nr.1

Në këtë periudhë funksioni zbulues i krimeve të kryera në nivel të SP të Gostivarit ka arritur një përqindje të përgjithshme të realizimit me efikasitetit 32,7% (36,9%). Në efikasitetin e përgjithshëm shënojmë ulje për 4,2% (0,9%). Ky efikasitet i arritur para së gjithash është rezultat i numrit të rritur të krimeve të kryera nga autori i panjohur që në vitin aktual nuk janë realizuar por megjithatë kemi një nivel të kënaqshëm, duke pasur parasysh arsyet objektive që kanë të bëjnë me përfshirjen e pjesëtarëve të krim-policisë dhe policisë në ruajtjen e situatës së sigurisë, problemet hapësinore dhe mungesën e pajisjeve teknike që rezultojnë me pamundësinë për të siguruar dëshmi të forta materiale për procedimin e ngjarjeve.

Sipas Buletinit zyrtar të Komunës së Gostivarit,¹¹⁸ Stacioni policor Gostivar ON gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 ndërmoi masa të vazhdueshme dhe aktivitete në suaza të autorizimeve ligjore me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të kriminalitetit dhe veprimeve tjera antiligjore. Gjatë gjysmës së parë janë ndërmarrë masa preventive dheaktivitete me qëllim që të garantohet gjendja e sigurisë pa ndonjë prishje serioze të RQP si dhe formave të rënda të veprave penale.Në gjysmën e parë të vitit 2014 janë ndërmarrë masa shtesë dhe aktivitete rreth prishjes së pandërprerë të procesit zgjedhor *Zgjedhjet presidenciale* dy rrethet të “Zgjedhjeve parlamentare”. Gjatë kësaj, Shërbimi ishte i angazhuar në maksimum me qëllim zvogëlimin e incidenteve të mundshme dhe prishjen e RQP si dhe parandalimin e kryerjes së formave më të rënda të veprave penale. Kështu që i gjithë procesi zgjedhor rrodhi në atmosferë korrekte dhe demokratike pa ndonjë çrregullim më serioz dhe incidente.Situata në fushën e qetësisë dhe rendit publik gjatë gjysmës së parë të viti 2014 është në nivel të kënaqshëm për shkak të numrit të zvogëluar të kundërvajtjeve dhe nuk janë regjistruar prishje të RQP me përmasa të mëdha. Nga ana e shërbimit në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë masa preventive dhe aktivitete me vendosje në kohë dhe mbulim të punkteve dhe zhizhave ku në numër të madh të rasteve është prishur rendi dhe qetësia publike dhe në vende kriminogjene. Gjithashtu nëpërmjet Departamentit për prevencion policia realizoi pjesë të aktiviteteve të planifikuara në pajtim më përcaktimet programore. Në gjysmën e parë të vitit 2014 japim vlerësime se aktiviteti operativ i shprehur në përqindje është 58%(47%) dhe shënon rritje të pakonsiderueshme për 11% në aspekt të feltëparaqitjeve penale të parashtruara për veprat penale të realizuara në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2013, sepse në këtë gjysëmvjetor janë parashtruar gjithsej 126(82) fletparaqitje penale, respektivisht 44 më shumë se në periudhën e njëjtë në vitin 2013, për gjithsej 184(105) vepra penale të realizuara, respektivisht 64 (29) vepra të zbardhura nga ato të regjistruara me autorë të panjohur në vitin 2014, 17 (8)vepra të zbardhura të regjistruara si vepra të kryera nga autori i panjohur në vitin 2013 dhe 103 (68) vepra të regjistruara në vitin 2014 të njëjtat të kryera nga autorë të panjohur.Në gjysmën e parë të vitit 2014 kriminaliteti në territorin e Stacionin Policor Gostivar shënon rritje të pakonsiderueshme për 38% në krahasim me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar 2013 (vitin e kaluar 2013 në periudhën e njëjtë shënohet ulje prej 9% në krahasim me vitin 2012).

¹¹⁸ http://ëëë.gostivari.gov.mk/ëëb/images/stories/PDF/Buletin/bz07-14_sg07-14.pdf

Kjo ka të bëjë me numrin e rritur të veprave penale të denoncuarra dhe të regjistruara për 158 më shumë krahasuar me gjysmëvjetorin e parë të vitit 2013 (në gjysëm vjetorin e paraë 2013 për 41 më pak se në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012). Në periudhën e lartpërmendur janë kryer gjithsej 568 (410) vepra penale, 465 (342) janë kryer nga kryerës të panjohur, nga të cilët 64(29) janë zbardhur, ndërsa 103(68) janë kryer nga kryerës të njohur për të cilët janë parashtruar gjithsej 117(75) kallëzime penale kundër 153(94) kryerësve nga të cilët 43 (33) përsëritës dhe 5(9) minorenë. Përqindja e efikasitetit në zbardhjen e veprave penale të kryera nga ana e kryerësve të pajnohur është 13,7% (8,48), që don të thotë funksionim i zbulimit në zbardhjen e veprave penale të kryera nga ana e kryerësit të panjohur shënon rritje për 5,22% në raport me periudhën e njëjtë të viti 2013 (viti e kaluar për të njëjtën periudhë krahasuar me vitin 2012 shënohet ulje për 8,68%). Shënojmë ulje të efikasitetit në zbardhjen e veprave penale të kryera nga ana e autorit të panjohur për 1,39% në krahasimin e kryer të tremujorit të parë të vitit 2014 (14,39%) me tremujorin e dytë të vitit 2014 (13%). Nga gjithsej 586 (401) veprat penale të kryera, 167(97) vepra penale janë zbardhur ose janë kryer nga kryerës të njohur që paraqet efikasitet të përgjithshëm prej 29% (23%). Në efikasitetin e përgjithshëm vërejmë rritje prej 6% (në gjysmëvjetorin e parë të vitit të kaluar krahasuar me vitin 2012 shënonim ulje për 4%) në raport me periudhën e njëjtë të vitit raportues 2013, e që ka të bëjë me numrin e rritur të veprave të zbardhura penale për 35 më shumë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe numrin e rritur të denoncimeve të realizuara të veprave penale të kryera nga ana e autorit të njohur për 35 më shumë për periudhën e njëjtë të vitit kaluar. SP Gostivar korrespondon edhe me 401(312) kallëzime penale kundër kryerësve të panjohur në gjithsej 401(313) veprat të kryera dhe të regjistruara, por ende jo të zbardhura nga të cilat 399 nga lëmi i krimit klasik 1 nga fusha e tregtisë së palejuar me droga dhe 1 nga fusha e krimi të ekonomik.

3.2 Casy Study - Intervistë e realizuar me Prokurorin Publik në Komunë e Gostivarit

Pyetja nr.1 A jeni të mendimit se - Sa më i bazuar të jetë procesi i përcaktimit të Fajit në veprën penale , aq më ligjore do të jetë veprimtaria e procedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtutjeshme. Përcaktimi i përpiktë i institutit të fajit dhe formave në të cilat ai manifestohet është parakusht për zbatimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal.

Sipas mendimit tim : Ligji për procedurë penale përmban dispozita që për herë të parë nëlegjislacionin penal-procedural maqedonas e rregullojnë mundësinë përmarrëveshje në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit për llojin dhelartësinë e sanksionimit penal, parashohin status tjetër të deklaratës përpranim të fajit në fazën e kontrollit të akuzës dhe të pranimit të krimit të dhënëgjatë shqyrtimit kryesor të procedurës së rregullt, si dhe gjatë shqyrtimit nëprocedurën e shkurtuar, për dallim nga ajo që e kemi pasur deri tani sa i përketpranimit të krimit që i akuzuari mund ta jepte para gjyqit. Në LPP është propozuar procedurë për sjellje të aktgjykimit në bazë tëmarrëveshjes për pranim të fajit në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit,dhe për herë të parë mundësohet marrëveshja midis palëve me qëllim që tëarrihet zgjidhje e pranueshme nga të gjitha palët. ga prokurori publik pritet veprim aktiv në kuptim të inicimit të procedurës përmarrëveshje për pranim të fajit dhe angazhimit për të arritur deri te njësanksion penal që është i pranueshëm nga të dyja palët për veprën apo përveprat për të cilat ai ka sjellë urdhër për fillim të procedurës hetimore. Prokuroripublik duhet që fillimisht ta vlerësojë vlerën e dëshmime të mbledhura me të cilatdisponon në rastin konkret dhe në bazë të tyre të sjellë vendim se vallë duhettë iniciojë marrëveshje për pranim të fajit, apo do të shfrytëzojë ndonjëmundësi tjetër procedurale që ia ofron LPP-ja, si për shembull, shtyrje tëkushtëzuar të ndjekjes penale apo do të zhvillohet procedura e rregullt penale.Në kuadër të autorizimeve të prokurorit publik sipas LPP-së, në mes tjerash,është paraparë edhe detyrimi që ai të negociojë dhe të merret vesh me tëakuzuarin për pranim të fajit, në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me LPP. I akuzuariështë njëra nga palët që merr pjesë në procedurën e marrëveshjes përpranim të fajit, e i njëjti mund të paraqitet në rolin e iniciatorit për fillim të pro -cedurës për marrëveshje për pranim të fajit.

Sipas LPP-së, i akuzuari ka të drejtë që ta paraqesë lirshëm mbrojtjen e tij, të mos jetë i detyruar të japë deklaratë kundërvetes, të afërmeve të tij apo ta pranojë fajin, si dhe të ketë mundësi të deklarohepër faktet dhe dëshmitë të cilat e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhedëshmitë që janë në favor të tij. *Sipas kësaj mund ta vërtetojmë hipotezën e parë të këtij punimi : Sa më i bazuar të jetë procesi i përcaktimit të Fajit në veprën penale , aq më ligjore do të jetë veprimtaria e procedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtutjeshme. Përcaktimi i përpiktë i institutit të fajit dhe formave në të cilat ai manifestohet është parakusht për zbatimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal.*

Pyetja nr.2 A jeni të mendimit se Struktura e Fajit përfshin: përgjegjsi, dashje dhe pakujdesi dhe vetëdije ose detyrim dhe mundësi për vetëdije për ndalueshmërinë e veprës penale, dmth. , nevojitet vetëdije aktuale apo potenciale për ndalueshmërinë e veprës, kurse detyrimi dhe mundësia për vetëdije për ndalueshmërinë janë të mjaftueshme jo vetëm te pakujdesia por edhe te dashja.

Vepra penale është vepër e rrezikshme shoqërore, që rendi juridik e ndalon me kërcënim të aplikimit të sanksioneve penale. Ajo është rezultat i sjelljes të njeriut, kështu që mund të caktohet si sjellje e njeriut me të cilën shkelen dispozitat juridike dhe shkaktohen pasoja të dëmshme për shoqërinë, për çka edhe reagohe me aplikimin e sanksioneve penale. Si sjellje e njeriut, si akt i njeriut të caktuar, kjo bartë karakteristika të vetë personalitetit: kushteve të tij të jetës, konfliktit me vetvete , konfliktit me individë të tjerë, grupet shoqërore dhe shoqërinë në tërësi. Nocioni material i veprës penale është i lidhur me shkollën italiane pozitive, e cila më shumë i ka kushtuar kujdes përmbajtjes së problemit se sa formës. Sipas Garofalit, vepra penale është ajo vepër me të cilin ofendohen ndjenjat altruiste dhe morale të njerëzve, që janë pranuar nga pjesa civilizuese e njerëzimit. Feri e definon veprën penale si veprim që rrjedhë nga motivet egoiste dhe asociale, me të cilën ofendohen kushtet e jetës dhe morali i një populli në një fazë të zhvillimit. Në të vërtetë, shkolla pozitive e ka quajtur veprën penale si vepër të rrezikshme shoqërore të cilën duhet penguar me aplikimin e masave shoqërore mbrojtëse.

Në teori, ky nocion i veprës penale është i njohur me titullin “ nocioni sociologjik i veprës penale” Përgjegjësia penale e personave juridikë është normuar në legjislacionet e shumicës së vendeve, por vazhdon të jetë një ndër temat me të debatueshme në kuadër të sistemeve juridike, me tendencë të harmonizimit me parimet e së drejtës penale. Një nga aspektet themelore që kërkon sqarim nga ana teorike dhe praktike mbetet vetë konceptimi i fajësisë së personave juridikë. Për një definim të saktë të kësaj problematike si zgjidhje është konceptimi normativ i fajësisë së personit juridik, për dallim nga konceptimi psikologjik apo psikologjik-normativ i fajësisë për personin fizik. I takon prokurorisë dhe gjykatës që përgjegjësinë penale të personave juridikë ta provoj në mënyrë paralele me përgjegjësinë e personit fizik, si një përgjegjësi autonome edhe pse derivon nga vepra penale e kryer nga personi fizik (përgjegjës). Kjo nënkupton se fajësia e personit juridik bazohet në sjelljen e tij, politikën afariste që ka zbatuar, dhe masat që ka ndërmarrë me qëllim të parandalimit të veprave penale. Me qëllim të krijimit të një baze juridike me të qartë mbi përgjegjësinë e personave juridikë në Maqedoni është e nevojshme që me ligj të përcaktohet detyrimi i personave juridikë që të miratojnë modele organizimi dhe kontrolli efikas (compliance program) dhe kjo të jetë baza e provimit të fajësisë apo pafajësisë së tyre. *Sipas kësaj mund ta vërtetojmë hipotezën e dytë të këtij punimi Struktura e Fajit përfshin: përgjegjsi, dashje dhe pakujdesi dhe vetëdije ose detyrim dhe mundësi për vetëdije për ndalueshmërinë e veprës penale, dmth. , nevojitet vetëdije aktuale apo potenciale për ndalueshmërinë e veprës, kurse detyrimi dhe mundësia për vetëdije për ndalueshmërinë janë të mjaftueshme jo vetëm te pakujdesia por edhe te dashja.*

Pyetja nr.3 A jeni të mendimit se: Për çdo vepër të shkaktuar me faj nga autori i veprës parashihet kufizimi dhe vendosja në korniza të caktuara e drejta e shtetit për të ndëshkuar.

Për çdo vepër të shkaktuar me faj nga autori i veprës parashihet kufizimi dhe vendosja në korniza të caktuara e drejta e shtetit për të ndëshkuar I Paditur në procedurë penale është personi i cili ngarkohet për veprën penale të kryer për të cilën kundër tij udhëhiqet procedurë penale. Ai është personi kundër të cilit udhëhiqet procedura, edhe pse për të në stadi të ndryshme në procedurë ka edhe përcaktime më të përafërta (p.sh., arrest, i akuzuar, i gjykuar, i dënuar). Pozita e të akuzuarit në procedurën penale është shumë komplekse. I akuzuari para së

gjithash është subjekt i procedurës penale. Në vlersimin e saj gjykata është e detyruar të bëjë një vlersim pozitiv të të gjithë Rasteve që kanë çuar në shkaktimin e pasojave të parashikuara nga dispozita ligjore. Kjo do të thotë se ai si subjekt është bartës i autorizimeve të caktuara në procedurë, të cilin subjektet tjera duhet ta respektojnë dhe në këtë kuptim gëzon mbrojtje ligjore. Duke u nisur nga pikëpamjet në shoqëri për njeriut dhe pozitën e tij në të, me vetë atë që të akuzuarit i vendoset në ngarkesë kryerjen e ndonjë veprë penale, e cila është veprë e rrezikshme, atij si i akuzuar nuk i mohohet cilësia e njeriut, nuk i mohohet personaliteti i tij dhe dinjiteti njerëzor, nuk i mohohet pozita e subjektit në procedurë dhe e drejta të mbrohet dhe të provojë pafajësinë e vet të cilat janë në dobi të tij. Po ashtu mund të themi se gjatë përgjigjes së kësaj pyetje, kemi edhe aprovimin e hipotezës së përgjithshme.

Pyetja nr.4 A jeni të mendimit se: Gjukata duhet të ndihmohen nga mendimi i ekspertëve në dhënien e përcaktimeve dhe shkaqeve që kanë çuar në realizimin e veprës penale, por gjithashtu vet gjykatësi duhet të ketë një vëmendje shumë më të koncentruar ndaj gjithë autorëve nëse ata paraqiten si pjesmarrës në kryerjen e veprës penale që ka prodhuar manifestimin e përgjegjësisë penale.

Mendoj që Gjukata do të mbajë seancë mbi kërkesën pronësore-juridike, vetëm nëse me atë nuk zgjatet procedura, mund edhe të miratojë nëse i akuzuari është shpallur fajtor. Gjukata asnjëherë nuk e refuzon propozimin e parashtruesit. Nëse angazhohet në seancë dhe nëse vlerëson se kërkesa nuk mund të pranohet, bartësi i kërkesës pronësore juridike do të udhëzohet në proces të rregullt civil. Gjukata mund dhe nuk është patjetër ta miratojë lutjen për kthim në gjendjen e mëparshme. Kundër vendimit për kthim në gjendjen e mëparshme nuk mund të paraqitet ankesë. Prandaj, ekzis-ton mundësi në një rast të tillë, vendimi me të cilin nuk është lejuar ankesë për kthimin në gjendjen e mëparshme të mund të sulmohet bashkë me ankesën kundër aktgjykimit drejtuar gjykatës së shkallës së dytë, gjykatës më të lartë, kompetent për të vendosur në shkallë të dytë sipas ankesës, i cili në atë rast së pari, duhet të vendosë për kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe nëse gjen se lëshimi është i ar-syeshëm, do të angazhohet edhe në shqyrtimin e ankesës së paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Po ashtu mund të themi se gjykata duhet të ndihmohet edhe nga ana e ekspertëve për dhënien e përcaktimeve dhe shkaqeve të cilat lanë dërguar në realizimin e veprës penale, poashtu edhe vet gjykatësi duhet të jetë i koncentruar në atë se çka përzgjedh për zgjidhje. Gjukata në dhënien e dënimit

duhet të ketë parasysh të gjithë elementët e sjelljes së autorit të veprës penale si dhe të rrezikshmërisë shoqërore. Gjykata duhet të jetë në gjendje të identifikoj dhe jap dënimin më të përshtatshëm për rastin konkret të paraqitur dhe të krijuar sipas fajta dhe formave të tij.

Pyetja nr.5 A jeni të mendimit se: Në legjislacionin penal, llojet e posaçme të dashjes janë të rëndësishme për praktikën gjyqësore, për njohjen më të mire të dashjes dhe mund të merren si rrethanë rënduese apo lehtësuese me raste të matjes së dënimit.

Mendoj që Dashja është përfytyrimi i të gjithë elementëve të faktit të kundërligjshëm, si rrjedhojë duhet të përfytyrohen dhe të duhenveprimi ose mosveprimi, lidhja shkakësore, pasojat dhe të gjithë elementët e faktit tipik. Për shëmbull një gjuetar i cili mendon sepas një shkurre është një derr, edhe pse në fakt është një gjyetar tjetër, dhe qëllon duke shkaktuar vdekjen e këtij të fundit, dashja e veprës penale të vrasjes nuk mund të afirmohet, gjuetari kishtëpërfytyruar dhe dashur një fakt tjetër nga ai i realizuar siç është vrasja e derrit dhe jo e kolegut të tij. Dashja e menjëherëshme ose e paramenduar (dolus repentinus) me të cilën kuptohet raste kur mendimi përkryerjen e veprës vijnë aty për aty dhe personi vepron menjëherë përrealizimin e saj, për shëmbull, vrasja e ndodhur në grindje e sipër. Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, eparashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mëndjelehtësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk iprashikon, megjithëse sipas rrethanave duhet dhe kishte mundësi ti parashikonte. Pakujdesia sidhe dashja përbëhet nga dy pjesë që i dallon qëndrimi i ndryshëm psikik i personit ndaj veprimtose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm. Vetbesimi i tepruar ekziston vetëm atëhere kur personi e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, nuk i dëshiron ato por me mëndjelehtësi mendon se do t'i shmangë. Dallimi kryesor ndërmjet pakujdesisë me vetbesimin e tepruar dhe dashjes indirekte është mënyra e të menduarit rreth pasojave të mundshme të cilat mund t'i parandalojë ato. Shkalla dhe karakteri i parashikimit të pasojave në pakujdesi me vetbesim të tepruar nuk janë as të barabarta dhe as të njëjta me ato të dashjes indirekte. Dallim tjetër përbën edhe shkalla e dëshirës lidhur me mosardhjen e pasojës. Pakujdesia në formën e vetbesimit të tepruar është karakteristikë e veprave penale të shkeljeve të rregullave të mbrojtjes në punë, të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj

PJESA E KATËRT

KAPITULLI I KATËRT

4.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Rëndësia dhe arsyet e hulumtimit të këtij punimi janë të shumta por njëra ndër më të rëndësishmet është ajo, se ky punim do të jetë një lloj ndihmese për të kuptuar në mënyrë të detajuar institutin e Fajit, format e manifestimit të tij dhe rëndësinë e këtyre formave në jurisprudencën penale. Pra, realizimit të këtij punimi do t'i shërbej hartimi i një strukture funksionale të brendshme të të gjitha strukturave shtetërore në veçanti Prokurorisë shtetërore dhe Gjyqsisë lidhur me identifikimin rast pas rasti të elementeve përbërës të veprës penale kryesht Fajit me qëllim ndihmese për të bërë dallimin e qartë ndërmjet veprave penale dhe mbi bazën e të cilave do të akuzohet autori i saj. Sa më I bazuar do të jetë procesi gjyqsor I përcaktimit të fajit, aq më ligjore do të jetë veprimtaria e organeve të procedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtejshme. Pra, punimi në fakt në mënyrë modeste do të ketë impakt në modernizimin e legjislacionit tonë penal, posaçërisht në pjesën e anës subjektive të figurës së veprës penale, por edhe të procedurës penale. Në këtë pjesë, Kodi ynë Penal, ka nevojë për reformim, sipas parimeve të përgjithëshme juridike-penale, për tu përsosur dhe për tu afruar më shumë me qëndrimet bashkëkohore të së Drejtës Penale si dhe me praktikën europiane përkatëse. Kështu Kodi ynë Penal ka nevojë të plotësohet me dispozita sqaruese, ndërsa ai procedural me reformën e Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Së fundi , ky hulumtim do të gjallëronte më shumë jetën juridike penale në vëndin tone pasiqë, zgjerimi i botimeve në këtë fushë, do të perbënin kontribut të çmuar në përpunimin e mendimit shkencor juridik penal dhe forcimin e formimit shkencor profesional të studentëve të drejtësisë të universiteteve në vëndin tonë. Punimi i kësaj teze ndoshta do të jetë sadopak i ndikueshëm edhe tek ligjvënësi për të pasuruar dispozitat në legjislacionin penal që kanë të bëjnë me kualifikimin e veprave penale në procedurat gjyqsore si dhe plotësimin e zbrastirave juridike që mund të hasen në legjislacionin vendas. Me rastin e hulumtimit dhe të vërtetimit të hipotezave të lartpërendura dhe pas arritjes dhe realizimit të qëllimeve të parapara në këtë punim do të rezultojnë disa përfundime dhe rekomandime që do të nxirren nga ky hulumtim, të cilat do ti paraqes në tezën time të magistraturës. ër dënimin e kryerit të veprës penale nuk mjafton sjellja e kryerësit të përgjigjet me përshkrimin ligjor të veprës penale dhe të jetë kundërligjore dhe e rrezikshme, nëse për sjelljen nuk ka faj (fajësi).

Faji ose fajësia ekziston për atë sjellje për të cilën kryerësi mund të qortohet se nuk është sjellë sipas kërkesave të bashkësisë shtetërore. Qortohet vetëm ai kryerës i cili është në mundësi dhe është i aftë të sillet si duhet, i cili e di se çfarë mund të bëjë dhe çfarë nuk mund të bëjë, kurse ai edhe përkundër kësaj ka vendosur për sjelljen e cila është e ndaluar dhe e dënueshme. Faji ose fajësia është përmbledhje e supozimeve sipas të cilave një vepër e kundërligjshme mund t'i atribuohet kryerësit. Ajo është e lidhur me vetëdijen e kryerësit, respektivisht për sjelljen e tij dhe qën-drimin e tij kundrejt asaj veprë. Në kuptimin e gjerë faji ose fajësia i përfshinë aftësinë e kryerësit të gjykojë dhe nxjerr përfundime si duhet (përgjegjësi) dhe marrëdhënia e tij psikologjike me veprën (paramendim dhe neglizhencë). Fajtor ose i fajshëm është kryerësi i cili është i përgjegjshëm, nëse veprën e ka kryer me paramendim ose prej neglizhencës (pakujdesi), kurse ai ka qenë i vetëdijshëm ose mund të ketë qenë i vetëdijshëm se vepra e tij është kundërligjore. Fajësia është qortim për veprën e kryer e cila është e ndaluar. Ajo nuk është ndonjë qëndrim ose botëkuptim për diçka e cila nuk manifestohet në veprën e cila është e ndaluar. Askush nuk mund të ketë përgjegjës për disa veti të karakterit dhe cilësi të personalitetit të tij, por për veprën e cila është e ndaluar. Përgjegjshmëria është cilësi e njeriut të shëndosh mendor, të mendojë dhe vendos në mënyrë të duhur. Ajo, veç kësaj, njohja e duhur e dispozitave juridike dhe mundësia për sjellje në paj-time ato dispozita, respektivisht rregulla. Në përgjegjshmëri bëjnë pjesë këto aftësi: aftësia të kuptojë domethënien e veprës dhe aftësia për menaxhimin me veprimet e veta. Aftësia për të kuptuar domethënien e veprës, d.m.th. të kuptohet si ngjarje, qoftë me ose pa pasoja, nga pikëpamja e qëndrimit të shoqërisë dhe qëndrimit të tij për atë vepër. Aftësia për menaxhim me veprimet e veta d.m.th. aftësia për vendosmëri, pasi do të kuptojë domethënien e veprës. Ajo, veç kësaj d.m.th. edhe aftësi për gjykim. Për çdo njeri si qenie e vetëdi-jshme, me përgjegjësi dhe të lirë supozohet është i përgjegjshëm. Sepse përgjegjshmëria nënkuptohet, në kodin penal tonin nuk është thënë çfarë është përgjegjshmëri, por çfarë është papërgjegjshmëri. I papërgjegjshëm është ai njeri, kryerës i veprës i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mundur të kuptojë veprën e tij ose nuk ka mundur të menaxhojë me veprimet e veta dhe ajo papërgjegjësi ka shkaktuar sëmundje mendor të përhershme ose të përkohshme, çrregullim i përkohshëm ose zhvil-lim të prapambetur mendor. Vlerësimi për përgjegjshmërinë e kryerësit ka të bëjë vetëm për ve-prën konkrete dhe jo në përgjithësi. Papërgjegjshmërinë sa i përket veprës penale të kryer e përcakton gjykata – në bazë të eksper-tizës psikiatrike.

Papërgjegjshmëria e përjashton përgjegjësinë penale, ashtu që kryeri me papërgjegjshmëri nuk mund të dënohet. Për përgjegjësi penale dhe për shqiptimin e dënimit penal nuk mjafton kryeri në kohën e kryerjes së veprës penale të jetë i përgjegjshëm, por edhe të jetë i fajshëm. Përgjegjshmëria është vetëm supozim për faj, respektivisht fajësi. Ndërsa tek përgjegjshmëria analizohet gjendja psikologjike e kryerësit në kohën e kryerjes së veprës penale, tek faji analizohet (me prezumim se ai psikologjikisht është i shëndosh) si është raporti i tij psikologjik me veprën. Ekzistojnë këto shkallë ose forma të fajit: 1) paramendim si formë më e fajit dhe 2) pakujdesi si formë më e lehtë e fajit. Paramendimi është kundërshtim i vetëdijshëm i të drejtës (rendit juridik), kurse pakujdesia është sjellje e padëshiruar e pakujdesshme, në një farë kuptimi mendjehetësi. Për çdo vepër penale të kryer me paramendim është paraparë dënim, kurse për veprën e kryer prej pakujdesisë vetëm nëse ajo me ligj është paraparë. Vepra penale e kryer me paramendim kur kryerësi është i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e dëshiron kryerjen e saj (paramendim direkt) ose kur është i vetëdijshëm se për shkak të veprimit ose mosveprimit të tij mund të paraqitet pasoja e ndaluar, kurse ai edhe përkundër kësaj pajtohet të paraqitet pasoja (paramendim eventual). Paramendimi, sipas kësaj, mund të shprehet si paramendim direkt ose eventual. Tek paramendimi direkt kryerësi me vetëdije dhe me dëshirë shkon në atë ta kryejë vepër penale, kurse tek paramendimi eventual kryerësi është i vetëdijshëm se ka rrezik të madh prej kryerjes së vepër penale, si edhe për mundësinë prej paraqitjes së pasojave të ndaluara, por ajo vetëdije nuk ndikon për të kthyer (heq dorë) prej kryerjes së asaj vepre (p.sh., gjuetari gjuan në kafshë të egër edhe pse është i vetëdijshëm se mund të godas ndonjë gjuetar i cili është në afërsi të kafshës së egër). Ai për realizimin e asaj që është cak i tij, (gjuajtjen e kafshës së egër), pajtohet të paraqiten pasojat e ndaluara (vrasja e gjuetarit i cili është në afërsi direkte) si qëllim i tij i dytë. Pakujdesia (vëmendje e pamjaftueshme e nevojshme gjatë ndonjë aktiviteti), është kryerje e padëshiruar e veprës penale. Kryerësi, edhe nuk e dëshiron veprën e cila nuk është dëshirë e tij, përgjigjet për pasojat e padëshiruara. Pakujdesia mund të jetë e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme. I pandehuri mund të deklarohet fajtor për të gjitha akuzat në bazë të faktevetë pretenduara nga prokuroria. Po ashtu, si alternativë, i pandehuri mund të deklarohet fajtor për disa nga akuzat. Gjykatësi duhet të gjykojë nëse deklarimi, Palët mund të pajtohen që i akuzuari të deklarohet fajtor për një pjesë të aktakuzës dhe prokurori të mos ofrojë dëshmi për të mbështetur pjesët tjeraose pretendimet e aktakuzës.

Pas pranimit të deklarimit për të lehtësuar akuzat prokurori mund të ftojë gjykatësin për të miratuar propozimin. Gjykatësi mund ta refuzojë këtë. Si alternativë, prokurori mund të vazhdojë pa kërkuar miratimin e gjykatësit. Gjykatësi mund të shprehë mospajtim dhe të ftojë prokurorin të rishikojë rastin. Gjykatësi mund të pezullojë procedurën gjyqësore nëse mendon se rrethana e propozuar nga ana e prokurorit “mund të çojë deri në padrejtësi të rëndë”. Pastaj prokurori duhet, patjetër, ta diskutojë këtë me prokurorët elartë të caktuar dhe në rrethana ekstreme gjykatësi mund të refuzojë të vazhdojë deri sa autoriteti për ndjekje konsultohet me Prokurorin Publik.

Po ashtu erdhëm në përfundim se Me përgjegjësi penale kuptohet zbatimi i kërkesave të cilat lidhen së pari, me procedurën emarrjes në përgjegjësi penale të parashikuar nga legjislacioni procedural penal, së dyti, shqyrtimin dhe hetimin e çështjes gjatë gjykimit, së treti, marrjen e vendimit gjyqësor, së katërti, vuajtjen e dënimit të dhënë nga gjykata, së pesti, kufizimet e tjera të përcaktuara në vendimin egjykatës ndaj personit të marrë si i pandehur për kryerjen e veprës penale. Figura e veprës penale, në këtë tekst, konsiderohet si e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale, për një vepër penale të kryer prej tij dhe se, pa konstatimin e figurës së veprës penale, nuk mund të realizohet dhënia e drejtësisë. Vazhdohet më tej, me rolin parësor që luan figura e veprës penale për cilësimin ligjor të veprës. Vepra penale dhe dënimi janë dy institute të lidhura mjaft ngushtë ndërmjet tyre. Nuk mund të ketë dënim pa u parashikuar në veprën penale dhe nga ana tjetër nuk mund të ketë kuptim një vepër penale pa ekzistuar në të dënimi. Në këtë kuptim dënimi është një pjesë integrale e veprës penale. Nga ana e saj vepra penale përbëhet kryesisht nga dy pjesë, të cilat janë dispozitivi dhe sanksioni. Nëse do të mungonte ky i fundit, vepra penale do të konsiderohej një formulim bosh e pa asnjë vlerë praktike. Është pikërisht sanksioni ai i cili i jep vlefshmëri qëllimit të parashikimit të veprës penale. Nga ana e tij sanksioni ose dënimi duhet të konceptohet si një reagim i shtetit apo i shoqërisë ndaj një veprimi apo mosveprimi që vjen në kundërshtim me vlerat e tyre. Me anë të dënimit ata i tregojnë personave që i kryejnë këto veprime apo mosveprime se janë të papranueshme dhe të patolerueshme nga ana e tyre. Gjithashtu me anë të dënimit ky fakt i'u bëhet i ditur jo vetëm personave të sipërpërmendur, të cilët janë shkelësit e drejtpërdrejtë të normave të gjithëpranuara, por edhe të gjithë personave të tjerë. Në të njëjtën kohë dënimi është edhe një privim, vuajtje ose kufizim në drejtim të personave që kryejnë një vepër penale. Pa këtë element dënimi nuk do të mund të sillte efektet e tij, është ai që i jep jetë dënimit. Pra dënimi

mund të kuptohet si një masë shtrënguese që jepet nga shteti apo shoqëria ndaj atyre personave që mbajnë një sjellje në kundërshtim me normat dhe vlerat e konsideruara si të pacënueshme.

4.1 BIBLIOGRAFIA

1. Salihu I., E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithëshme), Prishtinë, 2003.
2. Zëeigert & Katz, “Njohuri për të drejtën e krahasuar”, përkthim, Skanderbeg Books, Tiranë, 2008.
3. Çela., Peza., Elezi., Gjika., E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë - Pjesa e Përgjithshme, Tiranë, 1982
4. Delpino L., Diritto Penale, Parte Generale, Napoli 2010
5. E drejta zakonore e Labërisë – Ismet Elezi.
6. E drejta zakonore penale e shqiptarëve – Ismet Elezi.
7. E drejta zakonore shqiptare 1 – Koço Nova.
8. E drejtë penale e krahasuar – Altin Shegani.
9. Elezi I, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë 2008
10. Elezi I., E Drejta Penale, Pjesa Posaçme, Tiranë, 2009
11. Elezi I., Kaçupi S., Haxhia M., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2012.
12. Gruda Z., Mbrojtja Ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Botimi I pestë ,Prishtinë, 2010
13. Islami H., Hoxha A, Panda I, Procedura Penale, Tiranë, 2007
14. J., Pradel, G., Corstens, G., Vermeulen , E drejtë penale europiane, përkthim shqip, Tiranë 2010
15. Kanuni i Lekë Dukagjinit (në variantin e Mirditës) – Xhemal Meçi.
16. Kanuni i Lekë Dukagjinit në profilin juridik – Sabri Quku.
17. Kërkime mbi kanunin e Skënderbeut – Xhyher Cani.
18. Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
19. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
20. Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – Prof. Dr. Ismet Elezi, Prof. As. Dr. Skënder Kaçupi, Dr. Maksim R. Haxhia.
21. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
22. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
23. Камбовски В., Казнено право (Општ дел), Скопје , 2010

24. Mantovani ., Diritto penale (Parte generale) Padova 2001.
25. Muçi Sh., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2012
26. Perkins R.M. & Boyce R.N., “Criminal laë and procedure”. Simonsen C.E & Gordon M.S. III, “Juvenile Justice in America”, J. Herring., “E Drejta Penale. Teori, kazuse dhe materiale”, përkthim, botuar nga “UET Press”, Tiranë 2013.
27. Sahiti E., & Zejneli I., E drejta e procedures penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2007.
28. Sahiti E., E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 1984.
29. Salihu I., E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2005.
30. Salihu I., E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithëshme), Prishtinë, 2010
31. Shegani A., E drejta Penale e Krahasuar, Tiranë 2002
32. Spiro S., “Elementet përbërës të figurës së veprës penale”, Cikël leksionesh, UET, Tiranë 2009.
33. Ukaj B., Kundërvajtjet në lëmin penal (leksione të autorizuara), Prishtinë, 2010.
34. Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri – Ismet Elezi.
35. Xhafo J., E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë 2009
36. Zejneli I., Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2008.
37. Zlataric B., Medjunarodno krivicno pravo, Prvi dio, Zagreb, 1979
38. Маркович Б., Коментар на Законот за кривична постапка, Скопје, 1978.
39. Матовски Н., Казнено процесно право (Посебен дел), Скопје, 2004.
40. Матовски Н., Казнено процесно право, (Општ дел), Скопје 2003

4.1.1 Akte normative

1. Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut, Ansambleja e Përgjithshme e OKB-së, 10 Dhjetor 1948.
2. Karta e OKB-së Ligji nr.8984, datë 23.12.2002 “Për Ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”
3. Karta Sociale Europiane Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat e Njeriut.
4. Kodi I Procedurës Penale të Kosovës, Nr. 04/L-123 , Gazeta zyrtare e RK Nr. 37 / 2012.
5. Kodi Penal Francez., Paris, 1997
6. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-082, Gazeta Zyrtare e RK Nr. 13/2008
7. Kodi Penal I RM-së (Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 36/96)
8. Kodi Penal Italian, Milano, 1992
9. Kodi Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë, Nr.7905, datë 21.3.1995
10. Konventa për Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, 1950.
11. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM-së Nr.51/92)
12. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, miratuar me referendum më 22.11.1998, shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 (i përditësuar) Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, 2016
13. Kushtetuta e SH.B.A-së , hyri në fuqi më 4 mars 1789
14. Ligji Nr. 9754 , 14.06.2007, “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik” I Kosovës.
15. Ligji për Procedurë penale I RM- së , Gazeta zyrtare e RM-së, Nr. 15/97.
16. Ligji për Prokurorinë Publike i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 150/2007, 111/2008
17. Rekomandimet e Këshillit të Europës në fushën penale.

4.1.2 Linqe ndërkombëtare dhe kombëtare

- [http:// www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org).
- <http://ec.europa.eu/>
- <http://ligjet.org>.
- <http://parlamenti.al>.
- <http://pravo.org.mk/>
- <http://www.ahc.org.al>.
- <http://www.coe.int>.
- <http://www.drejtesia-ks.org>.
- <http://www.gjykatatirana.gov.al> .
- <http://www.informator.rs/>
- <http://www.osce.org>.